

UDHËZUES PËR UJIN, SANITETIN DHE HIGJENËN NË KUSHTET E NDRYSHIMEVE KLIMATERIKE

Për profesionistët
e shëndetit publik



Dhjetor, 2023

Përmbajtja

Përmbledhja ekzekutive.....	5
Hyrje	8
Situata në Shqipëri në kuadër të ndryshimeve klimatike	8
Qëllimi udhëzuesit	11
Objektivat.....	12
Aksesi barabartë për ujë të pijshëm	13
Cilësia e ujit të pijshëm në kuadër të ndryshimeve klimatike.....	17
Principe mbi përdorimin e ujit	19
Rëndësia e ujit të pijshëm	20
Furnizimi me ujë	20
Sistemi i centralizuar i furnizimit me ujë (ujësjellësit)	23
Burimet ujore	23
Kërkesat higjieno sanitare për sigurimin e cilësisë së ujit të pijshëm të puseve.....	23
Kontrolli i cilësisë së ujit të pijshëm.....	25
Vlera parametrike.....	27
Zonat e mbrojtjes sanitare.....	28
Dezinfektimi	30
Procedura për parametrat që do të testohen në vend (ujësjellës)	31
Furnizimi me ujë në rast të përmytjeve.....	34
Dezinfektimi i puseve	40
Udhëzimet për furnizimin me ujë, kanalizimet dhe higjienën në objektet e kujdesit shëndetësor	41
1. Furnizimi me ujë në objektet e kujdesit shëndetësor	41
2. Saniteti në objektet e kujdesit shëndetësor.....	43
Largimi i ujërave të përdorura në objektet e kujdesit shëndetësor.....	45
Rekomandime	47
Parimet për zbatimin e ndërhyrjeve sanitare.....	48
Tualeti	48
Mbajtja – ruajtja/trajtimi	49
Transporti.....	49
Largimi i ujërave të përdorura	51
Shërbimet WASH.....	54
Gjinia dhe WASH.....	54

Higjiena.....	54
Plani i sigurisë së ujit	57
Referencat.....	61

Shkurtime

AKUK	Agjensia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
ISHSH	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor
NJVKSH	Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor
UK	Ujësjetllës Kanalizime
SOU	Sëmudjet me Origjinë nga Uji
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
ERRU	Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura
SHUK	Shoqëritë e Ujësjetllës Kanalizimeve
KBU	Këshilli i Basenit Ujor
PSV	Procedurat Standarde të Funksionimit
SDG	Objektivi mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm
DROSHKSH	Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor
QSH	Qendra Shëndetësore
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Përmbledhja ekzekutive

Sëmundjet me Origjinë nga Uji (SOU) janë njohur prej kohësh si një çështje e rëndësishme e shëndetit publik në mbarë botën, veçanërisht në vendet në zhvillim. Në kontekstin e ndryshimeve klimatike, sëmundjet e transmetuara nga vektorët, sëmundjet e shkaktuara nga ushqimi dhe SOU janë sëmundjet kryesore infektive në mbarë botën. Njerëz mund të ekspozohen ndaj SOU-ve duke u larë, dhe/ose duke pirë ujë të kontaminuar me patogjene. Patogjenët modifikojnë habitatet e tyre mjedisore dhe sjelljet e mbijetesës sipas ndryshimeve të klimës, të cilat mund të çojnë në transmetimin e patogjenëve.

Për më tepër, edhe në vendet e zhvilluara, shqetësimet rreth SOU-ve vazhdojnë. Në përgjithësi, ndryshimet klimatike dhe ngjarjet e ngrohjes globale kanë rritur shfaqjen e SOU-ve.

Mungesa e një infrastrukture shëndetësore, te përshtatshme dhe te besueshme si dhe ndryshimet e klimës, ndikojnë në rritjen e rasteve me SOU. Disa nga SOU, si kolera, salmoneloza, tifoja, hepatiti A dhe E, diarrea, leptospiroza, giardiasis, shigelloza, amebiaza, drakunkuliaza, kriptosporidioza, enteriti *Campylobacter*, dhe poliomielitit po bëhen gjithnjë e më serioze për shkak të ujë të pijshëm pamjaftueshmërisht të pastër.

Fëmijët janë më të prekshëm ndaj SOU-ve sesa të rriturit sepse fëmijët kanë një sistem mbrojtës imunitar të ulët. Rruga fekalo-orale, në të cilën feçet e njeriut gëlltiten përmes ushqimit ose ujit të kontaminuar dhe që më së shumti lindin nga menaxhimi joadekuat i ujërave të zeza dhe kushteve josanitare, është një transmetues i shpeshtë i shfaqjes së SOU-ve. Për më tepër, kur distanca ndërmjet tualeteve jashtë shtëpise dhe puseve nuk janë mjaftueshëm të largëta (më shumë se 50 m), krijon një mundësi me lartë që patogjenët fekalo-oral të hyjnë në puse, dhe mund të jenë burim kryesor i ndotjes së ujit për fshatarët (*Figura 1*).

Ndikimi i ndryshimeve klimatike në mjedis është një nga kërcënimet kryesore për shëndetin e njeriut. Shumë studime kanë treguar se incidenca e SOU-ve do të rritet. SOU-të të lidhura me ndryshimet ekstreme të motit do të ndikojnë në mënyrë disproporcionale në popullatat dhe ndoshta do të përkeqësojnë pabarazitë.

Për më tepër, ndryshimi i klimës mund të rrisë rrezikun e SOU-ve për shkak të ndryshimeve në cilësinë e burimeve ujore dhe frekuencën e fatkeqësive natyrore, si rezultat bëhen shkak për ndotjen e rrjetit të furnizimit me ujë. Si rrjedhim, sëmundjet infektive, si kolera, dizenteria, dhe tifoja, mund të bëhen më të zakonshme. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), mesatarisht 1.1 miliardë individë konsumojnë ujë që është i ndotur nga feces dhe 1.8 miliardë njerëzit vdesin çdo vit nga diarreja. Lidhja midis klimës dhe faktorëve që shkaktojnë SOU mund të ndryshojnë ndjeshëm midis vendeve dhe zonave gjeografike.

Tifoja dhe kolera janë dy sëmundjet kryesore që përbëjnë një kërcënim serioz dhe kanë ndikim të rëndësishëm në shëndetin e njeriut dhe veçanërisht për fëmijët nën moshën 5 vjeçare.

Vendet në zhvillim, në mënyrë të pashmangshme do të vuajnë në mënyrë disproporcionale epidemitë e shkatuara nga ndotja e ujit dhe fatkeqësitë e ndryshimeve klimatike, të tilla si shirat e dendur, përmbytjet, rritja e temperaturave dhe thatësitrat.

Kjo, së bashku me rritje e numërit të popullsisë, vlerat e larta të varfërisë, nivelet e ulëta të zhvillimit dhe kapaciteti i kufizuar adaptues, i bën vendet në zhvillim të prekshme ndaj çështjeve shëndetësore që lidhen me ndryshimet klimatike.

Konsumimi i ujit me cilësi të ulët në verë mund të rrisë rrezikun e mundshëm të gëlltitjes të patogjenëve të ujit, të cilët mund të çojnë në sëmundje diarrike me natyrë nga uji. Në vendet, ku kryehen jashtëqitje në zonat e hapura rurale publike pranë përrenjve ose liqeneve mund të shtohen rreziku i infeksioneve të tifos, paratifos dhe kolerës gjatë sezonit të verës, apo në ngjarjet e reshjeve të shumta dhe përmbytjeve.

Këto ngjarje klimatike rrisin transmetimin e *Vibrio cholerae* dhe baktere të tjera që transmetohen nga feçet tek uji i pijshëm ose sistemet e ushqimit.

Higjiena e dobët dhe cilësia e ulët e ujit të pijshëm janë përgjegjëse për rreth 80% të infeksioneve në vendet në zhvillim.

Mungesa e kanalizimeve të sigurta kontribuon në sëmundjet diarrike, të cilat janë një shqetësim i madh për shëndetin publik dhe shkak kryesor i sëmundjeve dhe vdekjeve tek fëmijët nën pesë vjeç në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme, veçanërisht kur efekti i ndryshimeve klimatike

është tepër i lartë. Në mbarë botën, 2.2 miliardë njerëz ende nuk kanë akses në ujë të pijshëm të sigurt dhe gati gjysma e popullsisë globale nuk ka akses në kanalizime të sigurt.

Dy miliardë njerëz nuk kanë akses në pajisjet për larjen e duarve me sapun dhe rreth 419 milionë njerëz praktikojnë jashtëqitjen e hapur. Pasojat e ujit të pasigurt, kanalizimeve dhe higjienës (WASH) të fëmijët mund të jenë vdekjeprurëse. Mbi 700 fëmijë nën moshën 5 vjeç vdesin çdo ditë nga sëmundjet diarreike për shkak të mungesës së shërbimeve të duhura WASH, të cilat favorizohen dhe nga efektet negative të kequshqyerjes. Në zonat e cilat ndoshen në konflikte, fëmijët kanë gati 20 herë më shumë gjasa të vdesin nga sëmundjet diarreike sesa nga vetë konflikti.

Mungesa e aksesit në objektet e përshtatshme higjienike dhe mungesa e ujit, është gjithashtu një shkak kryesor i rrezikut për gjendje ankthi, veçanërisht për gratë dhe vajzat. Për të gjitha këto arsye, higjiena parandalon sëmundjet infektive, siguron privatësinë dhe dinjitetin është e drejtë themelore e njeriut.

Higjiena përkufizohet si aksesit dhe përdorimi i objekteve dhe shërbimeve për asgjësimin e sigurt të urinës dhe feçeve njerëzore. Një sistem sanitar i sigurt është një sistem i projektuar dhe i përdorur për të ndarë jashtëqitjet njerëzore nga kontakti njerëzor në të gjitha hapat e zinxhirit të shërbimit sanitar nga hapja dhe përdorimi i tualetit përmes zbrazjes, transportit, trajtimit dhe asgjësimit përfundimtar ose përdorimit përfundimtar.

Sistemet e sigurt sanitare duhet të plotësojnë kërkesat e domosdoshme në një mënyrë që të shkojnë paralel me të drejtat e njeriut, duke adresuar gjithashtu bashkë-depozitimin e ujit gri, higjienën, praktikën dhe shërbimet thelbësore të nevojshme për funksionimin e teknologjive.

Megjithëse ka një sërë udhëzimesh kombëtare që përfshijnë disa fusha të ujit dhe sanitetit, aktualisht nuk ka një dokument që përshkruan qartë dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse rekomandimet për ujin, kanalizimet dhe higjienën, veçanërisht në kushtet e ndryshimeve klimaterike.

Ky udhëzues do të ofrojë standardet e rekomanduara dhe praktikën më të mira për ujin. Furnizimi me të, kanalizimet dhe higjienën në mjediset të ndryshme.

Hyrje

Sipas OBSH, një në tre njerëz jetojnë në mjedise pa kanalizime. Kjo situatë po shkakton sëmundje dhe vdekje të panevojshme. Edhe pse janë bërë hapa të rëndësishëm lidhur me qasjen në ujë të pijshëm të pastër, mungesa e kanalizimeve po pengon këto përpertime. Nëse ofrojmë pajisje të përballueshme dhe edukim mbi praktikën higjienike, ne mund ta ndalojmë këtë vuajtje të pakuptimtë dhe humbje jetësh.

Sipas SDG 6 deri në vitin 2030, duhet te garantohet:

UJI I PIJSHEM I SIGURT DHE I PERBALLUESHEM

Duhet të arrihet akses universal dhe i barabartë në ujë të pijshëm të sigurt dhe të përballueshëm për të gjithë deri në vitin 2030,

FUNDI I DEFEKIMIT TË HAPUR

Duhet te arrihet akses i barabarta në kanalizimet dhe higjiene adekuate për të gjithë dhe t'i jepet fund jashtëqitjes së hapur, duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të grave dhe vajzave dhe atyre në situata vulnerabël.

PËRMIRËSIM CILËSINË E UJIT, TRAJTIMIN I UJËRAVE TE ZEZA DHE RIPERDORIM I SIGURT

Duhet te përmirësohet cilësia e ujit duke reduktuar ndotjen, duke eliminuar mbetjet dhe minimizuar çlirimin e kimikateve dhe materialeve të rrezikshme, duke përgjysmuar përqindjen e ujërave të zeza të patrajuara dhe duke rritur ndjeshëm riciklimin dhe ripërdorimin e sigurt te ujit.

Situata në Shqipëri në kuadër të ndryshimeve klimatike

Ndryshimi i klimës, behet i dukshëm në rritjen e temperaturave te cilat ndikojnë ne cilësinë e ujit te pijshëm, ne modelet e reshjeve, thatësirën e zgjatur dhe përmbytjeve të cilat ndikojnë ne prurjet e ujit dhe ne reduktimin e sasisë se tij. Ndryshimet klimatike, diktojnë menaxhimin e mirë të cilësisë se ujit te pijshëm.

Uji mund të ndotet nga toka, nga rrjeti shpërndarës, veçanërisht tubacionet e dëmtuara. Shtimi i reshjeve dhe infiltrimi nëpërmjet tokës në zona industriale dhe bujqësore mund të ndotin ujin me lëndë inorganike dhe organike, plehra, pesticide etj.

Ndotësit e ajrit, si p.sh oksidet e squfurit dhe të azotit, treten në shi, duke prodhuar aciditet të shtuar të ujit dhe shi acid që nëpërmjet ciklit rrethor të qarkullimit behet faktor ndikues në cilësinë e ujit të pijshëm dhe ujërave te tjerë sipërfaqësor.

Uji i pijshëm i sigurt, kanalizimi dhe higjiena (WASH) janë thelbësore për shëndetin dhe mirëqenien e njeriut. Larja e sigurt nuk është vetëm një parakusht për shëndetin, por kontribuon në jetesën e mirë të popullatës, ndjekjen e shkollës dhe dinjitetin e individit si dhe ndihmon në krijimin e komuniteteve reziliente që jetojnë në mjedise të shëndetshme.

Proceset e rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e ujit

Lloji i procesit	Procesi i trupit ujqor	Trupi ujqor
Hidrologjik	Hollimi	Të gjithë trupat ujqorë
	Avullimi	Ujërat sipërfaqësorë
	Kullimi	Ujërat nëntokësorë
	Pezullia	Sipërfaqet ujqore
Fizike	Shkëmbimi i gazeve në atmosferë	Kryesisht lumenj e liqene
	Avullimi	Kryesisht lumenj e liqene
	Absorbimi	Të gjithë trupat ujqore
	Ngrohja dhe ftohja	Kryesisht lumenj e liqene
	Difuzioni	
Kimike	Fotodegradimi	
	Reaksionet me bazë acide	Të gjithë trupat ujqore
	Reaksionet redoks	Të gjithë trupat ujqore
	Shpërbërja e grimcave	Të gjithë trupat ujqore
	Precipitimi i mineraleve	Të gjithë trupat ujqore
	Shkëmbimi jonik	Ujërat nëntokësorë
	Prodhimi primar	Ujërat sipërfaqësore

Biologjike	Shkatërrimi dhe rritja mikrobike	Të gjithë trupat ujore
	Dekompozimi i materies organike	Kryesisht lumenj e liqene
	Bioakumulimi	Kryesisht lumenj e liqene
	Biologjia	Kryesisht lumenj e liqene

Qëllimi udhëzuesit

Qëllimi kryesor i këtij udhëzuesi është që nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të profesionistëve, të përmirësohet mbrojtja e shëndetit publik nga efektet negative të çdo ndotjeje të ujit të destinuar për konsum njerëzor duke u siguruar cilësinë dhe sigurinë e tij.

Ndryshimet klimatike, veçanërisht rritjet e temperaturave, ndryshimi i shtrirjes së stinëve në shtrirjen vjetore kanë një impakt negativ në cilësinë e ujit dhe sasinë e nevojshme për përdorim. Gjithashtu, përfshirja e disa institucioneve përgjegjëse në sigurimin e cilësisë së ujit të pijshëm si dhe mungesa e një instrumenti ndihmues por dhe të unifikuar për të vepruar në situata të emergjencës apo shpërthimeve epidemike me natyrë nga uji bënë të mundur hartimin e një udhëzuesi mbi sigurinë e ujit dhe sanitetin.

Udhëzuesi ofron rekomandime për menaxhimin e riskut nga rreziqet që mund të cenojnë sigurinë e ujit të pijshëm.

Ky udhëzues është një dokument teknik i cili do të përdoret nga institucionet të cilat janë përgjegjëse për garantimin e cilësisë dhe sigurisë së ujit të pijshëm dhe kanalizimeve. Institucionet përgjegjëse të cilat do të përdorin këtë udhëzues në praktiken e përditshme janë, Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) nëpërmjet përgjegjësit për monitorimin të jashtëm të cilësisë së ujit të pijshëm; DROSHKSH Bashkërendojnë punën ndërmjet të gjitha strukturave që kanë në varësi. Shoqëritë e Ujësjellës-Kanalizimet (UK) nëpërmjet përgjegjësit për monitorimin e brendshëm të cilësisë së ujit dhe kanalizimeve; Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) institucion këshillues në situata emergjente të shpërthimeve epidemike me natyrë nga uji, Agjensia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve (AKUK) përgjegjëse për cilësinë e ujit të pijshëm dhe kanalizimeve, ISHSH (përgjegjëse për inspektimin dhe kontrollin e kushteve higjienike në ujësjellës)

Udhëzuesi do të shërbejë si një instrument i rëndësishëm në promovimin e sistemeve dhe praktikave të sigurta sanitare në kuadër të ndryshimeve klimatike.

Udhëzuesi ofron lidhjen midis kanalizimeve dhe shëndetit, rekomandime dhe udhëzime për implementimin e praktikave të mira higjienike në mbrojtje të shëndetit publik.

Udhëzuesi synon gjithashtu të përcaktojë dhe mbështesë rolin e shëndetit dhe aktorëve të tjerë në politikat dhe programimin e kanalizimeve për të ndihmuar në sigurimin e identifikimit dhe menaxhimit të rreziqeve shëndetësore në mënyrë efektive.

Objektivat

Hartimi i udhëzuesit dhe vënia e tij në zbatim nga specialistët e shëndetit publik dhe punonjësit e ujësjellës kanalizimeve, do të jetë një vlerë e shtuar në marrjen e masave të nevojshme për të siguruar që uji i destinuar për konsum njerëzor është i shëndetshëm dhe i sigurt. Ai do të ndihmojë edhe në marrjen e masave për të siguruar kushte të përshtatshme higjienike në praktiken e përditshme të përdorimit të tualeteve.

Objektivat në implementimin e këtij udhëzuesi konsistojnë në:

1. Dhënien e këshillave orientuese në situatat emergjente në rastet e kontaminimit të ujit të pijshëm, kur kërkohet ndërhyrje nga një departament apo institucion përgjegjës.
2. Përdorimin e tij për sigurinë e ujit të pijshëm dhe sanitetin duke përfshirë dhe zonat turistike.
3. Përdorimin e tij në objekte të cilat duhet të përdorin ujin e pijshëm në përpunimin dhe trajtimin e ushqimit (ndërmarrje prodhimi ushqimor).
4. Përdorimi i udhëzuesit nga palët e interesuara për çështjet e cilësisë së ujit, duke përfshirë zhvillimin e politikave ujore dhe prioritetëve kërkimore

Sipas OBSH, një në tre njerëz jetojnë në mjedise pa kanalizime. Kjo situatë po shkakton sëmundje dhe vdekje të panevojshme. Edhe pse janë bërë hapa të rëndësishëm lidhur me qasjen në ujë të pijshëm të pastër, mungesa e kanalizimeve po pengon këto përpertime. Nëse ofrojmë pajisje të përballueshme dhe edukim mbi praktikën higjienike, ne mund ta ndalojmë këtë vuajtje të pakuptimtë dhe humbje jetësh.

Sipas SDG 6 deri në vitin 2030, duhet të garantohet:

UJI I PIJSHEM I SIGURT DHE I PËRBALLUESHËM

Duhet të arrihet akses universal dhe i barabartë në ujë të pijshëm të sigurt dhe të përballueshëm për të gjithë deri në vitin 2030.

FUNDI I DEFEEKIMIT TË HAPUR

Duhet të arrihet akses i barabartë në kanalizimet dhe higjienë adekuate për të gjithë dhe t'i jepet fund jashtëqitjes së hapur, duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të grave dhe vajzave dhe atyre në situata vulnerabël.

PËRMIRËSIM NË CILËSINË E UJIT, TRAJTIMI I UJËRAVE TË ZEZA DHE RIPËRDORIM I SIGURT

Duhet të përmirësohet cilësia e ujit duke reduktuar ndotjen, duke eliminuar mbetjet dhe minimizuar praninë e kimikateve dhe materialeve të rrezikshme, duke përgjysmuar përqindjen e ujërave të zeza të patrajuara dhe duke rritur ndjeshëm riciklimin dhe ripërdorimin e sigurt të ujit.

Aksesi barabartë për ujë të pijshëm

Aksesi në ujë të pijshëm dhe të sigurt dhe aksesit në kanalizime janë njohur si të drejtat njerëzore nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe Këshilli i të Drejtave të Njeriut. Kjo do të thotë se sigurimi i aksesit në ujë të pijshëm dhe kanalizime të sigurta për të gjithë është një detyrim ligjor. Për të përmbushur këtë detyrim, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet një fazë të hershme të sigurimit që aksesit në ujë dhe kanalizime të jetë i barabartë për të gjithë popullsinë.

Për të siguruar akses të barabartë në ujë dhe kanalizimet nevojitet: reduktimi i dallimeve gjeografike në shërbimet e ofruara; shmangia e diskriminimit ose përjashtim nga aksesit në shërbime nga grupet e cënueshme dhe të marginalizuara; dhe duke siguruar përbalueshmërinë financiare nga përdoruesit.

Lidhja e fortë ndërmjet ofrimit të shërbimit me ujë dhe kanalizime kërkojnë një qasje holistike për promovimin e aksesit të barabartë për ujë dhe kanalizime në gjithë popullsinë panvaresisht pozicionimit gjeografik apo statusit social.

Enti Rregullator i Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime (ERRU) është institucion publik i pavarur që bën rregullimin e sektorit ujësjellës kanalizimeve në nivel vendi, për të siguruar garantimin dhe mbrojtjen e interesave publike dhe për të krijuar një mjedis rregullator transparent.

ERRU siguronë që:

- Operatorët/SHUK (Shoqëritë e Ujësjellës Kanalizimeve) t'ju ofrojnë konsumatorëve shërbime me cilësi të mirë dhe efikase dhe me një çmim të arsyeshëm;

- Tarifat e shërbimit, të kenë qëndrueshmërinë financiare të operatorëve/SHUK si dhe përballimin e tyre nga klientët, duke marrë në konsideratë dhe statusin ekonomike të popullatës dhe grupeve vulnerabel;
- Operatorët/SHUK të bëjnë më të mirën për klientët dhe mjedisin në vështrim afatgjatë;

Mesazhet kryesore që askush të mos mbetet pa shërbim të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve

- Realizimi i të drejtës së njeriut për ujë dhe kanalizime kërkon vëmendje të veçantë, ndaj vendndodhjes gjeografike për akses, akses nga personat vulnerabël dhe grupet e marginalizuara dhe çështjet e përballeshmërisë në tarifimin të ujit dhe kanalizimeve.
- Nevojiten qasje specifike për të korrigjuar pabarazitë aktuale në aksesin për ujë dhe kanalizime.
- Aplikimi i parimit "*Vëzhgimi detajuar i aksesit të barabartë*" është gjithashtu i nevojshme për të përshpejtuar përparimin bazuar në përmirësimin e menaxhimit për ujë dhe kanalizime.
- Marrja në konsideratë e boshllëqeve të aksesit për ujë dhe kanalizime dhe përballeshmërisë së tarifës ndërmjet zonave gjeografike duke reduktuar kështu ngarkesën financiare për personat në nevojë apo grupeve të marginalizuara të popullsisë.
- Zgjidhje të diferencuara për grupe të cënueshme, me nevojë ekonomike dhe me barriera të ndryshme për arritjen e aksesit të barabartë për ujë dhe kanalizime
- Sigurimi që fatura e ujit të jetë e përballeshme nga të gjithë grupet e popullsisë kërkon zgjidhje të kujdesshme të mjeteve jashtë tarifës së shërbimit.

Rritja e ekstremeve dhe ndryshueshmërisë klimatike, shoqërohet me rritje të fatkeqësive dhe rreziqeve të rënda dhe të shpeshta të lidhura me ujin. Keto ndryshime përfshijnë degradimin e mjedisit, ndotjen e ujit, rritjen e temperaturave të ujit dhe humbjen e ekosistemit dhe duke prekur thellësisht ekonominë, shoqërinë dhe mjedisin.

Kjo nga ana tjetër ndikon aftësinë natyrore të ekosistemeve. Një rritje e ngrohjes globale parashikohet të përkeqësojë rreziqet për ekosistemet dhe njerëz; nëntë nga dhjetë fatkeqësitë e shkaktuara nga rreziqet natyrore gjatë dekadës së fundit ishin të lidhura me ujin. Rritja e ekstremeve dhe ndryshueshmërisë klimatike, shoqërohet me rritje të fatkeqësive dhe rreziqeve të

rënda dhe të shpeshta të lidhura me ujin. Keto ndryshime përfshijnë degradimin e mjedisit, ndotjen e ujit, rritjen e temperaturave të ujit dhe humbjen e ekosistemit dhe duke prekur thellësisht ekonominë, shoqërinë dhe mjedisin. Për shkak të natyrës së tyre të varur nga uji, siguria ushqimore, shëndeti i njeriut, urban dhe rural vendbanimet, prodhimi i energjisë, zhvillimi industrial, zhvillimi ekonomik dhe ekosistemet janë gjithnjë e më vulnerabël ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Në të njëjtën kohë, përgjigjet ndaj ndryshimeve klimatike ndikojnë gjithashtu në burimet ujore dhe proceset hidrologjike.

Ndryshimet klimatike, aktivitetet e paqëndrueshme njerëzore dhe menaxhimi i dobët mjedisor ndikojnë në disponueshmërinë, cilësinë dhe sasinë e ujit, duke penguar realizimin e të drejtës së njeriut për ujin dhe kanalizimet, një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm, si dhe të drejta të tjera të njeriut.

Në vitin 2018, 2.3 miliardë njerëz (pothuajse 30% e popullsisë globale) jetonin në vende me ulje apo humbje të sasisë së ujit dhe 3.6 miliardë njerëz përballëshin me akses të pamjaftueshëm të ujit, kishin ujë një muaj në vit.

Ndikimet klimatike nuk njohin kufij dhe 60% e furnizimeve globale me ujë të ëmbël gjenden në basenet ndërkuftare të ndarë nga 153 vende, kjo i shton një dimension ndërkombëtar përshtatjes nga ndryshimi i klimës dhe reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë.

Shkalla e rrezikut të lidhur me ujin po rritet me një ritëm të paprecedentë, siç janë edhe frekuenca, intensiteti dhe kostot e fatkeqësive, duke shkaktuar humbje dhe dëme të konsiderueshme për njerëzit, natyrën, asetet ekonomike dhe infrastruktura.

Vdekjet nga fatkeqësitë e lidhura me ujin janë më shumë se dyfishuar 10 vitet e fundit. Gjate periudhes 2010 – 2019, janë raportuar rreth 95% e humbjeve dhe dëmeve të infrastrukturës të cilat ishin të lidhura me ujin. Gati 1.4 miliardë njerëz janë prekur nga thatësira dhe 1.6 miliardë te tjere nga përmbytjet gjate kesaj periudhe.

TË BËJMË

Sigurimin e ujit dhe kanalizimeve për të gjithë duke u bazuar në disa parime bazë

Kurse ujin

Bëj dush në kohë të shkurtër, mos e lërëe ujin të rrjedhë kur lanë dhëmbët, lanë enët apo kur përgatit ushqimin

Thyej tabut

Fol pa hezitim rreth rëndësisë së lidhjes midis tualetit dhe ujit gjatë mestuarcioneve

Vendos barazi në përdorim

Përdorim i barabartë i ujit në tualete e grave dhe të burrave, vazjave dhe djemve

Bëj shpëlarje të sigurt

Rregullo mungesën e ujit në tubacionet e mbetjeve (jashtëqitjeve)

Merr masa që depot septike të jenë bosh dhe të raportohet për mbetjet e llumit.

Ndaloni ndotjen

Mos hidhni mbetje ushqimesh, vaj, medikamnete dhe kimikate në tualete

Ha lokalisht

Blej ushqim vendas, ha ushqim sezonal dhe konsumo produkte që përgatiten me pak ujë.

Bëhu kurioz

Nga vjen uji në rrubinetin tim, si vjen dhe si shpërndahet. Vizitoni vendin e trajtimit të mbetjeve të shihni dhe kuptoni si menazhohen ato.

Mbro natyrën

Mbill një pemë ose krijoni një kopësht të vogël tuajin, përdorni zgjidhje naturale për të ulur riskun e përmbytjeve dhe sigurimin e ujit.

Pastro

Bëhu pjesë e pastrimit të lumenjeve, liqeneve apo plazheve

Përmbytjet shkaktojnë:

- Sëmundje infektive
- Sëmundje të shkaktuara nga uji
- Helmime
- Kufizim të shërbimeve shëndetësore
- Mungesë të ujit të pijshëm



Figura 1 Ndikimet e ndryshimeve klimatike në shfaqjen e sëmundjeve të shkaktuara nga uji, kryesisht nga patogjenët

Cilësia e ujit të pijshëm në kuadër të ndryshimeve klimatike

Ndryshimi i klimës, behet i dukshëm në rritjen e temperaturave të cilat ndikojnë në cilësinë e ujit të pijshëm, në modelet e reshjeve, thatësirën e zgjatur dhe përmbytjeve të cilat ndikojnë në prurjet e ujit dhe në reduktimin e sasisë së tij. Ndryshimet klimatike, diktojnë menaxhimin e mirë të cilësisë së ujit të pijshëm.

Uji mund të ndotet nga toka, nga rrjeti shpërndarës, veçanërisht tubacionet e dëmtuara. Shtimi i reshjeve dhe infiltrimi nëpërmjet tokës në zona industriale dhe bujqësore mund të ndotin ujin me lëndë inorganike dhe organike, plehra, pesticide etj.

Ndotësit e ajrit, si p.sh oksidet e squfurit dhe të azotit, treten në shi, duke prodhuar aciditet të shtuar të ujit dhe shi acid që nëpërmjet ciklit rrethor të qarkullimit behet faktor ndikues në cilësinë e ujit të pijshëm dhe ujërave të tjerë sipërfaqësor.

Uji i pijshëm i sigurt, kanalizimi dhe higjiena (WASH) janë thelbësore për shëndetin dhe mirëqenien e njeriut. Larja e sigurt nuk është vetëm një parakusht për shëndetin, por kontribuon në jetesën e mirë të popullatës, ndjekjen e shkollës dhe dinjitetin e individit si dhe ndihmon në krijimin e komuniteteve reziliente që jetojnë në mjedise të shëndetshme.

Proceset e rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e ujit

<i>Lloji i procesit</i>	<i>Procesi i trupit ujour</i>	<i>Trupi ujour</i>
<i>Hidrologjik</i>	Hollimi	Të gjithë trupat ujourë
	Avullimi	Ujërat sipërfaqësorë
	Kullimi	Ujërat nëntokësorë
	Pezullia	Sipërfaqet ujure
	Shkëmbimi i gazeve në atmosferë	Kryesisht lumenj e liqene
<i>Fizike</i>	Avullimi	Kryesisht lumenj e liqene
	Absorbimi	Të gjithë trupat ujourë
	Ngrohja dhe ftohja	Kryesisht lumenj e liqene
	Difuzioni	
	Fotodegradimi	
<i>Kimike</i>	Reaksionet me bazë acide	Të gjithë trupat ujourë
	Reaksionet redoks	Të gjithë trupat ujourë
	Shpërbërja e grimcave	Të gjithë trupat ujourë
	Precipitimi i mineraleve	Të gjithë trupat ujourë
	Shkëmbimi jonik	Ujërat nëntokësorë
	Prodhimi primar	Ujërat sipërfaqësore
	Shkatërrimi dhe rritja mikrobike	Të gjithë trupat ujourë
<i>Biologjike</i>	Dekompozimi i materies organike	Kryesisht lumenj e liqene
	Bioakumulimi	Kryesisht lumenj e liqene
	Biologjia	Kryesisht lumenj e liqene

Uji i destinuar për konsum njerëzor është i sigurt nëse:

- Nuk përmban mikroorganizma dhe parazitë apo ndonjë substancë, të cilat, në numër ose përqendrime, përbëjnë një rrezik potencial për shëndetin e njeriut.
- Plotëson kërkesat minimale të përcaktuara në *Aneksin I*, masat e nevojshme për të siguruar që uji i destinuar për njerëzit është në përputhje me kërkesat e direktivës së ujit.

Principe mbi përdorimin e ujit

- Uji është një burim i kufizuar, thelbësor për bujqësinë, industrinë dhe madje edhe ekzistencën njerëzore.
- Pa ujë të ëmbël të sasisë dhe cilësisë së duhur zhvillimi i qëndrueshëm nuk do të jetë i mundshëm.
- Ndotja e ujit dhe përdorimi i pa kriter i tij kërcënon projekte zhvillimore dhe e bëjnë trajtimin e tij të vështirë për ta destinuar atë si ujë të pijshëm të sigurt.
- Uji me cilësi të mirë është thelbësor për të pasur një zhvillim social- ekonomik të qëndrueshëm.
- Ekosistemet ujore kërcënohen në shkallë botërore nga një shumëllojshmëri ndotësish si dhe praktika shkatërruese të përdorimit të tokës ose të menaxhimit të ujit.
- Shkarkimi i mbetjeve industriale, kimikateve, mbetjeve bujqësore dhe blegtorale nxisin rritjen e algave (mund të çojnë në eutrofikim), janë disa nga shkaqet e sotme kryesore të degradimit të cilësisë së ujit.
- Ndotja e rëndë organike çon në prishje të ekuilibrit të oksigjenit dhe shpesh shoqërohet nga kontaminimi i rëndë patogjen.
- Përdorimi pa kriter i pesticideve, nitrateve rrit rrezikun e kontaminimit të ujit.
- Erozioni shkakton përqendrime të larta të lëndëve të suspenduara, lëndëve të ngurta në lumenj dhe përrenj.
- Ndotja direkte e ujërave sipërfaqësore me metale nga shkarkimet e minierave, shkrirja dhe prodhimi industrial është një fenomen i cili ka ndikim direkt në cilësinë e ujit.

- Lagështia në atmosferë duke u kombinuar me gazet që prodhohen lëndët djegëse, fosile që digjen nga kontakti me shiun acid, shkaktojnë acidifikimin e ujërave sipërfaqësore, veçanërisht liqeneve.
- Ndotja e ujit shkaktohet nga mikrondotës organikë sintetikë si rezultat i shkarkimit të drejtpërdrejtë në ujërat sipërfaqësore ose pas transportit përmes atmosferës.
- Sot, ka ndotje me gjurmë jo vetëm të ujërave sipërfaqësore, por edhe të trupave ujorë nëntokësorë, të cilët janë të ndjeshëm ndaj kullimit nga mbetjet e minierave dhe vendet e prodhimit industrial.⁽⁷⁾
- Thatësira me shtimin e mungesës së burimeve ujore mund të shkaktojë edhe ndryshim të cilësisë së burimeve ujore ekzistuese.
- Uji i pakët shoqërohet me cilësi të ulët, shtim të mundësisë për ndotje dhe mundësi e lartë për sëmundje që transmetohen nëpërmjet ujit të pijshëm të ndotur.

Rëndësia e ujit të pijshëm

- Uji është i domosdoshëm për mbijetesën e organizmit.
- Përdorimi i ujit jashtë specifikimeve për konsum mund të shërbejë si burim për përhapjen e një game të gjerë të sëmundjeve infektive dhe shpërthimeve epidemike të përmasave të ndryshme.
- Me rritjen e numrit të popullsisë pasuar dhe nga ndryshimet klimatike kryesisht në zonat urbane, bëhet i vështirë sigurimi i sasisë dhe cilësisë së ujit sipas kriterëve të vendosura në standarde.

Furnizimi me ujë

Sigurimi i ujit me cilësi për popullatën kërkon zbatimin e 4 elemente kryesore si

- a. Cilësia e ujit
- b. Respektimi i zonave të mbrojtjes sanitare
- c. Siguria e rrjetit shpërndarës

d. Sasia e mjaftueshme e ujit

- Kujdesi për respektimin e normave dhe kritereve higjieno sanitare është i rëndësishëm në sistemet e centralizuara të furnizimit me ujë (ujësjellësit), burimet lokale, puset kolektive apo personale që përdoren për furnizimin e popullsisë me ujë të pijshëm.
- Ndotjet bakteriale, shkaktojnë problematikë shëndetësore të menjëhershme si rezultat i ndotjes së ujit. Ndotja manifestohet me fillimin e simptomave tek personat që konsumojnë ujë të ndotur në varësi të tipit të ndotjes (bakteriale, virale)
- Shfaqja e efektit dëmtues të shëndetit nga uji karakterizohet nga ndërlidhja e elementeve të rëndësishme të kohës, vendit dhe numrit të personave të sëmurë.
- Evidentimi i ndotjes së ujit arrihet nëpërmjet procesit të monitorimit.

Burimet e ndotjes së ujit janë :

- Ujërat e zeza
- Ujërat industriale
- Ujërat e reshjeve që kalojnë përmes zonave urbane
- Ujërat që kalojnë nëpër zona bujqësore.

Shpesh sëmundjet me origjinë nga uji shkaktohen nga:

- Bakteret
- Viruset
- Parazitët

Shumica e këtyre sëmundjeve konsiderohen sëmundje infektive të cilat paraqesin vështirësi në trajtim në rastet e hasjes së shpërthimeve me përfshirjen e një numri të konsiderueshëm personash.

Sëmundjet të cilat kanë një barrë të madhe për shëndetin publik janë:

- Kolera,
- Tifoja,

- Paratifoja,
- Hepatiti A,
- Salmonelozat,
- Shigelozat,
- Xhardiazat
- Kriptoorkidazat etj

Marrja e masave për ndërhyrje të menjëhershme:

- Në rase të evidentimit të ndotjes së ujit të mos pritët deri në shfaqjen e simptomave shëndetësore të shkaktuara nga ndotja, por të veprohet menjëherë për të identifikuar shkaktarin.
- Sa herë që ekziston rreziku që uji të jetë i ndotur si në rastet e dëmtimeve të sistemit të furnizimit, infiltrimit të ujërave të zeza me prezencë të ndotjes bakteriale dhe kimike duhet të komunikohet me konsumatorin të respektojnë rregullat e dhëna nëpërmjet komunikimit.
- Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, (NJVKSH) kërkon që administratori (U.K) apo të dy së bashku, të marrin masat e duhura për të eliminuar rrezikun evident që pasqyron mospërputhjen me vlerat parametrike.
- Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, (NJVKSH) në bashkëpunim me administratorin (UK) duhet të informojnë konsumatorët mbi masat e ndërmarra dhe këshillojnë për çdo veprim rregullues shtesë që ata duhet të ndërmarrin deri në komunikimin përfundimtar të lejimit të ujit për konsum (kur treguesit e analizuar janë brenda normave).
- Shtimi i pikave të monitorimit.

Sistemi i centralizuar i furnizimit me ujë (ujësjellësit)

Një sistem furnizimi me ujë mund të përshkruhet si i përbërë nga tre komponentë bazë: burimi i furnizimit, përpunimi ose trajtimi i ujit dhe shpërndarja e ujit tek përdoruesit ose konsumatori, të cilat janë si më poshtë:

1. Burimi i furnizimit (burimi i ujit).
2. Përpunimi ose trajtimi i ujit.
3. Shpërndarja e ujit tek përdoruesit ose konsumatori.

Burimet ujore

Burime ujore konsiderohen:

- Ujërat që përdoren për prodhimin e ujit të pijshëm me origjinë nëntokësore
- Ujërat që përdoren për prodhimin e ujit të pijshëm me origjinë sipërfaqësore

Kërkesat higjieno sanitare për sigurimin e cilësisë së ujit të pijshëm të puseve

- Administratori i pusit kolektiv apo privat (pronari) është përgjegjës për respektimin e kërkesave higjieno sanitare për sigurimin e cilësisë së ujit të pijshëm.
- NVKSh kontrollon respektimin e kërkesave higjieno-sanitare të pusit, cilësinë e ujit. Rezultatet analitike të çdo parametri të analizuar ia bën të ditura me shkrim organeve të qeverisjes vendore dhe administratorit.
- Në rast të mosrespektimit të rregullave higjieno sanitare, NjVKSh informon Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor (ISHSH), i cili vepron sipas kompetencave të parashikuara ligjore.
- ISHSH-ja ndalon përdorimin e pusit individual apo kolektiv dhe/ose u kërkon organeve të qeverisjes vendore dhe/ose administratorit marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes.
- Në rastin e ndalimit të përdorimit, vendoset mbishkrimi: “Ujë i ndaluar për pirje”.⁽³⁾

Cilësia e ujit

Kontrolli i cilësisë së ujit të pijshëm është një aktivitet i ndërmarrë për të identifikuar dhe vlerësuar faktorët që mund të përbëjnë një rrezik për shëndetin.

Procesi i kontrollit të cilësisë përmban:

- Monitorimi
- Survejanca
- Inspektimi
- Kontrolli
- Cilësia e ujit

Monitorimi:

Monitorimi dhe vlerësimi është procesi i cili përfshin mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për të matur progresin drejt arritjes së qëllimeve për ujë të sigurt për konsumatorët. Ky proces ndihmon në identifikimin e problematikave dhe ndihmon në marrjen e vendimeve se si të përmirësojnë cilësinë e ujit dhe të mbrojmë shëndetin e konsumatorëve. Monitorimi dhe vlerësimi përfshin analizimin e parametrave fizikë, kimikë dhe biologjikë.

Survejanca:

Survejanca e furnizimit me ujë të pijshëm është "vlerësimi i vazhdueshëm dhe vigjilent i shëndetit publik në rivlerësimin e sigurisë dhe pranueshmërisë së furnizimeve me ujë të pijshëm" (OBSH).

Sistemi i Survejanca për Cilësinë e Ujit është një strukturë e krijuar për të mbështetur monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë së ujit në sistemin e shpërndarjes. Sistemi përbëhet nga një ose më shumë komponentë që rrisin aftësinë e një shoqërie që prodhon ujë të pijshëm për të zbuluar shpejt dhe për t'iu përgjigjur çështjeve të cilësisë së ujit, veçanërisht në rastet e shpërthimeve epidemike nga uji.

Survejanca është një program sistematik të dhënash që kombinohet me analiza të ujit të pijshëm.

- Survejanca ka kohëzgjatje të pakufizuar, programe intensive për të matur dhe vëzhguar cilësinë e mjediseve ujore për një qëllim të caktuar.
- Survejanca është matje dhe vëzhgim specifik me qëllim menaxhimin e cilësisë dhe aktivitetet operacionale.

Monitorimi i cilësisë së ujit përkufizohet si marrja e mostrave dhe analiza e gjithë parametrave dhe kushteve të ujit. Këto mund të përfshijnë ndotësit e natyrave të ndryshme.

Inspektimi

Inspektim konsiderohet analizë gjithëpërfshirëse e linjave të shpërndarjes së furnizimit me ujë. Nëpërmjet inspektimit jepet një vlerësim i plotë i linjave të shpërndarjes së furnizimit me ujë. Gjithashtu, nëpërmjet inspektimit zbulohen problematikat që lidhen me rrjedhjet, dëmtimet dhe çështje të tjera duke na ofruar analiza dhe vizualizime të të dhënave për menaxhim efikas të furnizimit me ujë në gjithë sistemin e shpërndarjes.

- Inspektimi mbulon të gjithë sistemin e furnizimit me ujë duke përfshirë burimet, tubacionet, impiantet e trajtimit, rezervuarët, depot, dhe sistemet e shpërndarjes.
- Drejtoritë e ujësjellës kanalizimeve Sh.A janë përgjegjës në çdo kohë për cilësinë dhe sigurinë e ujit që ata prodhojnë.
- Inspektimi realizon kombinim të praktikës së mirë operative për parandalimin e ndotjes dhe kontrollin e cilësisë.

Kontrolli

Sistemi i menaxhimit të furnizimit me ujë është një mënyrë për të rregulluar furnizimin me ujë në përpjekje për të përmbushur nevojat e popullatës dhe për të parandaluar defektet dhe mungesën e ujit në një vend të caktuar.

Uji i sigurt është jetik për shëndetin e njeriut, veçanërisht në kontekstin e larjes dhe përgatitjes së ushqimit, ndërsa furnizimi joadekuat me ujë mund të pengojë lehtësisht çdo aspekt të zhvillimit ekonomik të varur prej tij. Në këtë rast kostot operacionale do të rriten dhe furnizimi i pamjaftueshëm dhe jo i sigurt i ujit do të kërcënojë gjithashtu shëndetin e njerëzve.

Kontrolli i cilësisë së ujit të pijshëm

Kontrolli i cilësisë së ujit të pijshëm është detyrim i furnizuesit apo prodhuesit të ujit të pijshëm (monitorimi i brendshëm). dhe:

- Konsiston në marrjen e masave mbrojtëse në prodhimin dhe shpërndarjen e tij
- Përfshin testimin periodik (përfshi dhe testimin sporadik apo rastësor) të cilësisë së ujit duke siguruar respektimin e standardeve kombëtare.

Cilësia e ujit konsiston në:

- Ujë pa ndotje fizike
- Ujë pa ndotje bakteriologjike
- Ujë të përshtatshëm për pirje
- Ujë të përshtatshëm për përdorim shtëpiak

Kriteret e ujit të pijshëm të sigurt:

- Uji i pijshëm nuk duhet të ketë erë, ngjyrë dhe shije të pakëndshme,
- Uji duhet të jete bakteriologjikisht i pastër
- Furnizimi me ujë duhet të plotësojë normat për parametrat kimikë
- Uji duhet të jete në sasi të mjaftueshme dhe i aksesueshëm nga të gjithë
- Vlerësimi i cilësisë së ujit duhet të kryhet nga administratori përpara se uji i burimi të vihet në përdorim
- Duhet të kryhet marrja e kampioneve dhe testimi i mostrave të ujit në mënyrë periodike
- Frekuenca dhe kampionimi duhet të jetë sipas udhëzimeve të paraqitura në VKM 379
- Rezultatet e analizave të cilësisë së ujit duhet të vihen në dispozicion të institucioneve shëndetësore dhe prodhuesve të ujit të pijshëm, veçanërisht në raste të ndotjes dhe të mos përdorimit nga konsumatorët.

Monitorimi i cilësisë së ujit të pijshëm:

A. Parametrat bazë të përfshirë në monitorim:

- Aromë
- Shije
- Ngjyrë

- Temperaturë
- Turbullirë
- Përcjellshmëri
- pH
- Fortësi e përgjithshme
- Amonium
- Escherichia coli (E.coli)
- Koliform bakteria
- Enterococcus intestinal

Monitorimi dhe kontrolli periodik kanë për qëllim t'i ofrojnë administratorit dhe autoritetit shëndetësor informacion të rregullt mbi cilësinë mikrobiologjike, organoleptike dhe fiziko kimike të ujit të pijshëm, si dhe informacion mbi efektshmërinë e trajtimit të tij (veçanërisht të dezinfektimit), për të përcaktuar nëse uji i pijshëm është në pajtueshmëri me vlerat parametrike të vendosura në legjislacionin përkatës të ujit të pijshëm. *Aneks 1*

B. Parametrat lidhur me metodën e dezinfektimit:

- Nitrite: kur është përdorur kloraminimi.
- Klor i lirë mbetës: kur është përdorur klori ose LSD-të e tij.
- Klor i kombinuar mbetës: kur është përdorur kloraminimi.

Vlera parametrike

Vlerë parametrike quhet vlera e normës e vendosur për çdo parametër që do të monitorohet.

- Përqendrimi i një lënde që nuk shkakton risk për shëndetin e konsumatorit.
- Uji që plotëson kriteret e normës konsiderohet i përshtatshëm për pirje, për gatim, për përdorim familjar.
- Kur vlerat nuk janë brenda normës tregon që në sistemin e furnizimit me ujë ka një problem i cili kërkon ndërmarrje te veprimeve korrekte.
- Në rastin e evidentimit të një problematike kërkohet një bashkëpunim ndërinstitucional.

- Investigohet për zbulimin e shkakut nga ndërmarrja e UK Sh.A ne bashkëpunim dhe informim te institucioneve shëndetësore.
- Merren masa për evitimin e dëmtimit.
- Kërkohet ndihma dhe konsultimi me specialistët e shëndetit publik.
- Kërkohet vlerësimi i problematikës nga ISHSH.
- NjVKSh-të informojnë dhe rekomandojnë popullatën në rastet kur konstatohet ndotje.
- NjVKSh-të dhe DROSHKSH marrin informacion mbi rastet e paraqitura në QSH dhe Spital për shërbim mjekësor.
- Bashkia merr masa për furnizimin alternativ të qytetarëve.
- NjVKSh-të njoftojnë popullatën për moskonsum të ujit për pirje apo përdorimin e tij për përgatitje te ushqimit deri në sigurimin e cilësisë së dhe sigurisë se tij.

Në rast të konstatimit të ndotjes dhe furnizimi me ujë të pijshëm përbën një rrezik për shëndetin publik ISHSH vendos kufizimin ose ndalimin e përdorimit të ujit të pijshëm për popullatën.

Në këto raste është me rëndësi:

1. Njoftimi i shpejtë i popullatës së zonës përkatëse.
2. Furnizimi me ujë me mjete të tjera.
3. Njoftimi i organeve të specializuara për qartësimin e situatës dhe rivendosjen e situatës normale të funksionimit.

Zonat e mbrojtjes sanitare

Zona e mbrojtjes sanitare është krijuar e domosdoshme që të përjashtojë efektet e dëmshme që mund të vijnë ne territorin përreth burimit, depove etj.

Qëllimi kryesor i zonave të mbrojtjes sanitare është mbrojtja e burimit të furnizimit me ujë nga ndotja.

- Zonat e mbrojtjes sanitare përcaktohen përreth burimeve sipërfaqësore ose nëntokësore që përdoren për prodhimin e ujit të pijshëm.
- Zonat e mbrojtjes sanitare synojnë ruajtjen e cilësisë së ujit dhe mbrojtjen nga dëmtimet të veprave të marrjes së ujit.

- Kërkesat higjieno sanitare për zonat e mbrojtjes sanitare dhe detyrimet duhet të respektohen nga U K.
- Administratori është i detyruar të ruajë zonat e mbrojtjes sanitare dhe ndërhyr në çdo rast kur konstaton shkelje brenda territorit të tyre. Ai informon organet e qeverisjes vendore, që sipas rastit kërkojnë edhe ndihmën e organeve të ruajtjes së rendit. Njëkohësisht informon edhe NjVKSh-të.

Për burimet ujore që lidhen me sistem të furnizimit me ujë parashikohen 3 zona të mbrojtjes sanitare.

- zona imediate ose e rreptësisë së mbrojtjes sanitare,
- zona e afërt e mbrojtjes sanitare,
- zona e largët e mbrojtjes sanitare.

Në rastin e furnizimit me ujë nga një pus individual, pronari i pusit kërkon drejtpërdrejt nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar apo një subjekt i licencuar në fushën e hidrogeologjisë, përcaktimin e zonave të mbrojtjes sanitare sipas kërkesave të akteve ligjore në fuqi.

Rezervuarët (Depot):

- Duhet të ketë një depo të sigurt dhe të besueshme për ujin në çdo ujësjellës.
- Administratori merr masa që asnjë lëndë apo papastërti të mos kalojnë në ujin e pijshëm.
- Rezervuarët duhet të kenë kapacitetin e duhur për të furnizuar popullatën me ujë të klorinuar.
- Rezervuari, depoja e ujit duhet të jetë e mbuluar për të parandaluar kontaminimin dhe të pastrohet mbi bazën e procedurave të rregullta.
- Cilësia e ujit në depo duhet të testohet rregullisht.

Procesi i trajtimit:

- Procesi i trajtimit pastrues nuk duhet të lejojë të kalojë asnjë lëndë që mund të ndotë ujin ose të përkeqësojë cilësinë e tij me rrezik për shëndetin e popullatës.

- Trajtimi i ujit mbron konsumatorët nga rreziqet shëndetësore të shkaktuara nga agjentët biologjikë dhe kimikë.
- Trajtimi varet nga cilësia e ujit në vendburim.

Sistemi i centralizuar i furnizimit me ujë përbëhet nga :

- Kaptazhet
- Stacioni i trajtimit
- Stacioni i pompave
- Rrjeti i jashtëm (burim-depo)
- Depot
- Rrjeti i shpërndarjes deri te konsumatori
- Sistemet e telematjes e telekomandimit
- Laboratorët e kontrollit të cilësisë së ujit të pijshëm.

Dezinfektimi

Për dezinfektimin e ujit përdoren lëndët e trajtimit të ujit, Hipokloriti i Calciumit ose Hipokloriti i Natriumit.

Një parametër kyç është klori i lirë i mbetur në pikat e monitorimit prej 0,5 mg/l. Koha e kontaktit është të paktën 30 minuta dhe është për të maksimizuar mundësinë e vrasjes së çdo patogjeni që mund të hyjë në sistemin e furnizimit me ujë pasi uji të jetë trajtuar dhe para se të konsumohet nga konsumatorët.

Në një sistem të mirëmbajtur, veçanërisht një të ri, dhe ku ujërat e zeza dhe mbetjet e tjera njerëzore dhe shtazore menaxhohen me kujdes dhe hidhen larg furnizimit me ujë, shanset për hyrjen e patogjenëve janë të ulëta. Sidoqoftë, rreziku ekziston, prandaj duhet të zbatohet legjislacioni.

Megjithatë, në të njëjtën kohë, një mbetje e klorit të lirë prej më shumë se 0,5 mg/l ndoshta do ta bëjë ujin të papëlqyeshëm për konsumatorët dhe mund ti bëjë ata të përdorin furnizime me ujë të pambrojtur dhe të paklorinuar, duke vënë në rrezik shëndetin e tyre. Kjo kërkon testimin e ujit në pikat brenda sistemit, përveç kur del nga rezervuari i trajtimit.

Procedura për parametrat që do të testohen në vend (ujësuellës)

Një procedurë e rekomanduar e kampionimit për parametrat që do të testohen në vend - ngjyra, aroma, shija, pH, temperatura, turbullira, plus klorig i lirë i mbetur është :

1. Hapeni rubinetin plotësisht
2. Lëreni ujin të rrjedhë plotësisht për rreth 1-3 minuta. Kur kjo të ndodhë, rregulloni rrjedhën në një rrjedhje të ulët të qëndrueshme dhe mbajeni atë derisa të përfundojë marrja e mostrave. Mos e rregulloni përsëri rrjedhën ose mos e mbyllni rubinetin derisa të mblidhen të gjitha mostrat.
3. Mblidhni ujin me kujdes direkt në enë, qelizë testuese, etj., siç kërkohet nga testi. Përveç nëse udhëzohet ndryshe, shpëlajeni enën, qelizën e provës, etj., disa herë me ujë që po testohet.
4. Testoni menjëherë: ngjyrën, aromën, shijen (përdor shqisat), pH, temperaturën, turbullirën, klorin e lirë të mbetur (përdorni pajisjet përkatëse të provës). Era testohet menjëherë pas hapjes së një ene të mbyllur që përmban një mostër të tundur. Shija përcaktohet me gojë, nga një gotë e hapur ose filxhan. Mund të gëlltitet vetëm nëse uji është i sigurt për tu pirë.
5. Konteinerët, të cilat do të përdoren për marrjen e kampionëve të ujit, para përdorimit të tyre, do të sterilizohen në autoklavë jo më pak se 15 minuta në 121°C, ose do të përdoren shishe sterile, plastike një përdorimshe.
6. Regjistroni rezultatet në raportin e kampionimit.

Dezinfektimi i kaptazheve dhe rezervuarëve

Pastrimi i objektit fillon me heqjen e llumrave që mund të kenë dekantuar në dysheme, pastrimin e mureve dhe larjen e dyshemesë me ujë.

- Dezinfektimi i mureve dhe i dyshemesë bëhet me furçë të lagur me solucion të përqendruar të klorit me përmbajtje 100 mg/l klor aktiv.
- Kur dezinfektimi kryhet me përdorimin e pompës spërkatëse, përqendrimi i klorit merret 200–250 mg/l klor aktiv.
- Pas dezinfektimit bëhet shpëlarja e objektit.
- Dezinfektimi i objektit bëhet si më sipër duke përdorur solucion klorig.⁽³⁾

Dezinfektimi i linjave

Ndërtimi i linjave të reja të ujësjellësit, rikonstruksionet e tyre, vendosja e armaturave të ndryshme në sistemin e ujësjellësit shoqërohet me ndotjen e tyre. Për të evituar ndotjen e ujit, përpara vënies së tyre në punë, linjat pastrohen dhe dezinfektohen.

- Pastrimi bëhet me ujë me presion të lartë.
- Pastrimi vazhdon deri sa uji në tubacion të jetë i pastër.
- Zakonisht pastrimi vazhdon jo më pak se 2 orë.
- Dezinfektimi i linjave bëhet me solucion klorig, doza e të cilit merret në varësi nga koha e kontaktit.
- Për dezinfektimin me një kohë kontakti të solucionit me tubin prej 8 orësh, duhet që doza e klorit të merret 100 mg/l.
- Për dezinfektimin me një kohë kontakti të solucionit me tubin prej 12 orësh, duhet që doza e klorit të merret deri në 60 mg/l.
- Për dezinfektimin me një kohë kontakti të solucionit me tubin prej 24 orësh, duhet që doza e klorit të merret 20–30 mg/l.
- Pas dezinfektimit, tubacioni zbrazet nga uji dhe bëhet përsëri shpëlarja me ujë të pastër pa ndërprerje për 6 orë deri sa të largohet era e klorit.
- Dezinfektimi i rrjetit të brendshëm të furnizimit me ujë të godinave që ndërtohen të reja ose që rikonstruktohen bëhet me solucion klorig me dozë 15–20 mg/l për kohë kontakti prej 8 orësh.
- Për rrjetin e brendshëm të furnizimit me ujë të godinave bëhet shpëlarja e sistemit të tubacioneve përpara dhe mbas dezinfektimit.
- Pas dezinfektimit dhe shpëlarjes së kaptazheve, rezervuarëve, linjave të ujësjellësit, bëhet analiza bakteriologjike.
- Miratimi për vënien në punë të objekteve të ujësjellësit, bëhet nga ISHSH-ja, pas verifikimit të cilësisë së ujit të pijshëm.⁽³⁾

Pikat e hyrjes

Veprat e marrjes së ujit, Kaptazhet, Depot, Rezervuarët mirëmbahen në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike nga administratori. Algat ose bimët e tjera ujore që rriten në këto objekte hiqen dhe më pas sipërfaqet dezinfektohen me solucion hipokloriti. Territoret e veprave të marrjes së ujit rrethohen dhe hyrja në brendësi të tyre bëhet vetëm me autorizim të administratorit të objektit.

Përfaqësuesit e autoritetit shëndetësor, me detyrë kontrollin sanitar apo inspektimin sanitar, kanë të drejtë të hyjnë në brendësi të territorit pa autorizim, duke njoftuar paraprakisht administratorin. Në hyrje të objektit të ujësjellësit, kaptazh, stacion pompimi, rezervuar etj, vendosen vaska me solucion 5% të hipokloritit të kalciumit ose të natriumit, për dezinfektimin e këpucëve, çizmeve etj.

Rezervuarët e ujit të pijshëm kontrollohen për rrjedhje dhe pastrohen e dezinfektohen në mënyrë periodike. Për mbrojtjen nga korrozioni prej lëndëve kimike dhe agjentëve atmosferikë në kaptazhe, në veprat e trajtimit, stacionet e pompimit, dhomat e manovrimit, në rezervuarë, në pusetat e manovrimit, të tubacioneve sipërfaqësorë dhe saraçineskave, bëhet lysterja me bojë kundër ndryshkut, e destinuar për lysterjen e kontejnerëve të ujit të pijshëm, periodikisht dhe rast pas rasti.

Pusetat e kontrollit, manovrimit dhe ajrimit pastrohen në mënyrë periodike. Për të evituar futjen e ujërave nëntokësore bëhet izolimi i pusetave të ujit. Administratori kontrollon vazhdimisht rrjetin shpërndarës të ujësjellësit për gjetjen dhe eliminimin e defekteve. Administratori merr në konsideratë të gjitha njoftimet për defekte të zbuluara nga qytetarët apo organet e qeverisjes vendore dhe të referuara në NJVKSH. Eliminimi i defekteve bëhet menjëherë sapo ai konstatohet/merret njoftimi.

Administratori merr masa për minimizimin deri në eliminimin e plotë të ndotjes në rast të konstatimit të saj. Defektet regjistrohen në një regjistër të veçantë ku vendosen elementet identifikuese të defektit: adresa e plotë, koha e konstatimit/njoftimit, kush njofton, kur është eliminuar defekti dhe kush i ka kryer punimet.

Rekomandime shtesë

- Duke pasur parasysh kostot e larta të funksionimit dhe mirëmbajtjes, rekomandohet të shmangen, sa më shumë që të jetë e mundur, ndërtimet të tilla në infrastrukturën e ujësjellësve që kërkojnë pompa.
- Rekomandohet përdorimi i shpateve natyrore të tokës për të projektuar furnizimin me ujë, me rrjedhje natyrore.
- Rekomandohet përdorimi i tubave të polipropilenit (PPR) dhe klorurit polivinil (PVC) si për rehabilitim punime dhe projekte të reja ndërtimi.
- Rekomandohet të ndiqen udhëzimet dhe standardet e OBSH-së për cilësinë e ujit të pijshëm.

Furnizimi me ujë në rast të përmytjeve

Gjatë ndryshimeve klimatike burimet ujore mund të pakësojnë prurjet, burimet mund të shterohen dhe kërkesat e tepërta nga një grup njerëzish mund të kufizojnë furnizimet për fqinjët e tyre. Probleme të tilla përjetohen gjithashtu në vendet e industrializuara ku menaxhimi i kërkesës ka dështuar ose rritja e popullsisë ka tejkaluar zhvillimin e burimeve ujore. Nga ana tjetër, në rast të reshjeve intensive (permytjeve) duhet të sigurohet mbajtja nën kontroll e situatës higjieno sanitare të ujit të pijshëm dhe të komunikohet nëpërmjet insitucioneve të shëndetit publik me popullatën.

Nëse uji është i pasigurt:

- Të mos përdoret për të pirë.
- Të mos përdoret për të larë enët.
- Të mos përdoret për të larë dhëmbët.
- Të mos përdoret për të larë dhe përgatitur ushqim.
- Të mos përdoret për të larë duart.
- Të mos përdoret për të bërë akull.
- Të mos përdoret për të përgatitur formula apo produkte ushqimore për bebe.

Disa masa për sigurinë e cilësisë së ujit për konsum human nga sistemet e centralizuara të furnizimit me ujë dhe puseve individuale.

Emergjencat që lidhen me ujin mund të shkaktojnë çrregullime dhe sëmundje në mbarë komunitetin nëse uji është i ndotur me mikrobe, kimikate ose toksina.

Emergjencat e lidhura me ujin mund të krijohen nga katastrofa natyrore si uraganet, përmbytjet, thatësit, fatkeqësitë e shkaktuara nga njeriu, të tilla si derdhjet kimike ose shpërthimet e sëmundjeve të shkaktuara nga uji.

Shumë sëmundje mund të parandalohen:

- duke krijuar dhe ruajtur një furnizim me ujë për situatë emergjence.
- duke ditur se si të bëhet uji i sigurt.
- duke ditur rreth këshillave të ujit të pijshëm.
- duke ditur praktikat e higjienës gjatë një emergjence.

Uji i sigurt në situata emergjente arrihet nga :

- Vlimi,
- Dezinfektimi,
- Përdorimi i tabletave kimike për të dezinfektuar ujin,
- Filtrimi,
- Metoda të tjera

Në rast se konstatohet përmbytje e veprave të trajtimit të ujit, duhet të komunikohet menjëherë me SHUK, NJVKSH-ën dhe ISHSH-në për të ndaluar furnizimin me ujë për konsum human deri në vlerësimin me analiza për cilësinë e ujit të rrjetit.

Duhet të kryhet kontrolli i cilësisë së ujit të pijshëm çdo ditë në të gjitha pikat e përcaktuara në skemën e monitorimit dhe sipas Akt-Marrëveshjes ndërmjet NJVKSH-së dhe SHUK, si dhe të shtohen pikat monitoruese në rrjetin shpërndarës të ujësjellësit.

Duhet të kryhet vlerësimi higjieno-sanitar në veprat e ujësjellësit nga burimi në pikat fundore dhe në rast të konstatimit të problemeve gjatë ekspertizës të komunikohet menjëherë me SHUK, ISHSH dhe ISHP.

Duhet të kontrollohet 2 herë në ditë (në mëngjes dhe pasdite).

- Niveli i klorit të lirë mbetës duhet të mbahet në vlerat maksimale të lejuara, duke respektuar VKM 379 datë 25.05.2016 “Cilësia e Ujit të Pijshëm”. (Aneksi 1. Tabela e referencës së klorit mbetës në pikat fundore).
- Duhet të bëhet vlerësimi i nevojave për lëndë dezinfektante (Hipoklorit Natriumi dhe Hipoklorit Calciumi), për nevojat emergjente të ujësjellësve të dëmtuar, për proceset e dezinfektimit (mjedise publike, shtëpi, grupa septike/puseta të inonduara, puse etj...).
- Lënda dezinfektante duhet të përmbushë kërkesat bazuar në standardin shqiptar: “Për kimikatet që përdoren për trajtimin e ujrave të destinuara për konsum njerëzor”, për të garantuar dezinfektim të sigurtë, për furnizim me ujë bakteriologjikisht të pastër.

E rëndësishme

Uji që ka lëndë djegëse, kimikate toksike ose lëndë radioaktive nuk do të bëhet i sigurtë nga zierja apo dezinfektimi.

Të përdoret ujë i ambalazhuar ose një burim tjetër uji nëse e dimë ose dyshojmë se uji mund të jetë i kontaminuar me lëndë djegëse ose kimikate toksike.

- NJVKSH duhet të komunikojë në vazhdimësi me ndërmarrjen e ujësjellësit mbi rezultatet analitike mikrobiologjike, fiziko-kimike dhe për nivelet e klorit të lirë mbetës në pikat e monitorimit të rrjetit shpërndarës të ujësjellësit.
- Në rast konstatimi të nivelit të klorit të lirë mbetës (nën nivelet e rekomanduara) apo mungesë të tij duhet të komunikohet menjëherë me ndërmarrjen e ujësjellësit, Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor, lihen detyra dhe merren masa.

Burimi i ujit të transportuar me autobusë

Furnizimi i popullatës me ujë të transportuar me autobusë përdoret në raste emergjence ose në disa situata kur kjo mënyrë furnizimi është e vetmja mundësi e vlefshme. Në raste të transportit të ujit me autobusë përparësi ka sigurimi i mbrojtjes së shëndetit publik. Subjektet e autorizuara të cilat planifikojnë të transportojnë ujë të pijshëm me autobusë, fillimisht kontaktojnë me strukturat e ISHSH-së për pajisjen me aktmiratim higjieno sanitarë për autobusin.

Uji për furnizimin e autobotëve merret nga sistemi i ujësjellësit që furnizon me ujë popullatën. Në rast përdorimi të një burimi tjetër uji, si burim natyral apo pus shpimi, subjekti i licencuar (*sipas vkm 379 e ka kuptimin për subjekte që kanë licence për përdorim autobotesh*) duhet të pajiset me leje nga Këshilli i Basenit Ujor (KBU).

Kontejneri i autobotit

Kërkesat teknike dhe higjieno sanitare të kontejnerit:

- Kontejneri i autobotit duhet të jetë i pastër dhe i mirëmbajtur në mënyrë që të parandalohet ndotja e ujit të pijshëm.
- Materiali i veshjes së brendshme duhet të respektojë kërkesat për sigurimin e cilësisë së trajtimit, duhet të jetë lehtësisht i pastrueshëm dhe i dezinfektueshëm.
- Gjithë pjesa e brendshme e kontejnerit duhet të jetë lehtësisht e inspektueshme.
- Pjesa e brendshme e kontejnerit kontrollohet, shpëlahet me ujë të dezinfektuar, mbushet me ujin që do të transportohet dhe testohet nga ana mikrobiologjike.
- Testimi fillestar duhet të tregojë mungesën e mikroorganizmave përpara se autoboti të përdoret për transportin rutinë të ujit.
- Pasi ka filluar procesi i transportit rutinë dhe janë marrë masat për parandalimin e ndotjes, nuk ka nevojë të përsëritet testimi gjatë periudhës së përgjigjes ndaj emergjencës.
- Nuk lejohet të përdoren autobotët të cilët pas dezinfektimit nuk kalojnë testin fillestar.
- Nuk lejohet të përdoren për transportimin e ujit të pijshëm autobotët e përdorur për transportimin e lëndëve toksike ose lëngjeve të tjera jo të pijshme.
- Të gjithë kontejnerët mbushen ose zbrazen nëpërmjet një vrime ajri ose një dopio valvule kontrolli.
- Nyjat për mbushjen dhe zbrazjen e kontejnerit mbrohen për parandalimin e futjes së ndotësve.
- Kontejneri duhet të mbahet i vulosur ose i kyçur dhe kapaku ose kapanxha duhet të puthitet plotësisht.
- Nuk lejohen të përdoren për transportimin e ujit të pijshëm kontejnerët që kanë komunikim me atmosferën.

Përgatitja e autobotit

Preferohet që autobotët e ujit të përdoren vetëm për transportimin e ujit të pijshëm. Nëse autoboti është përdorur për transportimin e lëndëve jo të rrezikshme, duhet që ai të pastrohet dhe dezinfektohet përpara se të mbushet me ujë të pijshëm, në mënyrë që të sigurohet cilësia e ujit të pijshëm të furnizuar prej tyre.

Përgatitja e autobotit kalon në tre hapa:

Hapi 1. Pastrimi i kontejnerit

Kontejneri duhet të pastrohet për të siguruar që uji në të nuk ndotet me papastërtitë apo gjurmët e lëndës që ai ka mbartur më parë. Kjo arrihet me procedurën e mëposhtme:

1.1 Boshatisja e kontejnerit

Hapet kapaku/valvola e shkarkimit dhe zbrazet lëngu i mbetur, i cili grumbullohet për t'u shkarkuar në mënyrë të sigurt. Shumica e kontejnerëve e kanë valvolën e shkarkimit në pjesën e pasme, kështu që rekomandohet parkimi i tij në një vend të pjerrët në mënyrë që të zbrazet i gjithë lëngu.

1.2 Pastrimi i sipërfaqeve të brendshme

Për pastrimin e sipërfaqeve të brendshme të kontejnerit përdoret një përzierje detergjenti me ujë. Pastrimi bëhet me një furçë të fortë ose me presion të lartë. Nëse kontejneri ka mbartur lëndë volatile, si vaj apo lëndë organike si qumësht, nuk duhet hyrë në kontejner për arsye se gazrat që dalin mund të jenë të rrezikshme. Qoshet dhe lidhjet duhen pastruar me kujdes të veçantë në mënyrë që të mos mbetet asnjë sasi sado e vogël e lëngut të mëparshëm. Gjatë pastrimit, valvola e shkarkimit lihet hapur dhe mbetjet grumbullohen për t'u shkarkuar në mënyrë të sigurt.

1.3 Shpëlarja e sipërfaqeve të brendshme

Shpëlarja e sipërfaqeve të brendshme bëhet për të larguar të gjitha gjurmët e detergjentit. Ajo kryhet më lehtësisht me ujë me presion, por në mungesë, kontejneri mbushet me ujë dhe lihet të qëndrojë për disa orë. Zbrazet i gjithë uji nga kontejneri dhe grumbullohet për t'u shkarkuar në mënyrë të sigurt si më parë. Shpëlarja e kontejnerit vazhdohet deri sa të mos ketë më gjurmë të

detergjentit në ujë. Boshatisja e kontejnerit dhe pastrimi i kontejnerit duhet të bëhet në vende të hapura, larg shtëpive me qëllim shmangien e problemeve të mundshme për shëndetin.

Hapi 2. Dezinfectimi i kontejnerit

Për një dezinfektim sa më efektiv të kontejnerit:

- Mbushet kontejneri me ujë të pastër deri në $\frac{1}{4}$ e volumit.
- Përgatitet tretësira e klorit, Për këtë përdoret hipoklorit kalciumi, pluhur, që normalisht përmban 50 deri 70% klor.
- Shtohet tretësira e klorit ngadalë dhe duke e përzier, mbushet kontejneri me ujë të pastër deri në maksimum.
- Tretësira e klorit mbahet në kontejner për të paktën 24 orë dhe kapaku i kontejnerit mbahet i mbyllur.
- Nëse kontejneri kërkohet të përdoret urgjentisht, dyfishohet sasia e klorit të shtuar në kontejner. Kjo e redukton kohën e qëndrimit nga 24 në 8 orë.
- Zbrazet plotësisht kontejneri dhe bëhet shkarkimi i sigurt i tretësirës së klorit me që ajo ka përqendrim të lartë të klorit, që dëmton peshqit dhe bimësinë ujore.
- Në disa raste, për të larguar klorin përpara se uji i klorinuar të derdhet, mund të trajtohet me acid citrik ose tiosulfat.

Të gjithë tubat, pompat dhe pajisjet e tjera që përdoren në transportimin e ujit, dezinfektohen me të njëjtën procedurë të përshkruar më lart.

Hapi 3. Testimi i ujit për transportim

- Pasi është zbrazur plotësisht, kontejneri rimbushet me ujë të pastër për t'u transportuar, lihet 30 minuta dhe testohet për klorin e lirë mbetës dhe për mikroorganizma.
- Nëse përqendrimi i klorit të lirë mbetës është 0.5 mg/l, atëherë kontejneri është i sigurt të përdoret për transportimin e ujit të pijshëm. Përndryshe, zbrazet përsëri kontejneri dhe rimbushet me ujë të pastër.
- Ritestohet për të kontrolluar nëse përqendrimi është 0.5 mg/l.
ose më pak, kete pjese mendoj ta heqim pasi nuk ka vlere fikse dhe shkakton luhatje.??
- Nëse mikroorganizmat janë të pranishme, përsëritet procesi.

- Nëse kontejneri nuk mund të dezinfektohet deri në eliminim të mikroorganizmave ai nuk lejohet të përdoret.
- Uji që përdoret për përgatitjen e formulës së bebeve
Rekomandohet ushqyerja vetëm me gji për foshnjat deri gjashtë muajsh por nëse përdoret formula, duhet **përdorur ujë i sigurt**, apo përgatitjen e ushqimit të fëmijëve kur janë duke u yshqyer me ushqim plotësues.

Disa masa për sigurinë e cilësisë së ujit të pus-shpimeve familjare

- Puset e cekëta dhe ato në zonat afër detit/lumenjve mund të kontaminohen nga përmytjet.
- Në rast se konstatohet përmytje e puseve duhet të mos konsumohet uji deri sa të bëhet testimi për ujë të sigurt (deri në kryerjen e analizave).
- Duhet të mos konsumohet ujë nga pusi pas përmytjes, deri sa uji të dezinfektohet dhe të testohet për sigurinë e tij.
- Pas përmytjes së pusit, uji duhet të zihet ose të dezinfektohet plotësisht me metodë kimike, pastaj të testohet për sigurinë e tij.

Dezinfektimi i puseve

Ashtu si veprat e tjera të ujësjellësit, edhe puset individuale ose kolektive, që shërbejnë për furnizimin me ujë të pijshëm të popullatës, u nënshtrohen rregullave të higjienës. Ato pastrohen, mirëmbahen dhe dezinfektohen herë pas here.

- Muret e puseve duhet të pastrohen, lahen me solucion klori që përmban 100 mg/l klor aktiv.
- Solucioni për dezinfektim duhet të përgatitet duke tretur rreth 40 g hipoklorit kalciumi (me 25% klor aktiv) në 100 litra ujë.
- Pasi matet vëllimi i ujit në pus, duhet të hidhet solucioni duke llogaritur që përmbajtja e klorit aktiv të arrijë 50–100 mg/l dhe të ketë shpërndarje uniforme.
- Uji në pus duhet të lihet të qëndrojë në këtë gjendje rreth 12 orë dhe pastaj nxirret me pompë ose me kovë për t'u riqarkulluar.

Tabela 1 Sasi të e hipoklotit të kalciumit të përdorur për dezinfektimin e ujit të puseve (gr/m³)

Përqindja e klorit aktiv	Volumi i ujit në pus m ³															
	Doza a= 2 mg/l (gr/m ³)				Doza a= 4 mg/l (gr/m ³)				Doza a= 8 mg/l (gr/m ³)				Doza a= 10 mg/l (gr/m ³)			
	V=3 m ³	V=5 m ³	V=7 m ³	V=10 m ³	V=3 m ³	V=5 m ³	V=7 m ³	V=10 m ³	V=3 m ³	V=5 m ³	V=7 m ³	V=10 m ³	V=3 m ³	V=5 m ³	V=7 m ³	V=10 m ³
17	35,3	58,8	82,3	118	71	117	165	235	141	236	329	472	177	295	411	588
20	30	50	70	100	60	100	140	200	120	200	280	400	150	250	350	500
25	24	40	56	80	48	80	112	160	96	160	224	320	120	200	280	400
30	20	33	47	67	40	67	94	134	80	132	188	268	100	165	231	335
35	17	29	40	57	34	57	80	114	69	116	160	228	87	145	203	285
40	15	25	35	50	30	50	70	100	60	100	140	200	75	125	175	250
50	12	20	28	40	24	40	56	80	48	96	112	160	60	100	140	200

Format e sistemeve individuale te ujërave te përdorura

- Latrinat me grope te thjeshte
- Latrina me grope te ajrosur
- Latrina me larje me ujë
- Latrin e thjeshte ose me dy gropa
- Gropa septike
- Rrjeti i kanalizimeve

Udhëzimet për furnizimin me ujë, kanalizimet dhe higjienën në objektet e kujdesit shëndetësor

1. Furnizimi me ujë në objektet e kujdesit shëndetësor

1.1 Burimi i ujit

Objektet e kujdesit shëndetësor

- Duhet të kenë gjithmonë furnizim me ujë, (d.m.th. ujë gjatë gjithë vitit dhe të pandikuar nga sezonaliteti stinor, ndërprerjet e energjisë elektrike, etj.)
- Duhet të kenë burime uji të sigurta si: tubacione, pusin të mbrojtur, burimin e mbrojtur, ujin e ambalazhuar ose të dorëzuar nga një furnizues i licencuar.

- Duhet të kenë rubinete uji të disponueshme në të gjitha pikat e kujdesit (p.sh. dhomat e konsultave, dhomat e lindjes, etj., për të lejuar lehtësinë e qasjes në ujë të pijshëm, larjen e duarve, tualeteve, për higjienën personale, përgatitjen e ushqimit, lavanderi, pastrim dhe kopshtari.
- Duhet të kenë tubacione funksionale (d.m.th. të mos ketë rrjedhje të mëdha dhe të gjitha pikat fundore të jenë të lidhura me furnizimin me ujë).
- Duhet të kenë ujë të pijshëm në çdo kohë, në dispozicion të stafit dhe pacientëve, duke përfshirë fëmijët dhe njerëzit me lëvizshmëri të kufizuar.
- Duhet të ketë një burim dytësor uji që mund të përdoret në rast të ndërprerjeve në burimin parësor të ujit.

1.2 *Sasia e ujit*

- Sasia aktuale e ujit do të varet nga një sërë faktorësh si klima, disponueshmëria, lloji i objektit, numri i pacientëve, niveli i kujdesit dhe praktikat e përdorimit lokal të ujit.
- Duhet të disponohen sasi të mjaftueshme uji për të përmbushur kërkesat minimale ditore për pacientët, vizitorët dhe personelin.

1.3 *Ruajtja e ujit*

- Objektet e kujdesit shëndetësor duhet të kenë një rezervuar për ruajtjen e ujit që të ketë kapacitetin për të furnizuar objektin me ujë për dy ditë të plota. Ai do të përdoret si rezervë në rast ndërprerjesh në burimin kryesor të ujit.
- Rezervuarët e magazinimit duhet të jenë të pastër, të mbuluar me kapak të ngushtë dhe të mirëmbahen mirë për të parandaluar ndotjen (d.m.th. pa ndonjë, çarje, rrjedhje, etj.).
- Rezervuari për ruajtjen e ujit duhet të lejojë që uji të nxirret pa ndotur sipërfaqet që prekin ujin (p.sh. nëpërmjet përdorimit të një rubineti).

1.4 *Kualiteti i ujit*

Për një institucion shëndetësor janë të nevojshme, dy nivele të cilësisë së ujit.

1. Uji i pastër: uji i përdorur për të pirë, larjen e duarve, tualeteve, higjienën personale, përgatitjen e ushqimit, lavanderi, pastrim dhe kopshtari.

2. Uji i sterilizuar: uji i përdorur për qëllime specifike mjekësore, në dezinfektimin e pajisjeve mjekësore, dializë, kirurgji, operacione dentare dhe pajisjet e frymëmarrjes (p.sh. respirator, aparat lagështues, etj.)

2. Saniteti në objektet e kujdesit shëndetësor

Higjiena e sigurt është thelbësore për shëndetin, duke filluar me parandalimin e infeksioneve, përmirësimin dhe ruajtjen e mirëqenies mendore dhe sociale. Mungesa e kanalizimeve të sigurt rrit mundësinë për të shkaktuar diarre.

Diarretë janë shqetësime kryesore të shëndetit publik dhe një shkak kryesor i sëmundjeve, vdekjeve tek fëmijët nën pesë vjeç në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme.

Higjiena e ulët gjithashtu kontribuon në sëmundje të transmetueshme të cilat favorizohen dhe nga kequshqyerja. Mungesa e aksesit në objektet e përshtatshme higjienike është gjithashtu një shkak kryesor i rreziqeve dhe ankthit, veçanërisht për gratë dhe vajzat. Higjiena, ndihmon dhe parandalon sëmundjet dhe siguron privatësinë dhe dinjitetin dhe për të gjitha këto arsye, është e njohur si një e drejtë themelore e njeriu.

Higjiena përkufizohet si aksesit dhe përdorimi i objekteve dhe shërbimeve për asgjësimin e sigurt të urinës dhe feçeve njerëzore. Një sistem sanitar i sigurt është një sistem i projektuar dhe përdorur për të ndarë jashtëqitjet njerëzore nga kontakti njerëzor në të gjitha hapat e zinxhirit të shërbimit sanitar duke filluar nga hapja dhe kontrolli i tualetit përmes zbrazjes, transportit, trajtimit dhe asgjësimit përfundimtar

Sistemet e sigurt të kanalizimeve duhet të plotësojnë kërkesat e nevojshme në mënyrë që të jenë në përputhje me të drejtat e njeriut, duke adresuar gjithashtu bashkë-depozitimin e ujërave të përdorur, praktikat shoqëruese të higjienës dhe shërbimet thelbësore të kërkuara për funksionimin e teknologjive.

Higjiena në objektet e kujdesit shëndetësor i referohet sistemeve të kanalizimeve për ujërat e zeza, të menaxhuara në mënyrë të sigurt dhe ujërave të pandotura.

Nëse institucioni i kujdesit shëndetësor ndodhet në një zonë të prirur për përmbytje kërkohet që:

1. Objektet higjienike duhet të projektohen që të jenë rezistente ndaj përmbytjeve.
2. Objektet sanitare duhet të vendosen të paktën 25 metra larg dhe më poshtë nga çdo burim uji.

Sistemet e kanalizimeve në ambientet e kujdesit shëndetësor përfshijnë tualete të rregullta dhe largimin e ujërave të zeza dhe ujërave të rrjedhjes siç përshkruhet më poshtë:

2.1. Tualete të rregullta

Objektet e kujdesit shëndetësor

- Duhet të kenë tualete të rregullta të vendosura në ambient ose brenda ndërtesës.
- Duhet të kenë tualete gjithmonë të disponueshme, funksionale dhe të pastra.
- Duhet të ketë të paktën një tualet të destinuar për burra dhe një për gra me ambiente për të menaxhuar nevojat e higjienës menstruale.
- Duhet të ketë të paktën një tualet që plotëson nevojat e personave me lëvizshmëri të kufizuar.
- Duhet të kenë tualete me strukturë shkarkimi.
- Duhet të ketë tualete në numër të mjaftueshëm për të plotësuar nevojat e të gjithë pacientëve, stafit dhe vizitorëve.
- Duhet të ketë të paktën katër tualete: një për stafin, një për femra, një për meshkuj dhe një për persona me lëvizshmëri të kufizuar.
- Duhet të ketë më shumë se katër tualete për objekte më të mëdha (p.sh. spitalet), kjo do të varet nga numri mesatar i personave/në ditë që e përdorin tualetin e institucionit.
- Duhet të ketë të paktën një tualet për çdo 20 përdorues (staf, pacientë, vizitorë dhe kujdestarë)
- Tualetet për femra duhet të jenë të pajisura me mundësi për menaxhimin e higjienës menstruale (d.m.th. një kosh me kapak për asgjësimin e pecetave higjienike dhe ujë e sapun në dispozicion për larje).
- Duhet të ketë një lavaman funksional për larjen e duarve brenda dhomës së tualetit ose jashtë në distancë prej pesë metrave.
- Uji duhet të jetë i disponueshëm gjatë gjithë kohës në tualet.
- Duhet të ketë tabela të qarta që tregojnë tualete për burra, për gra ose për persona me aftësi të kufizuara.
- Duhet të kenë derë që mund të mbyllet nga brenda gjatë përdorimit për të garantuar privatësi.
- Duhet të kenë dritë të mjaftueshme për të garantuar sigurinë dhe aksesin për përdorim gjatë natës.

- Duhet të paktën një tualet në institucionin e kujdesit shëndetësor që të plotësojë nevojat e personave me lëvizshmëri të kufizuar që të ketë këto vecori:
 - E arritshme pa shkallë.
 - Të ketë një shteg pa pengesa, nëse është jashtë ndërtesës.
 - Të ketë parrakë për mbështetje.
 - Të ketë hapësirë të mjaftueshme, për një karrige me rrota që të rrotullohet.
 - Dera duhet të jetë së paku 80 cm e gjerë.
 - Lartësia e sediljes së tualetit duhet të jetë ndërmjet 40 cm dhe 48 cm mbi dyshemenë e tualetit.
 - Të ketë hapësirë të mjaftueshme që kujdestari të ndihmojë dikë që përdor tualetin.
 - Të jetë i aksesueshëm lavamani, dhe pjesa e sipërme e lavamanit, duhet të jetë 75 cm nga dyshemeja.
 - Çelësat për dritat duhet të jenë në një lartësi të arritshme (maksimumi 120 cm).
 - Të ketë p.sh. litar udhëzues për njerëzit me një pamundësi pamje.

Largimi i ujërave të përdorura në objektet e kujdesit shëndetësor

Llojet e ujërave të përdorura

1. Uji i zi: ujërat e zeza që bartin jashtëqitje njerëzore.
2. Ujërat e përdorura : ujërat nga lavamanët, dushet dhe banjat.

Të gjitha rrjedhjet dhe ujërat e zeza duhet të hidhen shpejt dhe në mënyrë të sigurt dhe të menaxhohen në mënyrë të tillë që të shmangët kontaminimi i objektit të kujdesit shëndetësor dhe i mjedisit.

Menaxhimi konsiston në:

1. heqjen, 2. para-trajtimin 3. asgjësimin.

1. Largimi:

Për të shmangur ujërat e ndenjura, në vendin e trajtimit/depozitimit, duhet përdorur një sistem largimi për të transportuar ujin larg. Sipërfaqja e grumbullimit duhet të jetë me pjerrësi të butë të paktën në një shkallë prej 1%.

2.Trajtimi paraprak:

Nëse është e mundur, ujërat e përdorura duhet të drejtohen në një vend ku sistemi i kanalizimit është i lidhur me një impiant adekuat trajtimi. Nëse kanalizimi nuk çon në objekt trajtimi atëherë bëhet trajtimi paraprak nëpërmjet gropave septike. Ujërat e përdorura dhe ujërat e zeza mund të trajtohen në të njëjtin gropë septike për të eliminuar materialin fekal dhe çdo lëndë tjetër të ngurtë.

3.Derdhja:

Ujërat e zeza mund të derdhen (hidhen) përmes gropave, kanaleve të infiltrimit ose direkt në sistemet e kanalizimeve. Gropat nuk duhet të derdhen në ambientet e objekteve të kujdesit shëndetësor.

- Fundi i sistemeve të infiltrimit duhet të jetë së paku 1.5 m nga niveli i ujërave nëntokësore.
- Sistemi i infiltrimit duhet të jetë së paku 25 m larg nga çdo pus i ujërave nëntokësore.

4. WASH për institucionet e kujdesit shëndetësor

4.1 WASH për institucionet e kujdesit shëndetësor përfshin:

- Furnizimin me ujë.
- Kanalizimet.
- Higjienën.
- Pastrimin/dezinfektimin.
- Menaxhimi i mbeturinave.
- Menaxhimi i mjedisit.
- Menaxhimi i objektit.

4.2 Përmirësimet e WASH në objektet e kujdesit shëndetësor

Përmirësimet në nivel objekti në infrastrukturën dhe praktikat e sjelljes WASH duhet të synojnë:

- funksionim të aktiviteteve ekzistuese të objektit,
- parandalimi dhe kontrolli i infeksioneve,
- rezistenca antimikrobike,
- aktivitete të përmirësimit të kujdesit.

Rekomandime

Rekomandimet e mëposhtme janë dhënë për veprim nga autoritetet përgjegjëse.

Rekomandimi 1:

Sigurimi i aksesit universal dhe përdorimit të tualeteve që përmbajnë jashtëqitje të sigurta

1.a) Bazuar në qasjen universale tualetet duhet të jenë të sigurta që të eliminohen jashtëqitjet e hapura dhe të jenë përparësi e pushtetit lokal, duke siguruar që ofrimi i tyre të jetë i barabartë dhe në përputhje me parimet e të drejtat e njeriut për ujë dhe kanalizime.

1.b) Kërkesa dhe oferta e objekteve për shërbime sanitare duhet të adresohen për të siguruar adoptimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të tualetit.

1.c) Ndërhyrjet sanitare duhet të sigurojnë mbulimin e të gjithë komuniteteve me tualete të sigurta, dhe duhet të adresojnë pengesat teknologjike dhe të sjelljes.

1.d) Të gjitha objektet si shkollat, objektet e kujdesit shëndetësor, vendet e punës dhe vendet publike duhet të kenë akses për tualet të sigurt që, si kërkesë minimale, të përmbajë në mënyrë të sigurt jashtëqitje.

Rekomandimi 2:

Sigurimi i aksesit universal në sisteme të sigurta përgjatë të gjithë zinxhirit të shërbimit sanitar

2.a) Përzgjedhja e sistemeve të sigurta të kanalizimeve duhet të jetë specifike për kontekstin dhe t'u përgjigjet kushteve fizike, sociale dhe institucionale.

2.b) Përmirësimet progresive drejt sistemeve të sigurta të kanalizimeve duhet të bazohen në vlerësimin e rrezikut dhe qasjes për mire menaxhim (p.sh. Planifikimi i Sigurisë Sanitare).

2.c) Punonjësit e kanalizimeve duhet të mbrohen nga ekspozimi në punë nëpërmjet masave adekuate të shëndetit dhe sigurisë.

Rekomandimi 3:

Higjiena duhet të trajtohet si pjesë e shërbimeve të ofruara në nivel lokal dhe programeve e politikave më të gjera të zhvillimit.

3.a) Ndërhyrjet sanitare duhet të koordinohen me masat e ujit dhe higjienës, si dhe asgjësimin e sigurt të feçeve të fëmijëve dhe menaxhimin e mbetjeve të kafshëve shtëpiake dhe jashtëqitjeve të tyre për të maksimizuar përfitimet shëndetësore të kanalizimeve.

Rekomandimet plotësohen nga një sërë veprimesh praktike të mira për të ndihmuar të gjitha palët e interesuara të zbatojnë rekomandimet.

1. Duhet të përcaktohen politikat sanitare shumësektoriale të udhëhequra nga qeveria, proceset e planifikimit dhe koordinimin.
2. Sigurimi që menaxhimi i rrezikut shëndetësor të pasqyrohet siç duhet në legjislacionin, rregulloret dhe standardet sanitare.
3. Mbështetja e angazhimit të sektorit shëndetësor në kanalizime përmes stafit dhe resurseve të përkushtuara, dhe përmes veprimit për sanitare brenda shërbimeve shëndetësore.
4. Ndërmarrja e vlerësimit lokal të rrezikut të bazuar në shëndetin për t'i dhënë përparësi përmirësimeve dhe për të menaxhuar performancën e sistemit.
5. Mundësimi i marketingut të shërbimeve sanitare dhe zhvillimi i shërbimeve sanitare dhe modeleve të biznesit.

Parimet për zbatimin e ndërhyrjeve sanitare

Sistemet e sigurt të kanalizimeve duhet të adresojnë kërkesat minimale të mëposhtme për të garantuar sigurinë përgjatë çdo hapi të zinxhirit të shërbimit të kanalizimeve.

Termi 'tualet' i referohet ambientit të përdoruesit me sistemin e kanalizimeve, ku përmbledhen jashtëqitjet dhe në të përfshihet ndenjëse tualeti ose pllakë tualeti (pedestal, tigan ose uturak).

Ka disa lloje tualetesh, për shembull tualete me derdhje dhe sterna, tualete të thata dhe tualete që devijojnë urinën. Superstruktura e tualetit mund të jetë një strukturë e pavarur, ose tualeti mund të jetë i vendosur brenda një ndërtese (p.sh. shtëpi private, shkollë, institucion shëndetësor, vend pune ose mjedis tjetër publik)

Tualeti

- Projektimi, ndërtimi, menaxhimi dhe përdorimi i tualetit duhet të sigurojnë që përdoruesit të kenë kushte të përshtatshme dhe të sigurt higjienike.

- Pllaka e tualetit ose piedestali duhet të ndërtohen duke përdorur materiale të qëndrueshme që mund të pastrohen lehtësisht.
- Struktura e tualetit duhet të parandalojë depërtimin e ujërave të shiut, rrjedhjes së ujërave të stuhisë, kafshëve dhe insekteve. Ajo duhet të garantojë siguri dhe privatësi me dyer të cilat të mund të kyçen.
- Dizajni i tualetit duhet të përfshijë sigurimin e objekteve të përshtatshme për kulturën dhe kontekstin për pastrimin anal, larjen e duarve dhe menaxhimin e higjienës menstruale.
- Tualetet duhet të mirëmbahen mirë dhe të pastrohen rregullisht.

Mbajtja – ruajtja/trajtimi

Kur ujërat nëntokësore përdoren si burim uji i pijshëm, duhet të kryhet vlerësimi i rrezikut dhe duhet të sigurohet që ka një distancë të mjaftueshme vertikale dhe horizontale ndërmjet bazës së një kontejneri të depërtueshëm, gropës së njomjes ose fushës së kullimit dhe burimit të ujit të pijshëm (burimi i ujit të pijshëm të jetë mbi vendin e ndërtimit të tualetit (distancë vertikale) sugjerohet si rregull i përgjithshëm).

- Kur gropa septike mbushet kjo duhet të derdhet në kanalizim me tubacione. Nuk duhet të shkarkohet në një kullues të hapur, trup uJOR ose tokë të hapur.
- Kur produktet nga magazinimi ose trajtimi përpunohen në saj të proceseve teknologjike ato destinohen në vend të posaçëm për përdorim përfundimtar ose asgjësim.

Transporti

- Kudo që është e mundur zbrazja dhe transporti i motorizuar duhet të ketë përparësi ndaj zbrazjes dhe transportit manual.
- Të gjithë punëtorët duhet të trajnohen për rreziqet e trajtimit të ujërave të zeza, llumit fekal dhe procedurat standarde të funksionimit (PSV).
- Të gjithë punëtorët duhet të mbajnë pajisje mbrojtëse personale (p.sh. doreza, maska, kapele, pantallona të gjera dhe këpucë të mbyllura të papërshkueshme nga uji) veçanërisht kur kërkohet pastrim manual i kanalizimeve ose zbrazje manuale.
- Përmirësimi i strukturave të higjienës është me rëndësi kritike për të parandaluar sëmundjet infektive apo transmetimin e patogjeneve që gjenden në ujërat e zeza.

- Kontejnerët e mbeturinave duhet të projektohen dhe të ndërtohen në mënyrë të tillë që të mos ndotin mjedisin.
- Projektimi i strukturave të kanalizimeve duhet të jetë pjesë e planifikimit fillestar të ndërtimit të një objekti.
- Aty ku infrastruktura dhe shërbimet e kanalizimeve janë të papërshtatshme, duhet të planifikohet për ndërtimin e të reja ose përmirësimin e strukturave ekzistuese.
- Duhet të ventilohe nga dritaret ose ventilatorët/tubat e ventilimit.
- Duhet të jenë të përshtatura për fëmijët, gjininë, moshën dhe invaliditetin.
- Duhet të jenë të ndara sipas gjinisë (meshkuj, femra)
- Duhet të kenë ndriçim të përshtatshëm brenda dhe jashtë.
- Në tualetet duhet të ketë kosha të mbuluara me kapak për hedhjen e papastërtive.
- Në tualetet e femrave duhet të ketë kosha për hedhjen e papastërtive menstruale
- Në tualetet e meshkujve dhe të femrave duhet të sigurohen lavamanë ose kova uji për të përmbushur kërkesat e pastrimit anal dhe higjienës menstruale.
- Duhet të garantojë privatësinë.
- Duhet të sigurohen me çelësa të brendshëm, dhe duhet të ndahen nga muret ose ndarjet që janë të paktën 1.8 metra të lartë.

Faktorët që duhet të merren në konsideratë gjatë planifikimit të tualetit të përshtatshëm:

- Madhësia e tualetit.
- Numri i personave të cilëve do tu shërbejë.
- Lloji i shërbimeve që ofrohen në strukturë.
- Disponueshmëria e furnizimit me ujë.

Tualeti konsiderohet i përdorshëm, funksional dhe privat sipas mënyrës së mëposhtme

Të disponueshme

I disponueshëm në çdo kohë. Janë në dispozicion të vazhdueshëm, dyert janë me kyç dhe një çelës është i disponueshëm në çdo kohë.

Funksional

Të mos jetë i prishur. Vrima e tualetit nuk duhet të ketë bllokim. Të mos ketë asnjë çarje apo rrjedhje në strukturën e tualetit, dhe të ketë ujë të rrjedhshëm në strukturën e shkarkimit.

Privatësi

Të ketë dyer që mund të mbyllen nga brenda, të mos shihen boshllëqe ose vrima të mëdha.

- Hyrja për në tualet duhet të jetë të paktën 1.5 metra gjerësi, dhe korridori për në tualet duhet të jetë pa pengesa dhe jo-i rrëshqitshëm.
- Dyshemetë duhet të jenë rezistente ndaj detergjentëve dhe dezinfektuesve të përdorur.
- Punimet e dyshemesë së tualeteve duhet të bëhen me pllaka të cilësisë së mirë që mos jenë rrëshqitëse, dhe të pjerrëta në mënyrë të përshtatshme për të lejuar pastrimin e duhur dhe tharjen e ujit.
- Muret në tualete duhet të jenë të veshura me pllaka majelike (ngjyra të lehta) dhe / ose të tjera materiale rezistente ndaj lagështisë deri në lartësinë e dhomës.
- Objektet duhet të ndërtohen në një zonë të arritshme që do të thotë se mënyra e qasjes duhet të jetë e përshtatshme.
- Dyert duhet të hapen nga jashtë për të rritur hapësirën e përdorshme brenda.

Largimi i ujërave të përdorura

Zbatimi i metodave sanitare për largimin e ujërave të përdorura është një investim që meriton prioritet. Marrja e vendimeve në fushën e sanitetit është e lidhur ngushtë me:

- kushtet sociale,
- kulturore,
- mënyrën e urbanizimit,
- dendësinë e popullsisë,
- faktorët ekonomike,
- furnizimi me ujë etj.

Në varësi të këtyre faktorëve zgjidhet edhe sistemi i sanitetit të ujërave të përdorura i cili mund të jetë :

Sistemi individual me gropa septike, latrinat me ose pa ventilim, i cili duhet të jetë i përkohshëm me tendencë drejt sistemit kolektiv.

Disavantazhet e Sistemit individual me gropat septike,

- kërkesën për të pasur furnizim të vazhdueshëm me ujë,
- përshkueshmërinë e terrenit ku ndërtohen.

Sistemi kolektiv, duhet te ketë rrjet te largimit të ujërave të përdorura.

- Rolin kryesor e luan sistemi i trajtimit nëpërmjet të cilit sigurohet mbrojtja e ujërave sipërfaqësore nga ndotja.
- Largimi i jashtëqitjeve dhe ujërave të përdorura në mënyrë jo korrekte favorizon ndotjen e tokës dhe burimeve ujore të furnizimit me ujë të pijshëm.

Për sistemin kolektiv të ujërave të përdorura ekzistojnë 2 lloj sisteme kanalizimesh:

- sistemi i përzier
- sistemi i ndarë

Në sistemin e përzier largohen e transportohen të gjithë ujërat. Në sistemin e ndarë ujërat e shiut kalojnë në rrjet të veçantë.

Ujërat që duhen larguar nga një qendër e banuar janë:

- ujërat e shiut
- ujërat e larjes së rrugëve
- ujërat e përdorur shtëpiakë
- ujërat industriale

Rrjetet e kanalizimit të ujërave të përdorura duhet të sigurojnë:

- Largimin e shpejtë të jashtëqitjeve nga banesa
- Transportin e tyre në kushte higjienike.

Udhëzues për Ujin, Sanitetin dhe Higjienën në kushtet e ndryshimeve klimaterike

- Shkarkimi në mjedisin natyror (duhet të jenë të trajtuara për të ulur ndotjen e ujërave sipërfaqësore det, lum, liqen)
- Parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive, tifo, kolere apo sëmundje të lëkurës.

Shërbimet WASH

Gjinia dhe WASH

Rëndësia e progresit në lidhje me ujin e pijshëm dhe higjienen janë të lidhur ngushtë me realizimin e Objektivi mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm (SDG 5), e cila, synon realizimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e të gjithëve grave dhe vajzave. Gjithashtu, pabarazitë gjinore pengojnë realizimin e SDG 6 dhe kjo e lidhur me WASH.

Refruar të dhenave 1.8 miliardë njerëz marrin ujin e pijshëm nga furnizime të vendosura jashtë ambienteve të shtëpise. Në dhjetë familje, një në shtatë pjesmarres janë kryesisht gra dhe vajza përgjegjës për grumbullimin e ujit për nevojat e familjes. Keto të dhena tregojnë që pothuajse në të gjitha vendet me të dhëna të krahasueshme, barra e transportit të ujit mbetet e konsiderueshme dhe behet më e rëndë për gratë dhe vajzat sesa për burrat dhe djemtë.

Programi WASH ndihmon në;

- Ndërhyrje që synon të reduktojë sëmundjet kërcënuese për jetën.
- Parandalimin afatgjatë dhe masat e kontrollit për përmirësimin e shëndetit.
- Reduktimin e varfërisë, dhe përmirësimin e zhvillimit socio-ekonomik.

Aksesi i barabartë në ujë të shëndetshëm dhe të sigurt, kanalizime të përshtatshme dhe të përmirësuara dhe programe të mira të higjienës (WASH) synojnë rritjen e efikasitetit, qëndrueshmërisë, integritit të higjienës dhe ndërhyrjeve në komunitete dhe institucione të edukimit (shkolla), Qendra Shëndetësore (poliklinika, spitale, qendra të urgjencës mjekësore) etj.

Higjiena

Higjiena është element i domosdoshëm e cila kërkon zbatim të praktikave higjienike

- Sapuni duhet të jetë i disponueshëm në çdo kohë në çdo strukturë të larjes së duarve .
- Objektet e larjes së duarve duhet të jenë të vendosura në vende të përshtatshme brenda njësisive të tualetit.
- Strukturat e larjes së duarve duhet të jenë 5 metra nga çdo tualet.
- Tualetet duhet të jenë të pastra nga mbeturinat, papastërtitë e dukshme, jashtëqitjet, insektet dhe uji i ndenjur.
- Muret dhe dyshemetë e bllokut të tualeteve duhet të pastrohen me ujë dhe zbardhues tri herë një ditë.

- Materialet pastruese (p.sh. uji, sapuni, dezinfektuesit, furçat etj.) duhet të jenë vënë në dispozicion për kryerjen e pastrimit të rregullt.
- Pajisjet e pastrimit (kova, legen, lecka, etj.) duhet të përdoren rreptësisht për pastrim.
- Stafi teknik i strukturave që janë të angazhuar në pastrim duhet të njohë dhe respektojë parimet e përgjithshme të pastrimit.
- Pastrimi duhet të kryhet gjithmonë nga zona më pak e ndotur deri tek më zona të ndotura, në mënyrë që zonat më të ndotura dhe mbeturinat që bien në dysHEME të hiqen të fundit.
- Për të parandaluar pluhurin, mbeturinat dhe mikroorganizmat të hyjnë në ajër, dhe me qëllim që sipërfaqet të jenë të pastra, duhet të evitohet fshirja dhe pluhuri i thatë.
- Kur përdoren dezinfektantët, duhet të ndiqen udhëzimet sipas etiketës sepse përdorimi me më shumë ose më pak ujë mund të zvogëlojë efektivitetin e dezinfektuesve
- Duhet të ketë furnizime me paisje të përshtatshme pastrimi dhe pajisje mbrojtëse personale.

Higjiëna e duarve

Larja e duarve është një nga mënyrat më të mira për të mbrojtur veten dhe familjen nga sëmundjet.

Larja e duarve mund parandalojë përhapjen e infeksioneve.

Mikrobet mund të përhapen nga personi në person ose nga sipërfaqja te njerëzit kur:

- Preken sytë, hunda dhe goja me duar të palara
- Përgatitet ushqimi dhe përdoret ushqim dhe pije me duar të palara
- Preken sipërfaqet ose objektet që kanë mikrobe mbi to
- Gjatë kollitjes, fryrjes së hundës, apo teshtitjes në duar dhe më pas preken duart e njerëzve të tjerë ose objektet e zakonshme.
- Larja e duarve duhet të bëhet në momentet kryesore me sapun dhe ujë për të paktën 20 sekonda ose përdorimin e një dezinfektuesi me bazë alkooli me të paktën 60 alkool nëse sapuni dhe uji nuk janë të disponueshëm.
- Dezinfektuesit e duarve mund të zvogëlojnë shpejt numrin e mikrobeve në duar në shumë situata por nuk eliminojnë të gjitha llojet e mikrobeve, duke përfshirë disa mikrobe që shkaktojnë diarre.
- Dezinfektuesit e duarve mund të mos jenë efektivë nëse duart janë të ndotura ose të yndyrshme.

Udhëzues për Ujin, Sanitetin dhe Higjiën në kushtet e ndryshimeve klimaterike

- Dezinfektuesit e duarve mund të mos heqin kimikatet e dëmshme, si pesticidet dhe metalet e rënda.

Është shumë e rëndësishme larja e duarve, veçanërisht në momentet kyçe si:

- Pas përdorimit të tualetit
- Kur duart janë të ndotura
- Para dhe pas ngrënies së ushqimit
- Pas fryrjes së hundës, kollitjes ose teshtitjes
- Pas prekjes së mbeturinave
- Përpara se të merren medikamentet
- Pas kontaktit me cdo send të ndotur
- Përpara përgatitjes së ushqimeve
- Pas kontaktit me sipërfaqe dhe objekte të ndotura.

Hapat për të larë duart në mënyrën e duhur



Lajini me ujë të rrjedhshëm
(të nxehtë ose të ftohtë)



dhe me sapun



shkumojini duke i fërkuar
me njëra-tjetrën



pastrojini në gjithë sipërfaqet duke
i larë të paktën për 20 sekonda



shpëlajini me ujë të pastër e
të rrjedhshëm



thajini sa më mirë duke përdorur
peshqir të pastër ose tharëse

Menaxhimi

- Të sigurohet sasia dhe cilësia e duhur e ujit në rast të ndryshimeve klimatike.
- Furnizimet natyrore mund të kenë nevojë të shtohen në zona të veçanta
- Mund të kenë nevojë të përdoren teknologji dhe procese rezistente ndaj klimës për trajtimin e ujit
- Sistemet e trajtimit të ujit mund të kenë nevojë të përmirësohen dhe të kenë kapacitet më të madh ruajtjeje për të qenë në gjendje për tu përballuar me ngarkesa më të mëdha mikrobike, turbullira dhe kimike, dhe për të përmirësuar efikasitetin e përdorimit të ujit gjatë trajtimit.
- Mund të kenë nevojë të zhvillohen burime të reja uji, të tilla si ujërat e zeza të ricikluara ose uji i shkripëzuar nga uji i detit të cilat kërkojnë investime paraprake.
- Mund të kenë nevojë të zbatohen strategji të reja, të tilla si ruajtja dhe rikuperimi i akuifereve.
- Do të kërkohet veprim për të përmirësuar menaxhimin e ujit, duke përfshirë zbulimin dhe reduktimin e rrjedhjeve, dhe reduktimin e kërkesës së konsumatorëve.

Plani i sigurisë së ujit

Ka tre komponentë kyç, të cilët udhëhiqen nga objektivat e bazuara në mbrojtjen e shëndetit:

- Vlerësimi i sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm, deri në pikën e arritjes tek konsumatori, bazuar në kriteret e cilësisë
- Masat e kontrollit në sistemin e ujit të pijshëm për identifikimin e rreziqeve dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës.
- Menaxhimi dhe komunikimi gjatë kushteve jo të mira të funksionimit furnizimit me ujë , duke përfshirë përmirësimin e planifikimit, monitorimit dhe komunikimit.

Rolet dhe përgjegjësitë

Institucionet	Rolet e përgjegjësitë
<p>NJKSH</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Monitorimi i jashtëm është nën përgjegjësinë e saj, për të siguruar që uji i pijshëm në territorin e vet administrativ plotëson kërkesat. Monitorimi i jashtëm përfshin kontrollin higjieno sanitar të objekteve të veprës së ujësjellësit, verifikimin e kryerjes së monitorimit të brendshëm dhe analizimin e rezultateve të këtij monitorimi, kontrollin e zonave të mbrojtjes sanitare, kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm në rrjetin shpërndarës të ujësjellësit etj. - Kërkon që administratori, të marrë masat e duhura për të eliminuar rrezikun e mospërputhjes me vlerat parametrike. - Informon në mënyrën e duhur konsumatorët e interesuar mbi masat e ndërmarra dhe këshillojnë për çdo veprim rregullues shtesë që ata duhet të ndërmarrin. - Kontrollon respektimin e kërkesave higjieno sanitare të pusit, si dhe cilësinë e ujit dhe rezultatet ia bën të ditura me shkrim organeve të qeverisjes vendore dhe/ose pronarit. - Në rast të mosrespektimit të rregullave higjieno sanitare, informon ISHSH-në. - Sa herë që furnizimi me ujë të pijshëm përbën një rrezik potencial për shëndetin publik, vendos/ rekomandon kufizimin ose ndalimin e përdorimit të ujit të pijshëm ose marrjen e masave të tjera të nevojshme për mbrojtjen e shëndetit. - Vendos/ rekomandon, masat që duhen marrë duke pasur parasysh rreziqet për shëndetin e njeriut që mund të shkaktohen nga ndërprerja e furnizimit ose përdorimi i kufizuar i ujit të pijshëm. - Monitoron cilësinë e ujit kur është i nevojshëm përdorimi i depozitave apo i autobotëve, duke kerkuar nga administratori respektimin e kërkesave teknike dhe higjienosanitare për autobotët.

	<ul style="list-style-type: none"> - Përpara se lëndët kimike të përdoren për trajtimin e ujit të pijshëm, kryen analiza kimike për pajisjen me miratimin për përdorimin e tyre. - Kur instalimi i ri fillon funksionimin, përgatit një raport bazuar në kontrollin, vlerësimin dhe ndjekjen e rezultateve analitike të kryera nga administratori, lidhur me parametrat e përcaktuar prej saj. - Nën mbikëqyrjen e saj vendosen nga pronari në ndërmarrjet e prodhimit ushqimor, pikat e marrjes së kampionëve të ujit. - Në çdo kampion të ujit të pijshëm për monitorim të brendshëm ose monitorim të jashtëm, uji cilësohet si: <ul style="list-style-type: none"> a) “I përshtatshëm për përdorim”, kur nga rezultati i analizave ai plotëson kërkesat. b) “I papërshtatshëm për përdorim”, kur ai nuk plotëson kërkesat. - Vë në dispozicion të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) një kopje të aktmarrëveshjes dhe njofton çdo ndryshim të pikave të monitorimit brenda 30 ditëve nga ndryshimi i bërë - Për çdo monitorim, harton raportin e monitorimit dhe në rast të konstatimit të parregullsive, jep rekomandime për administratorin e objektit të kontrolluar. - Dërgon nga 1 (një) kopje të raportit të monitorimit administratorit, MSHMS dhe ISHSH-së rajonale. - Rekomandon masat që duhet të marrë administratori për rivendosjen e cilësisë së ujit dhe informon ISHSH-në. - Informon në mënyrën e duhur konsumatorët e prekur dhe bashkë me Administratorin, secili sipas kompetencës së vet, u japin këshillat e nevojshme.
<p>ISHSH</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Inspektimin bazuar në vlerësimin e riskut, bazuar në raportet e monitorimit nga NJVKSH dhe sinjalizimet nga burime të tjera. ISHSH-ja kryen inspektimin në bashkëpunim të ngushtë me NJVKSH. - Kryen procedurën për lëshimin e aktmiratimit higjiено sanitar. Projektet e ndërtimit, fillojnë vetëm pas dhënies së aktmiratimit higjiено sanitar.

	<p>- Ndalon përdorimin e ujit dhe/ose u kërkon organeve të qeverisjes vendore dhe/ose administratorit marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes. Në rastin e ndalimit të përdorimit, vendoset mbishkrimi: “UJË I NDALUAR PËR TU PIRË”.</p>
<p>ISHP</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Kryerjen e studimeve në drejtim të ujit dhe sanitetit. - Rekomandon marrjen e masave, bazuar në situatat, për menaxhimin e rreziqeve që mund të cenojnë sigurinë e ujit të pijshëm. - Kryen ekspertiza në terren. - Realizon trajnime me qëllim forcimin e kapaciteteve të profesionistëve, të shëndetit publik. - Institucion këshillues në situata emergjente të shpërthimeve epidemike me natyrë nga uji, apo emergjencave natyrore. - Kryen modifikimin e shtojcave të VKM 379, në lidhje me zhvillimin e njohurive tekniko-shkencore apo në zbatim të akteve ligjore në fuqi. - Kryen përcaktimin e vlerave parametrike shtesë sa herë që kjo është e nevojshme për mbrojtjen e shëndetit publik në një pjesë apo në gjithë territorin e vendit - Kryen përshtatjen e metodave analitike, pas verifikimeve përkatëse, në mënyrë që rezultatet përfundimtare të jenë të së njëjtës shkallë besueshmërie me rezultatet e përfituara me metodat e specifikuar. - Për parametra të caktuar, shqyrton metoda të tjera zyrtare të analizave, të ndryshme, rezultatet e të cilave janë po aq të besueshme sa ato të përfituara me metodat e përcaktuara në VKM.

Referencat

- DIREKTIVA E KËSHILLIT 98/83/KE mbi cilësinë e ujit të destinuar për konsum njerëzor
- GUIDELINES FOR DRINKING-WATER QUALITY: FOURTH EDITION
- VKM 379
- <https://www.cdc.gov/handwashing/handwashing-school.html>⁽⁴⁾
- <https://www.cdc.gov/hygiene/personal-hygiene/hands.html>⁽⁵⁾
- WinHCF_Standards_ENG.pdf⁽⁶⁾
- <https://www.who.int/publications/i/item/0419217304> ⁽⁷⁾

VENDIM
Nr. 379, datë 25.5.2016

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“CILËSIA E UJIT TË PIJSHËM”¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 42, të ligjit nr. 10138, datë 11.5.2009, “Për shëndetin publik” dhe të pikës 1, të nenit 31, të ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

¹ 31998L0083 ; 03/11/1998; direktiva e Këshillit 98/83/EC, “Mbi cilësinë e ujit për konsum nga njerëzit”.

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Cilësia e ujit të pijshëm”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Vendimi nr. 145, datë 26.2.1998, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullore higjieno-shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Mjedisit, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, njësitë e vetëqeverisjes vendore për menaxhimin e integruar të burimeve ujore dhe çdo institucion tjetër, publik a privat, që kanë sistemin e tyre të furnizimit me ujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

RREGULLORE
CILËSIA E UJIT TË PIJSHËM

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore përcakton kërkesat e cilësisë së

ujit të pijshëm, me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik nga efektet negative të ndotjes së tij, duke siguruar që uji është i shëndetshëm dhe i pastër.
Neni 2

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ujë i pijshëm”, është ujë i përcaktuar për përdorim nga njerëzit, ku futen:

a) ujërat të trajtuara ose të patrajtuara, të përcaktuara për qëllim pirjeje, gatimi, përgatitjeje të ushqimeve dhe për nevojat e higjienës, pavarësisht origjinës së tyre dhe nëse janë furnizuar prej një rrjeti shpërndarës publik apo privat, prej depozitave, prej autobotëve, prej puseve individuale apo kolektive, apo të ambalazhuar në shishe ose në enë;

b) ujërat që përdoren në ndërmarrjet e prodhimit të ushqimeve për prodhimin, fabrikimin, përpunimin, ruajtjen apo tregtimin e prodhimeve apo lëndëve të përcaktuara për përdorim nga njerëzit, si dhe ujërat për pastrimin e sipërfaqeve, objekteve apo materialeve që mund të jenë në kontakt me artikujt ushqimorë;

c) akujt ushqimorë me origjinë ujore;

ç) ujërat e furnizuara për përdorim nga njerëzit, si pjesë e një aktiviteti tregtar apo publik, pavarësisht nga sasia mesatare e ujit të furnizuar në ditë.

2. “Autoriteti shëndetësor”, Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), strukturat rajonale të shëndetit publik (sipas përcaktimit në ligjin nr. 10 138, datë 11.5.2009, “Për shëndetin Publik”), Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH).

3. “Administratori dhe/ose administratorët”, personi/subjekti (vendës apo i huaj), autoriteti publik ose institucioni privat që është përgjegjës për furnizimin ose pjesë të tij ose për çdo aktivitet tjetër që lidhet me furnizimin me ujë të pijshëm.

4. “Ujësjellës”, sistemi i ndërtuar për prodhimin, depozitimin, transportimin, trajtimin dhe shpërndarjen e ujit të pijshëm me cilësinë e përcaktuar sipas kësaj rregulloreje deri në pikën e lidhjes së përdoruesve.

5. “Ujëra që përdoren për prodhimin e ujit të pijshëm”, ujërat që pavarësisht nga origjina, të trajtuar ose të patrajtuar, përdoren për konsum nga njerëzit.

6. “Pikë e marrjes së kampionit”, vendi i marrjes së kampionit dhe monitorimit të cilësisë së ujit të pijshëm.

7. “Vlerë parametrike”, niveli maksimal apo minimal i vendosur për secilin parametër në monitorim.

8. “Rezultat”, vlera e parametrit e përcaktuar me një metodë specifike analizuese dhe e shprehur në njësitë e përcaktuara në shtojcën I.

9. “Pesticide”, insekticidet organike, herbicidet organike, fungicidet organike, nematocidet organike, acaricidet organike, algicidet organike, rodenticidet organike, slimicidet organike, produktet që kanë lidhje *inter alia* me rregullatorë të rritjes dhe metabolitet përkatës, produktet e degradimit dhe të reaksionit.

10. “Lëndë”, çdo produkt (lëndë apo përbërës) që shtohet në ujë ose përdoret për përmirësimin apo trajtimin pastrues të ujit, si dhe ato të përdorura për pastrimin e sipërfaqeve, pajisjeve, depozitave apo enëve, që janë në kontakt me ujin e pijshëm.

Për këto qëllime ato ndahen në grupet e mëposhtme:

a) “Dezinfektantët e ujit”, produktet për dezinfektimin e ujit të pijshëm.

b) “Dezinfektantë të sipërfaqeve”, produktet për dezinfektimin e pajisjeve, kontejnerëve, mjeteve të konsumit, sipërfaqeve ose tubacioneve që kanë të bëjnë me prodhimin, transportin, ruajtjen dhe shpërndarjen e ujit të pijshëm.

c) “Algicidet dhe produktet kundër smërçit”, produktet që eliminojnë ose parandalojnë zhvillimin e algave në ujërat që përdoren për prodhimin e ujit të pijshëm ose që kanë veprim kundër smërçit apo depozitimeve të ngurtëzuara.

ç) “Lëndë të tjera”, çdo produkt që nuk është përfshirë në pikat e mësipërme.

11. “Lëndë sekondare të dezinfektimit (LSD)”, një përbërje kimike e formuar nga reaksioni i dezinfektantëve të ujit (p.sh. klor) me lëndët organike që ndodhen në ujë.

12. “Vepër e trajtimit të ujit të pijshëm (VTUP)”, proceset për trajtimin pastrues të ujit, të vendosur përpara rrjetit të shpërndarjes dhe/ose rezervuarit. Vepra duhet të përmbajë njësi të tjera përveç dezinfektimit.

13. “Materialet e ndërtimit në kontakt me ujin e pijshëm”, çdo material ndërtimi apo veshës ose i përdorur gjatë procesit të ndërtimit të të gjitha elementeve të një ujësjellësi.

14. “Tubacionet”, çdo sistem i ndërtuar tubash që transmeton ujin nga një vend në një tjetër.

15. “Rezervuar”, objekt i ndërtuar mundësisht në pikën më të lartë të sistemit, që ka për qëllim depozitimin e sasisë së ujit që do të përdoret në orët e pikut (konsumit maksimal) dhe sigurimin e presionit të duhur në rrjetin e shpërndarjes.

16. “Autobot”, rezervuar i lëvizshëm që përdoret në raste emergjence ose në disa situata kur kjo mënyrë furnizimi është e vetmja mundësi e vlefshme.

17. “Rrjet i jashtëm i shpërndarjes”, sistemi i tubacioneve, i projektuar për shpërndarjen e ujit të pijshëm nga vepra e trajtimit të ujit ose rezervuari tek ujëmatësi i përdoruesit.

18. “Rrjet i brendshëm i shpërndarjes”, tubacionet, nyjat dhe aparatat e instaluar midis rubinetave që përdoren normalisht për furnizimin me ujë të pijshëm dhe rrjetit të jashtëm të shpërndarjes. Kufiri ndërmjet rrjetit të brendshëm të shpërndarjes dhe rrjetit të jashtëm të shpërndarjes, zakonisht i quajtur pika e ofrimit, përfaqësohet nga ujëmatësi, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në kontratën e shpërndarjes dhe furnizimit.

19. “Pika e furnizimit”, vendi ku administratori i një pjese të furnizimit dorëzon ujin tek administratori tjetër i pjesës vijuese ose te përdoruesi (pika e ofrimit).

20. “Zonë e furnizimit”, një zonë e përcaktuar gjeografikisht brenda së cilës uji i pijshëm vjen nga një ose më shumë burime dhe cilësia e ujit mund të konsiderohet si përafërsisht e njëjtë gjatë gjithë vitit.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Fusha e zbatimit të kësaj rregulloreje përfshin ujërat e përcaktuara në nenin 2, pika 1.

2. Përfshihen nga fusha e zbatimit të kësaj rregulloreje:

a) ujërat kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale, të përcaktuara me rregullore të veçanta.

Neni 4

Kompetencat e institucioneve qendrore

1. Në fushën e mbuluar nga kjo rregullore, është kompetencë e institucioneve qendrore:

a) Modifikimi i shtojcave I, II dhe III në lidhje me zhvillimin e njohurive tekniko-shkencore apo në zbatim të akteve ligjore në fuqi;

b) Përcaktimi i vlerave parametrike shtesë që nuk gjenden në shtojcën I sa herë që kjo është e nevojshme për mbrojtjen e shëndetit publik në

një pjesë apo në gjithë territorin e vendit; vlerat e përcaktuara duhen, në minimum, të plotësojnë kërkesat sipas nenit 6, pika 2, shkronja “a”;

c) Përshtatja e metodave analitike të ndryshme nga ato të treguara në shtojcën III, shkronja “A” dhe “B”, pas verifikimeve përkatëse, nga ana e Institutit të Shëndetit Publik, në mënyrë që rezultatet përfundimtare të jenë të së njëjtës shkallë besueshmërie me rezultatet e përfituara me metodat e specifikuar më parë;

ç) Përzgjedhja e ujërave për përdorim në ndërmarrjet ushqimore, cilësia e të cilave nuk mund të ketë pasoja mbi sigurinë e produktit ushqimor përfundimtar;

d) Përshtatja e normave dhe udhëzimeve teknike për instalimin e veprave të ujësjiellësve, ashtu si edhe për punimet e gërmimit, shpimit, mirëmbajtjes, mbylljes e rihapjes së puseve të ujit;

dh) Përshtatja e udhëzimeve teknike për ujin e pijshëm të ambalazhuar në shishe apo enë.

2. Kompetencat sipas pikës 1, ushtrohen:

- për shkronjat “a”, “b” e “c” nga Ministria e Shëndetësisë;

- për shkronjat “ç” e “dh” nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë;

- për shkronjën “d”, nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

Neni 5

Kompetencat e qeverisjes vendore

Në fushën e mbuluar nga kjo rregullore, është në kompetencë të qeverisjes vendore:

1. Sigurimi që uji, i furnizuar nëpërmjet çdo rrjeti shpërndarës, depozite apo rezervuari fiks apo të lëvizshëm, pusi kolektiv, brenda zonës së tij territoriale, është i përshtatshëm për përdorim në pikën e ofrimit të tij të përdoruesi, sipas kërkesave të parashikuara në shtojcën I.

2. Parashikimi i masave për sigurimin e furnizimit në rast emergjence me ujë të pijshëm që plotëson kërkesat sipas shtojcës I, për sasinë dhe periudhën minimale të nevojshme për të përballuar nevojat lokale.

3. Përshtatja e planeve të ndërhyrjes për përmirësimin e cilësisë së ujit të pijshëm në bashkëpunim me Agjencinë e Ujit të Basenit (AUB).

Neni 6

Kriteret e cilësisë së ujit të pijshëm

1. Uji i pijshëm duhet të jetë i shëndetshëm dhe i pastër.

2. Uji i pijshëm plotëson kërkesën e pikës 1, nëse:

a) nuk përmban mikroorganizma, parazitë apo ndonjë lëndë tjetër, e cila, në sasi apo në përqendrim, përbën një rrezik potencial për shëndetin publik; dhe

b) përveç sa parashikohet nga neni 25, përmbush kërkesat e vendosura në shtojcën 1, pjesët A dhe B;

c) përputhet me sa parashikohet nga masat e përshtatura sipas nenit 24, pika 5.

3. Masat e marra për zbatimin e kësaj rregulloreje, në asnjë rrethanë, nuk duhet të lejojnë, drejtpërdrejt ose jodrejtpërdrejt, as ndonjë përkeqësim të cilësisë aktuale të ujit të pijshëm për aq sa kjo është e lidhur me mbrojtjen e shëndetit publik dhe as ndonjë rritje në ndotjen e ujërave të përdorura në prodhimin e ujit të pijshëm.

Neni 7

Pikat e respektimit të kriterëve të cilësisë së ujit të pijshëm

1. Vlerat parametrike të vendosura në shtojcën I duhet të respektohen në këto pika:

a) për ujin e furnizuar nëpërmjet një rrjeti shpërndarjeje, në pikën ku uji rrjedh nga rubineti i konsumatorit;

b) për ujin e furnizuar nga një pus individual apo kolektiv, depozitë, rezervuar privat apo publik, fiks apo i lëvizshëm, në pikën ku ai i ofrohet konsumatorit;

c) për ujin e ambalazhuar në shishe ose në enë për përdorim nga njerëzit, në pikën ku uji ambalazhohet dhe në fazën e tregtimit apo të vënies në dispozicion për përdorim;

ç) për ujin e përdorur në ndërmarrjet e industrisë ushqimore, në pikën ku uji përdoret në ndërmarrje.

2. Për ujin e përcaktuar nga pika 1, shkronja “a”, gjykohet se administratori i ka përmbushur detyrimet sipas kësaj rregulloreje atëherë kur vlerat parametrike të vendosura në shtojcën I respektohen në pikën e ofrimit, shprehur në nenin 2, pika 19 dhe kur sistemi i brendshëm i shpërndarjes nuk është në përgjegjësinë e tij si administrator. Për ndërtesat/strukturat ku uji i furnizohet publikut si pjesë e aktivitetit tregtar ose publik, zotëruesi i ndërtesës/strukturës, duhet të sigurojë që vlerat parametrike të vendosura në

shtojcën I, të respektuara në pikën e ofrimit, janë mirëmbajtur në pikën ku uji del nga rubineti.

3. Duke mbajtur parasysh sa është përcaktuar në pikën 2, sa herë që ekziston rreziku që ujërat sipas pikës 1, shkronja “a”, edhe pse në pikën e ofrimit respektojnë vlerat e parametrave të përcaktuar në shtojcën I, të mos respektojnë këto vlera në rubinet:

a) Struktura rajonale e shëndetit publik kërkon që administratori ose zotëruesi i ndërtesës /strukturës apo të dy së bashku, marrin masat e duhura për të eliminuar rrezikun e mospërputhjes me vlerat parametrike;

b) Struktura rajonale e shëndetit publik, AUB dhe administratori, gjithsecili për sa në kompetencë të vet, informojnë në mënyrën e duhur konsumatorët e interesuar mbi masat e ndërmarra dhe këshillojnë për çdo veprim rregullues shtesë që ata duhet të ndërmarrin.

Neni 8

Ujërat që përdoren për prodhimin e ujit të pijshëm

Ujërat që përdoren për prodhimin e ujit të pijshëm mund të jenë me origjinë nëntokësore ose sipërfaqësore, duke siguruar që nuk paraqesin asnjë rrezik për shëndetin e popullatës së furnizuar. Ndalohet ambalazhimi i ujërave me origjinë sipërfaqësore, qofshin edhe të trajtuara.

Neni 9

Kërkesat higjienosanitare për sigurimin e cilësisë së ujit të pijshëm të puseve

1. Administratori i pusit kolektiv apo privat është përgjegjës për respektimin e kërkesave higjienosanitare, sipas shtojcës IV të kësaj rregulloreje, për sigurimin e cilësisë së ujit të pijshëm.

2. Struktura rajonale e shëndetit publik kontrollon respektimin e kërkesave higjienosanitare të pusit, si dhe cilësinë e ujit dhe rezultatet ia bën të ditura me shkrim organeve të qeverisjes vendore, AUB dhe/ose administratorit.

3. Në rast të mosrespektimit të rregullave higjienosanitare, struktura rajonale e shëndetit publik informon ISHSH-në, AUB-in dhe Entin Rregullator të Ujit (ERRU), të cilët veprojnë sipas kompetencave të parashikuara ligjore. ISHSH-ja ndalon përdorimin e pusit individual apo kolektiv dhe/ose u kërkon organeve të qeverisjes vendore dhe/ose administratorit marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes.

Në rastin e ndalimit të përdorimit, vendoset mbishkrimi: “UJË I NDALUAR PËR PIRJE”.

Neni 10

Kërkesat e cilësisë së ujërave sipërfaqësore për prodhimin e ujit të pijshëm

Ujërat sipërfaqësore, sipas karakteristikave që paraqesin në raport me kërkesat e cilësisë të përcaktuara në shtojcën V, pika 1, të kësaj rregulloreje, klasifikohen në tri kategori: A1, A2 dhe A3 që korrespondojnë me metodat standarde të trajtimeve për transformimin e tyre në ujë të pijshëm, të dhëna në shtojcën V, pika 2.

Neni 11

Zonat e mbrojtjes sanitare

1. Zonat e mbrojtjes sanitare përcaktohen përreth burimeve sipërfaqësore ose nëntokësore që përdoren për prodhimin e ujit të pijshëm dhe synojnë:

- ruajtjen e cilësisë së ujit;

- mbrojtjen nga dëmtimet të veprave të marrjes së ujit.

2. Zonat e mbrojtjes sanitare përcaktohen specifiku për secilin burim sipas kërkesave të neneve 34 e 57, të ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”. Për burimet ujore që lidhen me sistem të furnizimit me ujë parashikohen 3 zona të mbrojtjes sanitare:

a) zona imediate ose e rreptësisë e mbrojtjes sanitare;

b) zona e afërt e mbrojtjes sanitare;

c) zona e largët e mbrojtjes sanitare.

3. Kërkesat higjienosanitare për zonat e mbrojtjes sanitare dhe detyrimet që duhet të respektojnë administratorët e veprave të ujësjellësit, jepen në shtojcën VI të kësaj rregulloreje.

4. Në rastin e furnizimit me ujë nga një pus individual, pronari i pusit kërkon drejtpërdrejt nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar apo një subjekt i licencuar në fushën e hidrogeologjisë, përcaktimin e zonave të mbrojtjes sanitare sipas kërkesave të akteve ligjore në fuqi. Shpenzimet përballohen nga pronari i pusit.

5. Administratori është i detyruar të ruajë zonat e mbrojtjes sanitare dhe ndërhyr në çdo rast kur konstaton shkelje brenda territorit të tyre. Ai informon organet e qeverisjes vendore, që sipas rastit kërkojnë edhe ndihmën e organeve të ruajtjes së rendit. Njëkohësisht informon edhe strukturën rajonale të shëndetit publik.

Neni 12

Sigurimi i cilësisë së trajtimit, pajisjeve dhe materialeve

1. Administratori merr masa që asnjë lëndë apo material i përdorur për instalime që shërbejnë për përgatitjen apo shpërndarjen e ujit të pijshëm, si dhe asnjë papastërti që lidhet me këto lëndë apo materiale të mos kalojnë në ujin e pijshëm lëndë apo karakteristika që ndotin apo përkeqësojnë cilësinë e ujit dhe nënkuptojnë mosrespektim të kërkesave, sipas shtojcës I ose një rrezik për shëndetin e popullatës së furnizuar.

2. Procesi i trajtimit pastrues nuk duhet të kalojë asnjë lëndë apo karakteristikë që mund të ndotë ujin ose të përkeqësojë cilësinë e tij dhe që do të thotë mospërputhshmëri me kërkesat e specifikuara në shtojcën I dhe rrezik për shëndetin e popullatës së furnizuar. Gjithashtu, nuk duhet të ketë efekt të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në ndotjen apo përkeqësimin e ujërave sipërfaqësore apo nëntokësore të përdorura për prodhimin e ujit të pijshëm.

Neni 13

Dezinfektimi i objekteve të ndryshme të furnizimit me ujë të pijshëm

Administratori siguron kryerjen e dezinfektimit, si masë parandaluese për të evituar ndotjen e mundshme të ujit.

a) Kaptazhet dhe rezervuarët dezinfektohen përpara vënies në shfrytëzim, si dhe gjatë shfrytëzimit sipas një kalendari të caktuar dhe sipas kërkesave të shtojcës VII, pika 1;

b) Tubacionet dezinfektohen dhe pastrohen përpara përdorimit sipas kërkesave të shtojcës VII, pika 2;

c) Kur, me qëllim furnizimin me ujë është i nevojshëm përdorimi i depozitave apo i autobotëve, administratori respekton kërkesat teknike dhe higjienosanitare për autobotët sipas shtojcës VIII të kësaj rregulloreje;

ç) Objektet e ambalazhimit të ujit kompozohen në mënyrë të tillë që të lejojnë dezinfektimin e tyre dhe të pajisjeve të instaluar. Ato dezinfektohen sa herë të paraqitet nevoja dhe të paktën 2 herë në muaj.

Neni 14

Lëndët e përdorura për trajtimin e ujit

1. Për trajtimin e ujit të pijshëm lejohet të përdoren vetëm lëndët kimike të miratuara/autorizuara sipas legjislacionit përkatës për produktet biocide.

2. Lëndët kimike që përdoren për trajtimin e ujit të pijshëm nuk duhet të përmbajnë lëndë të huaja dhe toksike. Sasitë maksimale të përmbajtjeve të këtyre lëndëve kur bashkohen në ujin e pijshëm nuk duhet të kalojnë nivelet më të ulëta të lejueshme të tyre, të përcaktuar në normat e kësaj rregulloreje.

3. Administratori siguron lëndët kimike sipas pikës 1 nëpërmjet subjekteve të licencuara për vendosjen në treg të këtyre lëndëve.

4. Administratori është i detyruar që përpara se lëndët kimike të përdoren për trajtimin e ujit të pijshëm, t'i dërgojnë në strukturën rajonale të shëndetit publik për analiza kimike dhe të pajisen prej saj me miratimin për përdorimin e tyre.

Neni 15

Dezinfektimi i ujit të pijshëm

1. Dezinfektimi i ujit të pijshëm është përgjegjësi e administratorit.

2. Uji i pijshëm i furnizuar nga rrjete shpërndarëse shtetërore apo private, depozita, rezervuarë fiks apo të lëvizshëm, puse kolektive apo individuale, duhet të dezinfektohet sipas përcaktimeve të shtojcës IX. Në këto raste, nënproduktet e dezinfektimit duhet të kenë nivelet më të ulëta të mundshme, pa cenuar në asnjë çast efektshmërinë e dezinfektimit. Kur nuk ka asnjë rrezik ndotjeje ose rritje mikrobiale përgjatë rrjetit shpërndarës nga fillimi deri në rubinetin e konsumatorit, administratori mund t'i kërkojë autoritetit shëndetësor përjashtimin nga dezinfektantët mbetës.

Neni 16

Kontrolle shëndetësore paraprake të instalimeve të reja

1. Pas miratimit të çdo projektideje të një ujëmbledhësi të ri, tubacioneve, vepre trajtimi uji, rrjeti të furnizimit ose të shpërndarjes, rezervuari të rrjetit të shpërndarjes ose rimodelimi të instalimeve në përdorim, administratori njofton ISHSH-në, e cila kryen procedurën për lëshimin e aktmiratimit higjienosanitar.

2. Shpenzimet, sipas pikës 1, mbulohen nga administratori.

3. Projektet e ndërtimit, sipas pikës 1, fillojnë vetëm pas dhënies së aktmiratimit higjienosanitar.

4. Kur instalimi i ri fillon funksionimin, struktura rajonale e shëndetit publik përgatit një raport bazuar në kontrollin, vlerësimin dhe ndjekjen e rezultateve analitike të kryera nga

administratori, për sa kohë që të kërkohet, lidhur me parametrat e përcaktuar prej saj.

Neni 17 **Personeli**

Personeli që punon në kontakt të drejtpërdrejtë me ujin e pijshëm duhet të jetë i pajisur me dëshmi të gjendjes shëndetësore sipas rregullores për pajisjen me librezë shëndetësore profesionale.

Neni 18 **Laboratorët për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm**

1. Çdo laborator mikrobiologjik/biokimik që kryen analizat për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, duhet përdorë metodat e analizave sipas shtojcës III.

2. Për parametra të caktuar, Instituti i Shëndetit Publik do të shqyrtojë metoda të tjera zyrtare të analizave, të ndryshme nga ato në shtojcën III, shkronja "A", rezultatet e të cilave janë po aq të besueshme sa ato të përfutuara me metodat e përcaktuara në atë shtojcë, si dhe metodat e analizave për parametrat e përcaktuar në shtojcën III, shkronjat "B" e "C".

Neni 19 **Kontrolli i cilësisë së ujit të pijshëm**

1. Kontrolli i cilësisë së ujit të pijshëm përfshin:

- a) monitorimin e brendshëm;
- b) monitorimin e jashtëm;
- c) inspektimin.

2. Për të siguruar që uji i pijshëm plotëson, në pikat e treguara në nenin 7, pika 1, kërkesat e kësaj rregulloreje, kontrolli i cilësisë së ujit të pijshëm duhet të kryhet:

- a) në pikat e marrjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore të përcaktuara për prodhimin e ujit të pijshëm;
 - b) në pikën ku uji del nga vepra e trajtimit apo rezervuari i ujit;
 - c) në secilën pikë të furnizimit ndërmjet administratorëve të ndryshëm;
 - ç) në rrjetin e shpërndarjes;
 - d) në impiantin e ambalazhimit të ujit;
 - dh) në ujin e ambalazhuar në shishe ose në enë;
 - e) në ujin e përdorur në ndërmarrjet e prodhimit ushqimor.
- Në këtë rast, pikat e marrjes së kampionëve të ujit në industrinë ushqimore vendosen nga ky i

fundit nën mbikëqyrjen e strukturës rajonale të shëndetit publik.

ë) në ujin e furnizuar me puse, depozita dhe autobotë.

3. Në lidhje me monitorimin sipas shkronjës "a" mbahen parasysh rezultatet e studimit të gjendjes së cilësisë së burimeve ujore.

4. Për ujin e pijshëm, të furnizuar nëpërmjet autobotëve, monitorimi sipas shkronjës "ë" përfshin edhe përshtatshmërinë e mjetit të transportit.

5. Në rastet kur dezinfektimi bën pjesë në procesin e përgatitjes apo të shpërndarjes së ujit të pijshëm, monitorimi, sipas pikës 2, verifikon efektshmërinë e dezinfektimit dhe siguron që ndotja nga prania e nënprodukteve të dezinfektimit është mbajtur në nivelin më të ulët të mundshëm, pa cenuar vetëdezinfektimin.

6. Në çdo kampion të ujit të pijshëm për monitorim të brendshëm ose monitorim të jashtëm, uji duhet të cilësohet si:

a) "I përshtatshëm për përdorim", kur nga rezultati i analizave ai nuk përmban asnjë mikroorganizëm, parazit apo lëndë, në sasi apo në përqendrim të tillë që përbën një rrezik potencial për shëndetin publik dhe përputhet me vlerat parametrike të specifikuara në shtojcën I, pjesët A, B dhe D ose me vlerat parametrike për të cilat autoriteti shëndetësor ka lejuar shmangiet dhe pa cenuar çfarë është vendosur në nenin 24, pika 5;

b) "I papërshtatshëm për përdorim", kur ai nuk plotëson kërkesat e shkronjës "a".

Neni 20 **Monitorimi i brendshëm**

1. Monitorimi i brendshëm ka për qëllim verifikimin e cilësisë së ujit të pijshëm dhe është nën përgjegjësinë e administratorit, i cili kryen analizat sipas shtojcës II, në pikat sipas nenit 19, pika 2.

a) Administratori i secilës pjesë të sistemit të furnizimit me ujë, kryen monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm që furnizon. Pikat e marrjes së kampionëve për monitorim duhet të jenë përfaqësuese të ujës jellësit ose pjesëve të tij dhe përcaktohen nga struktura rajonale e shëndetit publik në bashkëpunim me administratorin. Ato bëhen të detyrueshme të respektohen me nënshkrimin e aktmarrëveshjes mes tyre. Struktura rajonale e shëndetit publik vë në dispozicion të Ministrisë së Shëndetësisë një kopje të aktmarrëveshjes dhe njofton çdo ndryshim të

pikave të monitorimit brenda 30 ditëve nga ndryshimi i bërë;

b) Rezultatet e analizave të kryera dërgohen çdo muaj në strukturën rajonale të shëndetit publik, sipas formatit të raportimit të përcaktuar në aktmarrëveshje;

c) Pas të paktën 2 vjet të monitorimit të brendshëm dhe në rast të parametrave të monitorimit verifikues, administratori mund t'i paraqesë kërkesën strukturës rajonale të shëndetit publik për të ulur deri në 50% shpeshhtësinë e analizave të treguara në këtë rregullore për parametra të caktuar, nëse është i sigurt për pamundësinë e ndodhjes së atyre parametrave në ujën e pijshëm në një përqendrim të tillë që paraqet rrezik të mospërputhjes me vlerën parametrike.

2. Për kryerjen e analizave, administratori përdor laboratorin e brendshëm mikrobiologjik/biokimik ose lidh kontratë me një laborator të jashtëm mikrobiologjik/biokimik, të licencuar dhe që plotësojnë kërkesat e nenit 18 të kësaj rregulloreje.

3. Rezultatet e monitorimit regjistrohen në një regjistër dhe ruhen për të paktën 5 vjet. Ato vihen në dispozicion të strukturës rajonale të shëndetit publik dhe ISHSH-në rajonale, kur kërkohen prej tyre.

4. Sa herë që ndonjë incident i ndodhur mund të ndryshojë cilësinë e ujit ose kur konstatohet prishje e cilësisë së ujit, administratori merr të gjitha masat e nevojshme dhe informon menjëherë organet e qeverisjes vendore dhe strukturën rajonale të shëndetit publik.

5. Në situatën e një rreziku të mundshëm për shëndetin publik, struktura rajonale e shëndetit publik i kërkon administratorit kryerjen e analizave shtesë me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik.

6. Administratori është përgjegjës për mirëmbajtjen e veprës së ujës-jellësit. Ai respekton kërkesat sipas shtojcës X të kësaj rregulloreje, si dhe kërkesat e akteve të tjera në fuqi.

7. Nëse cilësia e ujit të pijshëm pëson ndryshime që e bëjnë ujën të papërshtatshëm për përdorim, qoftë përkohësisht apo përgjithnjë, administratori informon popullatën dhe/ose administratorë të tjerë të interesuar, organet e qeverisjes vendore, strukturën rajonale të shëndetit publik, si dhe ERRU-së mbi ndodhinë e mospërputhjes, veprimet korrigjuese dhe masat parandaluese të parashikuara, nëpërmjet burimeve dhe në formën e përcaktuar në marrëveshje me strukturën rajonale të shëndetit publik, me qëllim shmangien e ndonjë rreziku që cenon shëndetin.

Neni 21

Monitorimi i jashtëm

1. Monitorimi i jashtëm është nën përgjegjësinë e strukturës rajonale të shëndetit publik, për të siguruar që uji i pijshëm në territorin e vet administrativ plotëson kërkesat e kësaj rregulloreje.

2. Monitorimi i jashtëm përfshin kontrollin higjienosanitar të objekteve të veprës së ujës-jellësit, verifikimin e kryerjes së monitorimit të brendshëm dhe analizimin e rezultateve të këtij monitorimi, kontrollin e zonave të mbrojtjes sanitare, kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm në rrjetin shpërndarës të ujës-jellësit etj.

3. Për çdo monitorim, struktura rajonale e shëndetit publik harton raportin e monitorimit dhe në rast të konstatimit të parregullsive, jep rekomandime për administratorin e objektit të kontrolluar. Struktura rajonale e shëndetit publik i dërgon nga 1 (një) kopje të raportit të monitorimit administratorit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe ISHSH-së rajonale.

4. Për kryerjen e analizave, struktura rajonale e shëndetit publik përdor laboratorin e brendshëm mikrobiologjik/biokimik ose lidh kontratë me një strukturë tjetër të shëndetit publik. Laboratorët e shëndetit publik duhet të plotësojnë kërkesat e nenit 36, të ligjit nr. 10138, datë 11.5.2009, "Për shëndetin publik" dhe të nenit 18 të kësaj rregulloreje.

5. Rezultatet e këtij monitorimi regjistrohen në një regjistër dhe ruhen për të paktën 5 vjet. Ato vihen në dispozicion të Ministrisë së Shëndetësisë dhe ISHSH-në rajonale, kur kërkohen prej tyre.

6. Ministri i Shëndetësisë përcakton objektet dhe shpeshhtësinë minimale të kontrollit nga strukturat rajonale të shëndetit publik, si dhe metodikën dhe shpeshhtësinë minimale të inspektimit nga ISHSH-ja.

Neni 22

Inspektimi dhe masat administrative

1. Inspektimi i zbatimit të kërkesave ligjore të kësaj rregulloreje kryhet nga ISHSH-ja, i cili, në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", planifikon inspektimin bazuar në vlerësimin e riskut, në raportet e monitorimit nga strukturat qendrore dhe rajonale të shëndetit publik dhe sinjalizimet nga burime të tjera.

2. ISHSH-ja kryen inspektimin sipas pikës 1, në bashkëpunim të ngushtë me strukturat rajonale të shëndetit publik.

3. Në rastet e mosrespektimit të kërkesave të kësaj rregulloreje, ISHSH-ja vepron sipas dispozitave të ligjit nr. 7643, datë 2.12.1992, "Për inspektimin sanitar", të ndryshuar, dhe akteve të tjera ligjore në fuqi dhe njofton Ministrinë e Shëndetësisë dhe AUB-së përkatëse.

4. Çdo 6 muaj, ISHSH-ja raporton në Ministrinë e Shëndetësisë për veprimtarinë inspektuese në zbatim të këtij neni.

Neni 23

Shpeshtësia e marrjes së kampionëve

1. Numri më i vogël i kampionëve të ujit për monitorim të brendshëm duhet të sigurojë përfaqësimin sa më domethënës të ujësjellësit ose pjesë të tij dhe të industrisë ushqimore dhe të jenë të shpërndarë uniformisht gjatë gjithë vitit.

a) Shpeshtësia më e vogël e marrjes së kampionëve për kontrollin rutinë dhe kontrollin verifikues përcaktohet sipas sa është specifikuar në shtojcën II;

b) Shpeshtësia e marrjes së kampionëve për dezinfektantët mbetës mund të rritet nëse vlerësohet e nevojshme nga struktura rajonale e shëndetit publik;

c) Ekzaminimi organoleptik bëhet të paktën dy herë në javë dhe sa herë nuk është kryer ndonjë lloj tjetër analize brenda kësaj periudhe.

Kur struktura rajonale e shëndetit publik gjykon se ka një rrezik për shëndetin publik, kërkon nga administratori të rritë shpeshtësinë e marrjes së kampionëve për ata parametra që struktura rajonale e shëndetit publik i vlerëson të nevojshëm.

2. Shpeshtësia e marrjes së kampionëve për ujin në depozita dhe autobotë, përcaktohen për çdo rast nga struktura rajonale e shëndetit publik.

3. Numri vjetor i kampionëve të marrë në rubinetin e konsumatorit duhet të jetë të paktën numri i përcaktuar në shtojcën II, tabela B3.

Neni 24

Masat korrigjuese dhe kufizimet në përdorim

1. Pa cenuar sa është përcaktuar në nenin 25 dhe nenin 27, pika 2, çdo mospërputhje me vlerat parametrike, të vendosura sipas nenit 6, duhet shqyrtuar menjëherë nga administratori në

bashkëpunim me strukturën rajonale të shëndetit publik, me qëllim përcaktimin e shkakut dhe marrjen e masave të nevojshme për rivendosjen e cilësisë, duke i dhënë përparësi masave zbatuese duke pasur parasysh shtrirjen e tejkalimit të vlerës parametrike përkatëse dhe rrezikun potencial për shëndetin publik.

2. Nëse ndodh apo jo mospërputhje me vlerat parametrike, sa herë që furnizimi me ujë të pijshëm përbën një rrezik potencial për shëndetin publik, struktura rajonale e shëndetit publik vendos kufizimin ose ndalimin e përdorimit të ujit të pijshëm ose marrjen e masave të tjera të nevojshme për mbrojtjen e shëndetit. Struktura rajonale e shëndetit publik vendos, gjithashtu, për masat që duhen marrë duke pasur parasysh rreziqet për shëndetin e njeriut që mund të shkaktohen nga ndërprerja e furnizimit ose përdorimi i kufizuar i ujit të pijshëm.

3. Struktura rajonale e shëndetit publik informon ISHSH-në, sipas nenit 22, pika 1 e kësaj rregulloreje, AUB-në dhe ERRU-në.

4. Administratori zbaton masat korrigjuese të nevojshme për arritjen e cilësisë së duhur të ujit të furnizuar. Pas zbatimit të masave korrigjuese, administratori njofton strukturën rajonale të shëndetit publike, e cila analizon një kampion i ri në pikën ku është evidentuar mospërputhja për të kontrolluar gjendjen e normalizimit.

5. Në rast të mosarritjes së respektimit të vlerave parametrike ose specifikeve të përcaktuara në shtojcën I, pjesa C dhe D, struktura rajonale e shëndetit publik klasifikon ujin si "të përshtatshëm apo të papërshtatshëm për përdorim nga njerëzit" sipas rrezikut që paraqet për shëndetin publik. Ajo rekomandon masat që duhet të marrë administratori për rivendosjen e cilësisë së ujit dhe informon ISHSH-në, AUB-në dhe ERRU-në.

6. Administratori, AUB-ja dhe struktura rajonale e shëndetit publik, secili sipas kompetencës së vet, informojnë në mënyrën e duhur konsumatorët e prekur dhe u japin këshillat e nevojshme.

Neni 25

Shmangiet

1. Administratori kërkon lejimin e shmangieve kundrejt vlerave të parametrave të treguar në shtojcën I, pjesa B apo të vendosura në bazë të

nenit 4, pika 1, shkronja “b”, brenda vlerave maksimale të lejuara, për sa kohë që asnjë prej shmangieve nuk paraqet rrezik të mundshëm për shëndetin publik e gjithmonë me kushtin që furnizimi me ujë të pijshëm në përputhje me vlerat parametrike nuk mund të sigurohet me asnjë mjet tjetër të përshtatshëm.

2. Administratori i dorëzon strukturës rajonale të shëndetit publik kërkesën që duhet të përmbajë të paktën:

a) Kërkesën sipas formatit të paraqitur në shtojcën XI, pjesa A;

b) Originalin dhe një kopje të “Raportit përmbledhës” me seksionet e mëposhtme:

i) arsyet e kërkesës për shmangie duke treguar edhe arsyen e keqësimit të burimit ujqor, shoqëruar me një raport teknik;

ii) parametrat e interesuar, rezultatet e monitorimeve të ushtruar në 3 vitet e fundit, vlerën maksimale të lejueshme të propozuar, si dhe kohëzgjatjen e nevojshme për shmangien e kërkuar;

iii) raport që justifikon se furnizimi me ujë të pijshëm në përputhje me vlerat parametrike nuk mund të sigurohet me asnjë mjet tjetër të përshtatshëm;

iv) formulimi dhe format e transmetimit të shmangies te popullata e prekur;

v) një program të përshtatshëm monitorimi që parashikon, nëse nevojitet, një shpeshësi më të madhe të kontrolleve kundrejt vlerës minimale të parashikuar;

vi) planin e veprimeve të nevojshme korrigjuese, përfshirë një kalendar të punimeve, vlerësim të shpenzimeve, mbulimin përkatës financiar, si dhe vendimet për rishqyrtim.

3. Struktura rajonale e shëndetit publik merr vendimin dhe njofton pranimin e kërkesës brenda dy muajve nga paraqitja e dokumenteve në zyrën e protokollit.

4. Brenda pesëmbëdhjetë ditë pune, struktura rajonale e shëndetit publik i komunikon Ministrisë së Shëndetësisë shmangien e lejuar. Komunikimi bëhet në formën e printuar të përcaktuar në shtojcën XI, pjesa B dhe shoqërohet me një kopje të “Raportit përmbledhës”.

5. Shmangiet duhet të kenë kohëzgjatje sa më të shkurtër të mundshme, e sidoqoftë jo më të madhe se tre vjet.

6. Pas lejjimit të shmangies, administratori siguron që janë njoftuar përdoruesit dhe furnizuesit e tjerë të prekur nga shmangia dhe në koordinim me strukturën rajonale të shëndetit publik, administratori siguron që është dhënë këshillimi shëndetësor në popullatë e sidomos në grupe të veçanta për të cilat shmangia mund të paraqes një rrezik për shëndetin e tyre. Afati i fundit për komunikim është brenda dy ditëve nga njoftimi i lejjimit të shmangies.

7. Në përfundim të periudhës së lejuar, administratori i transmeton strukturës rajonale të shëndetit publik “Raport progresin” mbi rezultatet e arritura gjatë periudhës së shmangieve, në bazë edhe të sa është përcaktuar në paragrafin 2, së bashku me koston totale të masave të marra.

8. Në rrethana të veçanta, nëse tre vjet nuk kanë mjaftuar për korrigjimin e shkakut që motivi kërkesën për shmangie, administratori kërkon zgjatjen e lejjimit të shmangies. Në këtë rast, dy muaj përpara përfundimit të periudhës së lejjimit të shmangies, administratori i dorëzon strukturës rajonale të shëndetit publik këto dokumente:

a) Kërkesën sipas formatit të paraqitur në shtojcën XI, pjesa A;

b) Originalin dhe një kopje të “Raportit përmbledhës” të ri të përditësuar.

Në përfundim të periudhës së lejjimit të shmangies, administratori i dorëzon strukturës rajonale të shëndetit publik origjinalin dhe një kopje të “raport progresit”, që paraqet progresin e bërë nga lejimi i shmangies.

9. Struktura rajonale e shëndetit publik i komunikon Ministrisë së Shëndetësisë kërkesën, “Raportin përmbledhës” dhe “Raport progresin”, së bashku me një raport teknik të përgatitur prej saj në mbështetje të kërkesës për zgjatjen e lejjimit të shmangies.

10. Ministria e Shëndetësisë merr vendimin brenda dy muajve nga paraqitja e dokumenteve në zyrën e protokollit dhe njofton ERRU-në dhe strukturën rajonale të shëndetit publik, e cila, nga ana e saj, njofton administratorin brenda 5 ditëve nga data e protokollimit të vendimit.

11. Kjo periudhë e lejjimit të shmangies, në çdo rast, nuk duhet të jetë më e madhe se tre vjet.

12. Komunikimi me përdoruesit dhe furnizuesit e tjerë të prekur nga zgjatja e lejjimit të shmangies bëhet në përputhje me pikën 6.

13. Kur struktura rajonale e shëndetit publik vlerëson se papajtueshmëria me vlerën parametrike është e parëndësishme, si dhe se veprimet korrigjuese të ndërmarra në përputhje me nenin 24, janë të mjaftueshëm për zgjidhjen e problemit brenda një periudhe maksimale prej 30 ditësh, përcakton vlerën maksimale të lejueshme për parametrin përkatës dhe periudhën e nevojshme për të rivendosur përputhshmërinë me vlerën parametrike. Në këtë rast nuk zbatohen kërkesat e pikës 2.

14. Referimi në procedurën sipas pikës 12 nuk është i lejueshëm nëse mosrespektimi i së njëjtës vlerë parametrike për një furnizim të caktuar uji është verifikuar për më tepër se 30 ditë gjatë 12 muajve të kaluar.

15. Ky nen nuk zbatohet për ujin e pijshëm të furnizuar me anë të rezervuarëve, si dhe për atë të ambalazhuar në shishe apo enë.

16. Ministria e Shëndetësisë menaxhon Regjistrimin Kombëtar të rrethanave për shmangiet e lejuara.

Neni 26

Informimi i konsumatorit

1. Informacioni i dhënë përdoruesve duhet të jetë i besueshëm, i përshtatshëm, i mjaftueshëm dhe i përditësuar në çdo aspekt të përshkruar në këtë rregullore, përmes çdo mjeti të mundshëm komunikimi nga secili autoritet kompetent i përfshirë dhe nga administratorët.

2. Me qëllim informimin e konsumatorëve:

a) Strukturat rajonale të shëndetit publik përgatisin raportin vjetor mbi cilësinë e ujit të pijshëm në rajonin e tyre;

b) Instituti i Shëndetit Publik përgatit raportin vjetor kombëtar mbi cilësinë e ujit të pijshëm;

c) Ministria e Shëndetësisë përgatit raportin trevjeçar mbi cilësinë e ujit të pijshëm.

3. Raportet sipas pikës 2 (“a” dhe “b”) botohen në faqen e internetit të institucionit përkatës brenda muajit të parë të vitit. Raporti i parë do t’i referohet vitit të parë pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

4. Raporti sipas pikës 2 (c) botohet në faqen e internetit të Ministrisë së Shëndetësisë brenda tremujorit të parë të vitit të parë të periudhës trevjeçare. Raporti i parë do t’i referohet trevjeçarit të parë pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 27

Dispozita të fundit dhe kalimtare

1. Afatet e përputhshmërisë

Administratorët duhet të marrin masat e duhura për të plotësuar kërkesat lidhur me vlerat parametrike të vendosura në këtë rregullore brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, me përjashtim të këtyre parametrave: antimon, arsenik, hidrokarbure aromatike shumëciklike, plumb, tetrakloretilen e trikloretilen, Trihalometan (THMs) - total akrilamidë, epiklorhidrinë, hekur, për të cilët, afati kufi për përputhshmërinë është treguar në shtojcën 1, pjesa B.

2. Raste përjashtuese

a) Në raste të veçanta dhe për zona gjeografikisht të përcaktuara, nëse furnizimi me ujë të pijshëm në përputhje me vlerat parametrike, sipas shtojcës I, nuk mund të sigurohet me asnjë mjet tjetër të përshtatshëm, administratori i paraqet strukturës rajonale të shëndetit publik kërkesën për lejimin e një periudhe më të gjatë se ajo e vendosur në pikën 1. Periudha shtesë nuk mund të jetë më shumë se një vit.

b) Kërkesa sipas shkronjës “a” duhet të përmbajë arsyet, vështirësitë e hasura dhe të përfshijë si minimum të gjithë informacionin e specifikuar në nenin 25, pika 2.

c) Struktura rajonale e shëndetit publik shqyrton kërkesën në përputhje me procedurën sipas nenit 25.

d) Administratori siguron që popullsia e prekur nga kjo kërkesë të informohet në mënyrën e duhur për shtyrjen dhe, kur është e nevojshme të jepen këshilla për grupe të veçanta të popullsisë, për të cilat shtyrja mund të ketë një rrezik të veçantë.

e) Ky nen nuk zbatohet për ujin e pijshëm të furnizuar me anë të rezervuarëve, si dhe për atë të ambalazhuar në shishe apo enë.

3. Zonat e mbrojtjes higjienosanitare

Brenda dy viteve, nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, organet e qeverisjes vendore dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave duhet të inventarizojnë të gjitha burimet ujore që përdoren për prodhimin e ujit të pijshëm. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës informohet dhe

ndjek nga afër procesin, në mbështetje të shoqërive ujësjellës-kanalizime. Ministria e Shëndetësisë verifikon respektimin e kërkesave për zonat e mbrojtjes sanitare dhe të përcakton

masat që duhen marrë nga organet e qeverisjes vendore për plotësimin e kërkesave, si dhe afatet për secilën masë.

SHTOJCA I
KËRKESAT E CILËSISË PËR UJIN E PIJSHËM, 1. PARAMETRAT, VLERAT E TYRE DHE METODAT STANDARDE TË ANALIZAVE

PJESA A P
ARAMETRAT MIKROBIOLOGJIKË

Nr.	Parametri	Vlera parametrike (numër/100 ml)	Njësia	Shënime	Metoda e përcaktimit
1	<i>Escherichia coli</i> (<i>E. coli</i>)	0	numër/100 ml		S SH ISO 9308 –1 S
2					SH ISO 9308 –2 S
	SH ISO 9308 –3				
2	Enterokoki	0	numër/100 ml		S SH ISO 7899 -1
3					S SH ISO 7899 -2
	<i>Clostridium perfringens</i> (duke përfshirë sporet)	0	numër/100 ml	Shënimi 1	S SH ISO 6461 -1
					S SH ISO 6461 -2

Shënimi 1. Matet vetëm nëse uji e ka origjinën ose ndikohet nga ujërat sipërfaqësore. Në rast të mospërputhjes me vlerën parametrike, duhet të kontrollohet uji në VTUP ose në rezervuar, për të siguruar se nuk ka rrezik për shëndetin publik nga prania e mikroorganizmave *patogjenikë, si p.sh., Cryptosporidium.*

Për ujin e ambalazhuar të ofruar për shitje zbatohen të dhënat e mëposhtme:

Nr.	Parametri	Vlera parametrike	Metoda e përcaktimit
1	<i>Escherichia coli</i> (<i>E. coli</i>)	0/250 ml	S SH ISO 9308 –1
2			S SH ISO 9308 –2
2	Enterokoki	0/250 ml	ISO 7899 -2
3			
4	<i>Pseudomonas aeruginosa</i>	0/250 ml	S SH ISO 16266
5	Llogaritja e kolonisë në 22 °C	100/ml	S SH ISO 6222
	Llogaritja e kolonisë në 37 °C	20/ml	S SH ISO 6222

PJESA B.1

PARAMETRAT KIMIKË

Nr.	Parametri	Vlera parametrike	Njësia	Shënime	Metoda e përcaktimit
6	Agjentë sipërfaqësorë që reagojnë me blumetilenin shprehur në	200	µg/l		S SH ISO 7875-1
7	IAAunrtimlounlfadterimë31.12.2024	5,0 10,0	µg/l		S SH EN ISO 17294–1 S SH EN ISO 17294–2 S SH ISO 23914-2
8	Argjend	10.0	µg/l		S SH ISO 11885
9	Arsenik Deri më 31.12.2024	10 50	µg/l		S SH ISO 6595 S SH EN ISO 11969 S SH EN ISO 17294–1 S SH EN ISO 17294–2
10	Bakër	2,0	mg/l	Shënimi 1	S SH ISO 8288 S SH ISO 11885 S SH EN ISO 15587-1 S SH EN ISO 15587-2 S SH EN ISO 17294–1 S SH EN ISO 17294–2
11	Benzol	1,0	µg/l		S SH ISO 11423-1 S SH ISO 11423-2 S SH EN ISO 15586
12	Benzo(a)piren	0,010	µg/l		S SH EN ISO 17993

13	Bor	1,0	mg/l		S SH ISO 9390 S SH EN ISO 17294-1 S SH EN ISO 17294-2
14	Bromat	10	µg/l	Shënimi 2	S SH EN ISO 15061
15	Cianur	50	µg/l		S SH ISO 6703-1 S SH ISO 6703-2 S SH ISO 6703-3 S SH EN ISO 14403
16	1,2-diklorethan	3,0	µg/l		S SH EN ISO 10301 Fresenius (metodë gjermane) (*)
17	Fenol (C ₆ H ₅ OH)	0.5	µg/l	Shënimi 3	S SH ISO 6439
18	Fluor	1,5	mg/l		S SH EN ISO 10304-1 S SH ISO 10359-1
19	Fosfat (P ₂ O ₅)				S SH ISO 6878
20	Hidrokarbure aromatike shumëciklike (PAH) Shuma e përqendrimeve të: benzo(b)fluoranten benzo(k)fluoranten benzo(ghi)perilen indeno (1,2,3-cd) piren Deri më 31.12.2024	0,10 0,20	µg/l µg/l		S SH ISO 7981-1 S SH ISO 7981-2 S SH EN/ ISO 17993
21	Kadmium	5,0	µg /l		S SH EN ISO 5961 S SH ISO 8288 S SH ISO 11885 S SH EN ISO 15587-1 S SH EN ISO 15587-2 S SH EN ISO 17294-1 S SH EN ISO 17294-2
22	Krom	50	µg/l		S SH ISO 9174 S SH ISO 11885 S SH EN ISO 15587-1 S SH EN ISO 15587-2
23	Merkur	1,0	µg/l		S SH IS O 5666 S SH EN ISO 15586 S SH ISO 16590 S SH ISO 17852
24	Nikel	20	µg/l	Shënimi 1	S SH ISO 8288 S SH ISO 11885 S SH EN ISO 15586 S SH EN ISO 15587-1 S SH EN ISO 15587-2 S SH EN ISO 17294-1 S SH EN ISO 17294-2
25	Nitrat (NO ₃)	50	mg/l	Shënimi 4	S SH ISO 7890-3 S SH EN ISO 10304-1 S SH ISO 13395
26	Nitrit (NO ₂)	0,50	mg/l	Shënimet 4	S SH ISO 6777 S SH EN ISO 10304-1 S SH ISO 13395
27	PesticideindividualMepërqashtim për rastin e: aldrinës dieldrinës heptaklorit heptaklor epoksidit	0,10 0,03 0,03 0,03 0,03	µg/l µg/l µg/l µg/l µg/l	Shënimi 5	S SH EN ISO 11369 S SH EN ISO 15913 Fresenius (metodë gjermane) (*)
28	Pesticide — Total	0,50	µg/l	Shënimi 6	Fresenius (metodë gjermane) (*)

29	Plumb Nga 1.1.2021 deri më 31.12.2024 Deri në 31.12.2020	10 25 50	µg/l µg/l µg/l	Shënimi 1	S SH ISO 8288 S SH ISO 11885 S SH EN ISO 15586 S SH EN ISO 15587-1 S SH EN ISO 15587-2 S SH EN ISO 17294-1 S SH EN ISO 17294-2
30	Selen	10	µg/l		S SH EN ISO 9965 S SH ISO 11885 S SH EN ISO 17294-1 S SH EN ISO 17294-2
31	Tetrakloretilen dhe Triklloretilen	10 –	µg/l µg/l	Shuma e përqendrimeve të parametrave të specifikuar;	S SH EN/ ISO 10301 Fresenius (metodë gjermane) (*)
32	Trihalometan (THMs)— Total: Shuma e përqendrimeve të: bromdiklorometan bromoform kloroform dibromklormetan Deri më 31.12.2024	100 150	µg/l µg/l	Shënimet 7, 8 dhe 9	S SH EN ISO 10301 Fresenius (metodë gjermane) (*)
33	Zink	3	mg/l		S SH ISO 8288 S SH ISO 11885 S SH EN ISO 15586 S SH EN ISO 15587-1 S SH EN ISO 15587-2 S SH EN ISO 17294-1 S SH EN ISO 17294-2

(*) Fresenius, metodë gjermane që përdoret aktualisht në ISHP.

Shënimi 1. Vlera i referohet një kampioni të ujit të pijshëm të marrë në rubinet me anë të një metode të përshtatshme kampionimi dhe e zgjedhur në mënyrë të tillë që të jetë përfaqësuese e vlerës mesatare javore të marrë nga përdoruesit nëpërmjet ujit të pijshëm. Struktura rajonale e shëndetit publik duhet të mbajë parasysh nivelet kulmore që mund të dëmtojnë shëndetin publik.

Shënimi 2. Do të matet kur në pastrimin e ujit të pijshëm përdoret ozoni dhe do të matet të paktën në veprën e trajtimit të ujit. Ku është e mundur, pa kompromentuar dezinfektimin, duhet të bëhen përpjekje për të zbatuar vlera më të ulëta.

Shënimi 3. Përfshihen fenolet natyrore që nuk reagojnë ndaj klorit.

Shënimi 4. Duhet të sigurohet kushti: $[\text{nitrat}]/50 + [\text{nitrit}]/3 \leq 1$, ku kllapat katrore tregojnë përqendrime në mg/l për nitratin (NO₃) dhe nitritin (NO₂) dhe të respektohet vlera 0.10mg/l për nitritet në ujin nga VTUP.

Shënimi 5. Pesticidet e përcaktuara në nenin 2, pika 9.

Shënimi 6. Shuma e të gjitha pesticideve individuale të hasura dhe të matura në procedurën e monitorimit.

Shënimi 7. Matet kur për dezinfektim përdoret klor ose derivate të tij.

Nëse përdoret dyoksid klori, do të maten kloruret në VTUP ose në rezervuar.

Shënimi 8. Sa herë që nivelet janë mbi vlerat parametrike, do të maten 2,4,6-triklorfenoli ose LSD-të e dezinfektimit në VTUP ose në rezervuar.

Shënimi 9. Administrator/ët e ujësjellësve duhet të përpiqen për një vlerë sa më të ulët, pa kompromentuar vetë dezinfektimin.

PJESA B.2
PARAMETRAT KIMIKË QË MONITOROHEN SIPAS SPECIFIKIMEVE TË
PRODUKTIT

Nr.	Parametri	Vlera parametrike	Njësia	Shënime	Metoda e përcaktimit
34	Akrilamid deri në 31.12.2024	0,10 0,25	µg/l µg/l	Shënimi 1	Nuk ka metodë standard S SH EN ISO
35	Epiklorhidrinë deri më 31.12.2024	0,10 0,50	µg/l µg/l	Shënimi 1	S SHEN 14207
36	Klorvinil	0,50	µg/l	Shënimi 1	Nuk ka metodë standard S SH EN ISO

Shënimi 1. Vlera parametrike i referohet përqendrimit monomerik mbetës në ujë, llogaritur në përputhje me specifikimet e lëshimit maksimal nga polimeri përkatës në kontakt me ujin.

Kompania që tregton këto produkte pajis administratorët dhe montuesit e instalimeve brenda godinave dhe strukturave me dokumentacionin që tregon shkarkimin maksimal të produktit tregtar që është në kontakt me ujin e pijshëm kur ai është përdorur sipas specifikimeve të përdorimit të dhëna nga prodhuesi.

PJESA C
PARAMETRAT TREGUES

Nr.	Parametri	Vlera parametrike	Njësia	Shënime	Metoda e përcaktimit
37	Alumin	200	µg/l		S SHISO 10566 S SHEN ISO 12020 S SHEN ISO 17294-1 EN/ ISO 17294-2
38	Amonium	0,10	mg/l	Shënimi 1	S SHISO 5663 S SHISO 6778 S SHISO 7150 S SHISO 11732 S SHEN ISO 14911
39	Aromë	E pranueshme për konsumatorin dhe pa ndryshime jonormale			S SHEN 1622
40	Azot KJELDAHL	1,0	mg/l		S SHISO 5663
41	Bakterie koliforme	0	numër/ 100 ml	Shënimi 2	S SHISO 9308 -1 S SHISO 9308 -2 S SHISO 9308 -3
42	Fortësi	10-20	°dH	Shënimi 3	S SHISO 6059 S SHEN ISO 7980
43	Hekur Deri më 31.12.2024	200 300	µg/l µg/l		S SHISO 6332 S SHEN ISO 11885 S SHEN ISO 15586 S SHEN ISO 15587-1 S SHEN ISO 15587-2
44	Kalcium	200	mg/l		S SHISO 6058 S SHEN ISO 7980
45	Kalium	12	mg/l		S SHISO 9964-2 S SHISO 9964-3 S SHISO 11885 S SHEN ISO 17294-1 S SHEN ISO 17294-2
46	Karbon organik total (TOC)	Pa ndryshime jonormale		Shënimi 4	S SHISO 8245
47	Klor i lirë mbetës	0.5	mg/l	Shënimet 5, 6 dhe 7	S SHISO 7393

48	Klori kombinuar mbetës	2.0	mg/l	Shënimet 5, 6 dhe 8	S SHISO 7393
49	Klorure	250	mg/l	Shënimi 9	S SHISO 9297 S SH EN ISO 10304- S SHISO 15682
50	Llogaritja e kolonisë 22°C	Pa ndryshime jonormale			S SHISO 6222
51	Magnez	50	mg/l		S SHEN/ ISO 7980
52	Mangan	50	µg/l		S SHISO 6333 S SHISO 11885 S SHEN ISO 15586 S SHEN ISO 15587-1 S SHEN ISO 15587-2
53	Mbetje e thatë në 180°C	500	mg/l	Shënimi 10	
54	Natrium	200	mg/l		S SHISO 9964-1 S SHISO 9964-3 S SHEN ISO 17294- S SHEN ISO 17294-
55	Ngjyrë	Pa ndryshime jonormale			S SHISO 788
56	Oksidueshmëri	5,0	mg/l O ₂	Shënimi 4	
57	Oksigjen i tretur	≥ 8,0	mg/l		S SHISO 5813 S
58	Përcjellshmëri	2 500	µS cm ⁻¹ në 20 °C	Shënimi 8	S SHISO 7888
59	Përqendrimi i joneve të hidrogjenit (pH)	≥ 6,5 dhe ≤ 9,5	pH njësi	Shënimet 9 dhe 11	S SHISO 10523
60	Sulfat	250	mg/l	Shënimi 9	S SHEN ISO 10304-1, S SHISO 22743
61	Shije	E pranueshme për konsumatorin dhe pa ndryshime jonormale			S SHEN 1622
62	Temperaturë	15	°C	Shënimi 12	
63	Turbullirë	E pranueshme për konsumatorin dhe pa ndryshime jonormale		Shënimi 13	S SHISO 7027

Shënimi 1. Vlera 0.5 mg/l e parametrin lejohet:

1. kur vërtetohet nga studimi hidrogjeologjik i burimit ujor se është me origjinë shtresore, nëntokësore, e pa ndikuar nga ndotja organike e jashtme,
2. vetëm me vendim të veçantë të ISHSH-së.

Shënimi 2. Për ujërat e ambalazuara njësia është “numër/250 ml”.

Shënimi 3. Vlera 25 °dH (gradë gjermane) e parametrin lejohet vetëm me vendim të veçantë të ISHSH-së.

Shënimi 4. TOC-i do të matet për furnizime me më shumë se 10 000 m³ ujë në ditë, përndryshe do të matet oksidueshmëria.

Shënimi 5. Vlera e parametrin deri në 1.0 mg/l lejohet vetëm me vendim të veçantë të ISHSH-së. Në ndërmarrjet e prodhimeve ushqimore, ky parametër nuk ka nevojë të matet në ujin e proceseve ushqimore.

Shënimi 6. Do të analizohet nëse në trajtimin pastrues të ujit është përdorur klor ose LSD-të e tij. Nëse është përdorur dyoksid klori, duhet të maten kloruret në VTUP.

Shënimi 7. Matja e nivelit të klorit të lirë në rrjetin e ujësjellësit bëhet nga administratori 2 herë në ditë në pikat e monitorimit dhe çdo orë në dalje të rezervuarëve. Këto rezultate regjistrohen në regjistrin përkatës, duke shtuar edhe veçori të tjera, nëse ato vihen re gjatë matjes, si: turbullirë, ngjyrë etj.

Shënimi 8. I nevojshëm vetëm kur kloraminimi përdoret si dezinfektant.

Shënimi 9. Uji nuk duhet të jetë agresiv.

Shënimi 10. Vlera më e lartë e lejueshme është 1000 mg/l.

- Shënimi 11.* Për ujërat e ambalazuara të pagazuara, vlera minimale mund të ulet në 4,5 njësi pH.
Për ujërat të ambalazuara, që janë të pasur në mënyrë natyrale ose janë pasuruar artificialisht me dyoksid karboni, vlera minimale mund të jetë më e ulët.
- Shënimi 12.* Vlera më e lartë e lejueshme është 20 °C.
- Shënimi 13.* Në rast të trajtimit të ujit sipërfaqësor, duhet të synohet për një vlerë më të vogël se 1.0 NTU (njësi nefelometrike e turbullirës) në ujën që del nga vepra e trajtimit.

PJESA D
RADIOAKTIVITETI

Nr.	Parametri	Vlera parametrike	Njësia	Shënime
64	Aktivitet alfa total	0,10	Bq/l	
65	Aktivitet beta total	1,0	Bq/l	Shënimi 1
66	Dozë totale treguese	0,10	mSv/vit	Shënimet 2 dhe 4
67	Tritium	100	Bq/l	Shënimet 3 dhe 4

- Shënimi 1.* Duke përjashtuar tritiumin dhe kaliumin⁴⁰.
- Shënimi 2.* Duke përjashtuar tritiumin, kaliumin⁴⁰, radonin dhe produktet e degradimit të radonit. Shpeshësia e monitorimit, metodat dhe vendndodhjet më të rëndësishme për pikat e monitorimit do të vendosen në vijim në shtojcën II.
- Shënimi 3.* Shpeshësia e monitorimit do të vendosen në vijim në shtojcën II.
- Shënimi 4.* ISHSH-ja mund të mos kryejë kontrollin e ujit të pijshëm për tritium apo për radioaktivitet për të vendosur dozën e totale treguese nëse në bazë të monitorimeve të tjera të kryera, nivelet e tritiumit ose doza totale treguese e llogaritur, janë mjaft poshtë vlerës parametrike. Në këtë rast, ai i komunikon Ministrisë së Shëndetësisë arsyet e këtij vendimi, duke përfshirë rezultatet e këtij monitorimi.

SHTOJCA II
MONITORIMI

TABELA A PARAMETRA QË DUHET TË
ANALIZOHEN

1. Ekzaminimi organoleptik

Ka të bëjë me vlerësimin e karakteristikave të ujit të pijshëm në bazë të aromës, shijes, ngjyrës dhe turbullirës.

2. Kontrolli i rutinë

Kontrolli rutinë ka për qëllim t'i ofrojë administratorit dhe autoritetit shëndetësor informacion të rregullt mbi cilësinë mikrobiologjike dhe organoleptike të ujit të pijshëm, si dhe informacion mbi efektshmërinë e trajtimit të tij (veçanërisht të dezinfektimit), për të përcaktuar nëse uji i pijshëm është apo jo në pajtueshmëri me vlerat parametrike të vendosura në shtojcën I, pika 1 e kësaj rregulloreje.

A. Parametrat bazë të përfshirë në këtë monitorim: aromë, shije, ngjyrë, temperaturë, turbullirë, përcjellshmëri, pH, fortësi e përgjithshme, amonium, *Escherichia coli* (*E.coli*), koliform bakteria *Pseudomonas aeruginosa* (kur uji ofrohet për shitje në shishe ose enë (*)).

B. Parametrat që të paktën do të përcaktohen në pikën ku uji del nga VTUP/depo e ujit ose në mungesë të tyre në pikën ku uji del nga rezervuari rregullues dhe/ose shpërndarës:

- a) Hekur: kur është përdorur si flokulent. (*)
- b) Alumini: kur është përdorur si flokulent. (*)
- c) Koloni e llogaritur në 22°C.

d) *Clostridium perfringens* (përfshirë sporet): kur uji buron ose ndikohet nga ujërat sipërfaqësore[†] (*).

C. Parametrat lidhur me metodën e dezinfektimit:

- a) Nitrit: kur është përdorur kloraminimi.
- b) Klor i lirë mbetës: kur është përdorur klori ose LSD-të e tij.
- c) Klor i kombinuar mbetës: kur është përdorur kloraminimi.

Autoriteti shëndetësor, sa herë që e vlerëson të nevojshme për mbrojtjen e shëndetit të popullatës së furnizuar, përfshin parametra të tjerë në monitorimin rutinë.

3. Kontrolli verifikues

Kontrolli verifikues ka për qëllim t'i japë administratorit dhe autoritetit shëndetësor

[†] Në të gjitha rastet e tjera, parametrat janë në listën e kontrollit verifikues.

informacionin e nevojshëm për të përcaktuar nëse janë respektuar apo jo të gjitha vlerat parametrike të specifikuar në shtojcën I, pika 1 të kësaj rregulloreje. Të gjithë këta parametra janë subjekt i kontrollit verifikues, përveç parametrave që vlerësohen nga struktura rajonale e shëndetit publik se, për një periudhë të caktuar, nuk kanë gjasa që në një furnizim të dhënë të jenë në përqendrimet të tilla që mund të çojnë në rrezikun e shkeljes së vlerave përkatëse parametrike. Ky paragraf nuk zbatohet për parametrat për radioaktivitetin.

SHPESHTËSIA MINIMALE E MARRJES SË KAMPIONËVE DHE ANALIZAVE PËR UJIN E PIJSHËM TË FURNIZUAR NGA NJË RRJET SHPËRNDARËS, NGA NJË DEPOZITË OSE TË PËRDORUR NË NJË NDËRMARRJE PRODHIMI USHQIMOR

Kampionët do të merren në pikat e përcaktuara në nenin 7 për të siguruar që uji i pijshëm të plotësojë kërkesat e kësaj rregulloreje. Gjithsesi, në rastin e një rrjeti shpërndarës, për parametra të veçantë, kampionët mund të merren në zonën e furnizimit ose në VTUP, nëse tregohet se nuk do të ketë një ndryshim negativ të vlerës së matur për parametrat në fjalë.

TABELA B1

Vëllimi i ujit të shpërndarë ose prodhuar çdo ditë brenda një zone të furnizimit (shënimet 1 e 2) m³	Kontrolli rutinë – Numri i kampionëve në vit (shënimet 3, 4 e 5)	Kontrolli verifikues – Numri i kampionëve në vit (shënimet 3 e 5)
≤ 100	(shënim 6)	(shënim 6)
> 100 ≤ 1 000	4	1
> 1 000 ≤ 10 000	4 +3 për çdo 1 000 m ³ /d të vëllimit total dhe fraksion i 1 000	1 +1 për çdo 3 300 m ³ /d të vëllimit total dhe fraksion i 3 300
> 10 000 ≤ 100 000		3 +1 për çdo 10 000 m ³ /d të vëllimit total dhe fraksion i 10 000
> 100 000		10 +1 për çdo 25 000 m ³ /d të vëllimit total dhe fraksion i 25 000

Shënimi 1 Zona e furnizimit sipas përcaktimit në pikën 20 të nenit 2 përcaktohet nga katër faktorë:
a) emri brenda secilës zonë;
b) kodi i identifikimit;
c) numri i banorëve të furnizuar;
d) vëllimi mesatar i ujit të furnizuar çdo ditë, llogaritur në bazë të furnizimit vjetor.

Shënimi 2 Vëllimet e llogaritura përfaqësojnë mesataren vjetore.

Shënimi 3 Në rast të ndërprerjes për një kohë të shkurtër të furnizimit, shpeshësia e monitorimit të ujit të shpërndarë nga autobotët vendoset nga struktura rajonale e shëndetit publik.

Shënimi 4 Për parametra të ndryshëm në shtojcën I, struktura rajonale e shëndetit publik mund të pakësojë numrin e kampionëve të specifikuar në tabelë, nëse:

- a) Vlerat e rezultateve të përfutuara nga kampionët e marrë gjatë një periudhe prej të paktën dy vjet rresht janë konstant dhe dukshëm më mirë sesa limitet e përcaktuara në shtojcën I, dhe
 - b) Nuk ekziston asnjë faktor që mund të shkaktojë përkeqësimin e cilësisë së ujit.
- Shpeshësia minimale nuk duhet të jetë më e vogël se 50 % e numrit të kampionëve të treguar në tabelë, përveç rastit të veçantë të shënimet 6.

Shënimi 5 Sa të jetë e mundur, numri i kampionëve duhet të shpërndahet në mënyrë të barabartë në kohë dhe në hapësirë.

Shënimi 6 Shpeshësia do të vendoset nga struktura rajonale e shëndetit publik.

TABELA B2

Shpeshtësia minimale për marrjen dhe kryerjen e analizave për kontrollin e ujërave të ambalazuara në shishe apo enë si ujë i pijshëm.

Vëllimi i ujit të prodhuar çdo ditë për shitje në shishe apo enë (1)	Kontrolli rutinë – numri i kampionëve në vit	Kontrolli verifikues – Numri i kampionëve në vit
$\leq 10_3$	1	1
$m > 10 \leq 60$	12	1
> 60	12 +1 për çdo 5 m ³ dhe fraksion të vëllimit total	1+ 1 për çdo 100 m ³ dhe fraksion të vëllimit total

(¹) Vëllimet janë llogaritur si mesatare të marra gjatë një viti kalendarik.

TABELA B3

Shpeshtësia minimale për marrjen dhe kryerjen e analizave për kontrollin e ujit të pijshëm në rubinetin e konsumatorit.

Numri i banorëve të furnizuar	Numri minimal i kampionëve në vit
≤ 500	4
$> 500 \leq 5\ 000$	6
$> 5\ 000$	6 + 2 për çdo 5 000 banorë dhe fraksion të 5

SHTOJCA III SPECIFIKIMET PËR ANALIZAT E PARAMETRAVE

A. Parametrat për të cilët janë specifikuar metodat e analizave

Paramet e mëposhtme për metodat e analizave të parametrave mikrobiologjikë janë dhënë ose për referencë, sa herë që jepet një metodë EN/ISO ose si udhëzim, në pritje të përshtatjes së mundshme në të ardhmen të metodave ndërkombëtare të mëtejshme për këta parametra.

Laboratorët mund të përdorin metoda alternative, me kusht që ato të jenë të vlefshme apo të kredituara ose të jetë demonstruar ekuivalenca e saj dhe të jetë në përputhje me sa është përcaktuar në pikën 1, të nenit 18.

Coliform bacteria dhe *Escherichia coli* (*E. coli*) (ISO 9308-1)

Enterokoki (ISO 7899-2)

Pseudomonas aeruginosa (S SH ISO 12780)

Numërimi i mikroorganizmave të kultivueshëm — llogaritja e kolonisë në 22 °C (S SH ISO 6222)

Numërimi i mikroorganizmave të kultivueshëm — llogaritja e kolonisë në 37 °C (S SH ISO 6222)

Clostridium perfringens (duke përfshirë sporet)

Filtrimi me membranë i ndjekur nga inkubacioni anaerobik i membranës mbi m-CP agar (shënimi 1) në 44±1°C për 21± 3 orë. Llogariten kolonitë e verdha opake që kthehen në ngjyrë rozë ose të kuqe pas ekspozimit ndaj hidrosidit të amoniumit që avullojnë për 20 deri 30 sekonda.

Shënimi 1. Përbërja e m-CP agar është:
Medium bazik

Triptose	30 g
Ekstrat tharmi	20 g
Sucrose	5 g
L-cysteine hirokloride	1 g
MgSO ₄ · 7H ₂ O	0,1 g
Bromocresol i purport	40 mg
Agar	15 g
Ujë	1000ml

Shpërbë përbërësit e mediumit bazik, rregullo pH në 7,6 dhe autoklavë në 121°C për 15 minuta. Lejo mediumin të ftohet dhe shto:

D-cicloserine	400 mg
Polymyxine-B sulfat	25 mg
Indoxyl-(3-D-glucoside)	60 mg

Të tretet në 8 ml ujë steril përpara shtimit

Filtër — 0,5% phenolphthalein i sterilizuar	20 ml
Tretësira e diphosphate	

Filtër — 4,5 % FeCl ₃ · 6H ₂ O i sterilizuar	2 ml
--	------

B. Parametra për të cilët janë specifikuar karakteristikat e performancës

B.1 Për parametrat e mëposhtëm, për karakteristikat e specifikuar të performancës synohet që metoda e analizave e përdorur të jetë në gjendje, të paktën, të masë përqendrime të njëjtë me vlerën parametrike me një vërtetësi, saktësi dhe kufi diktimi të specifikuar. Metodot e përmendura, nëse nuk janë të ngjashme me ato të referimit sipas nenit 4, pika 1, shkronja “d”, duhet t’i dërgohen

paraprakisht Institutit të Shëndetit Publik, që ka të drejtën ta verifikojë sipas sa jepet në rregulloren e aprovimit të metodave të referimit. Pavarësisht nga ndjeshmëria e metodës së analizave të përdorur,

rezultati duhet të jetë shprehur duke përdorur të njëjtin numër decimalesh të përdorur për vlerën parametrike sipas shtojcës I, pjesët B dhe C.

Parametrat	Vërtetësia në % e vlerës parametrike (shënim 1)	Saktësia në % e vlerës parametrike (shënim 2)	Kufiri i diktimit në % të vlerës parametrike (shënim 3)	Kushtet	Shënime
Alumin	10	10	10		
Amonium	10	10	10		
Antimon	25	25	25		
Arsenik	10	10	10		
Bakër	10	10	10		
Benzo(a)piren	25	25	25		
Benzol	25	25	25		
Bor	10	10	10		
Brom	25	25	25		
Cianur	10	10	10		Shënimi 4
1,2-dikloretan	25	25	10		
Fluor	10	10	10		
Hekur	10	10	10		
Hidrokarbure aromatike shumëciklike	25	25	25		Shënimet 5 e 6
Kadmium	10	10	10		
Klorure	10	10	10		
Krom	10	10	10		
Mangan	10	10	10		
Mërkur	20	10	20		
Nikel	10	10	10		
Nitrat	10	10	10		
Nitrit	10	10	10		
Oksidueshmëri	25	25	10		Shënimi 7
Pesticide	25	25	25		Shënimet 6 e 8
Përçueshmëri	10	10	10		
Plumb	10	10	10		
Selen	10	10	10		
Natrium	10	10	10		
Sulfat	10	10	10		
Tetrakloretilen	25	25	10		Shënimi 9
Trikloretilen	25	25	10		Shënimi 9
Trihalometan-Total	25	25	10		Shënimi 5

B.2. Për përqendrimin e joneve hidrogjen, karakteristikat e specifikuara të performancës janë të tilla që metoda e analizimit e përdorur duhet të mund të masë përqendrime të njëjtë me vlerën parametrike me një vërtetësi prej 0.2 pH njësi dhe një saktësi prej 0,2 pH njësi.

Shënimi 1. Vërtetësia, vlera numerike e së cilës është gabimi sistematik, është diferenca midis vlerës mesatare të një numri të madh matjesh të përsëritura dhe vlerës së vërtetë (*).

Shënimi 2. Saktësia mat shpërndarjen e rezultateve përreth vlerës mesatare; zakonisht shprehet si devijimi standard brenda një grupi homogjen kampionësh dhe varet vetëm nga gabimet e rastit (*). (*) Këta terma janë përcaktuar më tej në ISO 5725.

Shënimi 3. Kufiri i diktimit është ose:

- trefishi i devijimit standard relativ brenda grupit të një kampioni natyral që përmban një përqendrim të ulët të parametrarit;
- ose
- pesëfishi i devijimit standard relativ brenda grupit të një kampioni të bardhë.

Shënimi 4. Metoda duhet të përcaktojë cianurin total në të gjitha format.

Shënimi 5. Karakteristikat e performancës zbatohen për çdo substancë të specifikuar në 25% të vlerës parametrike në shtojcën I.

- Shënimi 6.* Aktualisht, kufiri i diktimit mund të mos jetë i arritshëm për disa pesticide dhe hidrokarbure aromatikë, por duhet të bëhen përpjekje për arritjen e këtij objekti.
- Shënimi 7.* Oksidimi duhet të kryhet për 10 minuta në temperaturë 100°C në mjedis acid duke përdorur permanganat.
- Shënimi 8.* Karakteristikat e performancës zbatohen për çdo pesticid dhe varen nga pesticiidi në konsideratë.
- Shënimi 9.* Karakteristikat e performancës zbatohen për çdo substancë të specifikuar në 50% të vlerës parametrike në shtojcën I.

C. Parametra për të cilët nuk janë specifikuar metodat e analizës

Ngjyra

Aroma

Shija

Karboni organik total

Turbullira (shënim 1)

Shënimi 1. Për monitorimin e turbullirës në ujërat sipërfaqësore të trajtuara, karakteristikat e specifikuar të performancës janë të tilla që metoda e analizës e përdorur duhet, si minimum, të mund të masë përqendrimet të barabarta me vlerat parametrike me një vërtetësi prej 25%, një saktësi prej 25% dhe një kufi diktimi prej 25%.

SHTOJCA IV

KËRKESAT HIGJENOSANITARE PËR SIGURIMIN E CILËSISË SË UJIT TË PIJSHËM TË PUSEVE

1. Puset kolektive

Respektimi i rregullave higjienosanitare për ruajtjen në çdo kohë të gjendjes së ujit të këtyre puseve brenda kërkesave të cilësisë së ujit të pijshëm është përgjegjësi e administratorit.

Administratori merr me shkrim nga struktura rajonale e shëndetit publik dozat e nevojshme për dezinfektimin e ujit dhe metodikën e përgatitjes së solucionit dezinfektues.

Administratori vepron sipas nenit 14, pika 3 dhe 4 e kësaj rregulloreje.

2. Puset individuale

Administratori (pronari) i pusit individual për ujë të pijshëm, është përgjegjës për mirëmbajtjen e pusit.

Nuk lejohet lidhja e puseve individuale me rrjetin e ujësjellësit të zonës së banuar.

Me kërkesën e pronarit, struktura rajonale e shëndetit publik kryen analizat e ujit të pusit. Shpenzimet e analizave i përballon vetë pronari.

Në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 125, datë 13.3.1995, "Për financimin e kujdesit

shëndetësor për masat parandaluese e mjekuese ndaj sëmundjeve ngjitëse", kur ka indikacione epidemiologjike, shfaqje të vatrave të sëmundjeve me origjinë nga uji, ekzaminimet laboratorike të ujit të puseve individuale përballohen nga shteti.

Dezinfektimi i ujit të puseve individuale bëhet nga pronari, duke marrë me shkrim nga struktura rajonale e shëndetit publik dozën e nevojshme dhe metodikën e kryerjes së dezinfektimit.

Administratori vepron sipas nenit 14, pikat 3 dhe 4 të kësaj rregulloreje.

3. Dezinfektimi i puseve

Ashtu si veprat e tjera të ujësjellësit, edhe puset individuale ose kolektive, që shërbejnë për furnizimin me ujë të pijshëm të popullatës, u nënshtrohen rregullave të higjienës. Ato pastrohen, mirëmbahen dhe dezinfektohen herë pas here.

Muret e puseve pastrohen, lahen me solucion klori që përmban 100 mg/l klor aktiv. Ky solucion përgatitet duke tretur rreth 40 g hipoklorit kalciumi (me 25% klor aktiv) në 100 litra ujë. Pasi matet vëllimi i ujit në pus, hidhet solucionin duke llogaritur që përmbajtja e klorit aktiv të arrijë 50–100 mg/l dhe të ketë shpërndarje uniforme. Uji në pus lihet të qëndrojë në këtë gjendje rreth 12 orë dhe pastaj nxirret me pompë ose me kovë për t'u riqarkulluar.

4. Sasia e hipokloritit të kalciumit të përdorur për dezinfektimin e ujit të puseve (gr/m³)

Përqindja e klorit aktiv	Volumi i ujit në pus m ³															
	Doza a= 2 mg/l (gr/m ³)				Doza a= 4 mg/l (gr/m ³)				Doza a= 8 mg/l (gr/m ³)				Doza a= 10 mg/l (gr/m ³)			
	V=3 m ³	V=5 m ³	V=7 m ³	V=10 m ³	V=3 m ³	V=5 m ³	V=7 m ³	V=10 m ³	V=3 m ³	V=5 m ³	V=7 m ³	V=10 m ³	V=3 m ³	V=5 m ³	V=7 m ³	V=10 m ³
17	35,3	58,8	82,3	118	71	117	165	235	141	236	329	472	177	295	411	588
20	30	50	70	100	60	100	140	200	120	200	280	400	150	250	350	500
25	24	40	56	80	48	80	112	160	96	160	224	320	120	200	280	400
30	20	33	47	67	40	67	94	134	80	132	188	268	100	165	231	335
35	17	29	40	57	34	57	80	114	69	116	160	228	87	145	203	285
40	15	25	35	50	30	50	70	100	60	100	140	200	75	125	175	250
50	12	20	28	40	24	40	56	80	48	96	112	160	60	100	140	200

Llogaritja e sasisë së lëndës dezinfektuese (g/m³) është bërë sipas mënyrës së mëposhtme:

$V = Vëllimi\ i\ ujit\ (m^3):$

$$V = \pi \times R^2 \times h_{uj}$$

ku: $\pi = 3,14$ R: rrezja e pusit h_{uj} : lartësia e ujit në pus

$X = Nevoja\ për\ klor\ (grCl_2)\ në\ vëllimin\ e\ ujit\ (m^3):$

$X = a \times V$ ku: a - është doza në mg/l (g/m³) klor total

$G = Sasia\ e\ hipokloritit\ të\ kalciumit\ Ca(OCl)_2:$

$$G = \frac{100 \times X}{b}$$

ku: b është përqindja e klorit aktiv

SHTOJCA V
KËRKESAT E CILËSISË SË UJËRAVE SIPËRFAQËSORE QË PËRDOREN PËR PRODHIMIN E
UJIT TË PIJSHËM

1. Karakteristikat e ujërave sipërfaqësore të përcaktuara për prodhimin e ujit të pijshëm

	Parametrat	A1		A2		A3		
		G	I	G	I	G	I	
1	pH	6,5 në 8,5		5,5 në 9,5		5,5 në 9		
2	Ngjyrë (pas filtrimit)	mg/l shkalla Pt	10	20 (O)	50	100 (O)	50	200 (O)
3	Lëndë e ngurtë pezull-total	mg/l SS	25					
4	Temperaturë	C	22	25 (O)	22	25 (O)	22	25 (O)
5	Përçueshmëri	$\mu\text{s}/\text{cm}^{-1}$ at 20° C	1 000		1 000		1 000	
6	Aromë	(faktor hollimi në 25°C)	3		10		20	
7	Nitrat	mg/l NO ₃	25	50 (O)		50 (O)		50 (O)
8(1)	Fluor	mg/l F	0,7 në 1	1,5	0,7 në 1,7		0,7 në 1,7	
9	Hekur i tretur	mg/l Fe	0,1	0,3	1	2	1	
10	Mangan	mg/l Mn	0,05		0,1		1	
11	Bakër	mg/l Cu	0,02	0,05 (O)	0,05		1	
12	Zink	mg/l Zn	0,5	3	1	5	1	5
13	Bor	mg/l B	1		1		1	
14	Arsenik	mg/l As	0,01	0,05		0,05	0,05	0,1
15	Kadmium	mg/l Cd	0,001	0,005	0,001	0,005	0,001	0,005
16	Krom total	mg/l Cr		0,05		0,05		0,05
17	Plumb	mg/l Pb		0,05		0,05		0,05
18	Selen	mg/l Se		0,01		0,01		0,01
19	Merkur	mg/l Hg	0,0005	0,001	0,0005	0,001	0,0005	0,001
20	Barium	mg/l Ba		0,1		1		1
21	Cianure	mg/l Cn		0,05		0,05		0,05
22	Sulfat	mg/l SO ₄	150	250	150	250 (O)	150	250 (O)
23	Klorur	mg/l Cl	200		200		200	
24	Agjentë sipërfaqësorë (që veprojnë në blumetilen)	mg/l (lauril sulfat)	0,2		0,2		0,5	
25(2)	Fosfat	mg/l P ₂ O ₅	0,4		0,7		0,7	
26	Fenole (treguesi i fenoleve) paranitraniline 4 aminoantipirine	mg/l C ₆ H ₅ OH		0,001	0,001	0,005	0,01	0,1
27	Hidrokarbure të tretura ose në emulsion (pas ekstraktimit me eter petrolium)	mg/l		0,05		0,2	0,5	1
	Parametrat		A1		A2		A3	
			G	I	G	I	G	I
28(3)	Hidrokarbure policiklike aromatike	mg/l		0,0002		0,0002		0,001
29	Pesticide total (parathion, HCH (lindan) dhe	mg/l		0,001		0,0025		0,005

	dieldrinë))						
30	Kërkesa kimike për oksigjen (COD)	mg/l O ₂				30	
31	Niveli i ngopjes me oksigjen të tretur	%O ₂	> 70		> 50		> 30
32	Kërkesë biokimike për oksigjen (BOD ₅) (në 20° C pa nitrifikim)	mg/l O ₂	< 3		< 5		< 7
33	Azot me metodën Kjeldahl (përveç NO ₃)	mg/l N	1		2		3
34	Amoniak	mg/l NH ₄	0,05		1	1,5	2
35	Lëndë të ekstraktueshme me kloroform	mg/l SEC	0,1		0,2		0,5
36	Koliforme total 37° C	/100 ml	50		5 000		50 000
37	Koliforme fekal	/100 ml	20		2 000		20 000
38	Streptokok fekal	/100ml	20		1 000		10 000
39	Salmonelë		Jo i pranishëm në 5 000 ml		Jo i pranishëm në 1 000 ml		

I = i detyrueshëm

G = udhëzues

O = kushte të veçanta klimatike ose gjeografike

1. Vlerat e dhëna janë kufijtë e sipërm të vendosur në lidhje me temperaturën mesatare vjetore (e larta dhe e ulëta)

2. Ky parametër është përfshirë për të plotësuar kërkesat ekologjike të tipave të caktuar të mjedisit

3. Vlera e dhënë është për totalin e gjashtë substancave 1 µg/l

Fluoranten

Benzo (3,4) fluoranten

Benzo (11,12) fluoranten

Benzo (3,4) piren

Benzo (1,12) perilen

Indeno (1,2,3-cd) piren

2. Përcaktimet e metodave standarde të trajtimit për transformimin e ujërave sipërfaqësore të kategorive A1, A2 dhe A3 në ujë të pijshëm.

Kategoria A1

Trajtim i thjeshtë fizik dhe dezinfektim, p.sh. filtrim i thjeshtë dhe dezinfektim.

Kategoria A2

Trajtim normal fizik, trajtim kimik dhe dezinfektim, p.sh. paraklorinim, koagulim, flokulim, dekantim, filtrim, dezinfektim (klorinim final).

Kategoria A3

Trajtim intensiv fizik dhe kimik, trajtim i mëtejshëm dhe dezinfektim, p.sh. klorinim deri në pikën e thyerjes (pika ku kemi klor të lirë mbetës), koagulim, flokulim, dekantim, filtrim, absorbim (karbon aktiv), dezinfektim (ozone, klorinim final).

SHTOJCA VI

ZONAT E MBROJTJES SANITARE

1. Mbrojtja sanitare e burimeve të ujërave sipërfaqësore

Në sipërfaqet ujore që përdoren për prodhimin e ujit të pijshëm, janë të ndaluara futja e kafshëve, plazhet, lundrimi, shkarkimi i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë i lëndëve me efekt dëmtes për shëndetin e njeriut ose për cilësinë e ujit, si dhe të gjitha shkarkimet e ujërave të përdorura, të patrajuara deri në nivelet e normave e lejuara.

Vepra e marrjes së ujit, detyrimisht vendoset mbi zonën e shkarkimeve urbane dhe industriale.

2. Mbrojtja sanitare e burimeve të ujërave nëntokësore (Për furnizim publik ose individual)

Shfrytëzimi i një kaptazhi të ri uji nëntokësor i destinuar për konsum njerëzor dhe rritja e marrjes së sasive të ujit nga një vepër ekzistuese, i nënshtrohen përcaktimit të këtyre zonave të mbrojtjes sanitare:

a) zona e parë: *zona imediate ose e rreptësisë e mbrojtjes sanitare* është terreni menjëherë pranë kaptazhit dhe ka për funksion kryesor të pengojë kalimin e të gjitha lëndëve ndotëse në kaptazh. Në brendësi të saj ndalohen të gjitha depozitimet, shkarkimet e ujërave të zeza, përdorimi i pesticideve, ndërtimet dhe aktivitetet përveç atyre që janë të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit të furnizimit me ujë. Gjithë ndërtimet në këtë territor kanalizohen dhe ujërat e zeza derdhen jashtë zonës së rreptësisë në pjesën e poshtme të burimit, në gropë septike të pafiltrueshme, pastrimi i së cilës bëhet sistematikisht. Kjo është zonë e rrethuar dhe e mbyllur.

Në këtë zonë ndalohet banimi ose qëndrimi i përkohshëm i personave pa autorizim dhe i kafshëve.

Toka në këtë zonë nuk mbillet me asnjë kulturë bujqësore. Ajo mbillet vetëm me bar, i cili kositet herë pas here.

Në periferi të kësaj zone nuk lejohet të ndërtohen varreza, fusha të përpunimit të plehut, objekte industriale që shkarkojnë ujëra të ndotura me nënprodukte naftë, lëndë kimike, toksike etj. Shtrirja e kësaj zone përcaktohet duke u bazuar në kushtet hidrogjeologjike të vendburimit, karakterin, llojin dhe madhësinë e objekteve të ndryshme.

Për burimin (kaptazhin), sipas formacioneve gjeologjike, kjo zonë përfshin një territor me rreze 15–100 m.

Mbrojtja e saj me roje të armatosur sigurohet nga administratori i ujësjellësit.

b) zona e dytë: *zona e afërt e mbrojtjes sanitare*, vjen menjëherë pas zonës së parë dhe quhet edhe zona e parandalimit. Ky brez duhet të sigurojë mbajtjen larg kaptazhit të bakterieve dhe viruseve patogene, si dhe të mos lejojë lëndët e degradueshme ose të padegradueshme të arrijnë në zonën e ujërave nëntokësore.

Në këtë zonë ndalohen ndërtimet, bujqësia, industria, depozitimi i mbeturinave, nxjerrja e materialeve, si dhe kufizohet përdorimi i tokës. Në këtë zonë ushtrohet kontroll i vazhdueshëm për respektimin e rregullave higjienosanitare, vlerësimin e mjedisit, si dhe masave antiepidemike në rastet e sëmundjeve ngjitëse.

c) zona e tretë: *zona e largët e mbrojtjes sanitare* është brezi përreth zonës së dytë dhe shërben si zonë tampon midis zonës së dytë dhe mjedisit përtej zonës së tretë. Funkzioni i këtij brezi është të eliminojë lëndët e padëshirueshme. Në brendësi të kësaj zone ndalohen ndërtimet industriale dhe nxjerrja e materialeve.

SHTOJCA VII

DEZINFIEKTIMI I OBJEKTEVE TË NDRYSHME TË VEPRAVE TË FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM

1. Dezinfektimi i kaptazheve dhe rezervuarëve

Pasi ka mbaruar ndërtimi i veprës bëhet pastrimi i saj nga materialet e ndryshme ndërtimore. Pastrimi i mureve dhe i dyshemesë bëhet me furçë të lagur me solucion të përqendruar të klorit me përmbajtje 100 mg/l klor aktiv. Në rastin e përdorimit të pompave spërkatëse, përqendrimi i klorit merret 200–250 mg/l klor aktiv. Pastaj bëhet shpëlarja e objektit.

Pastrimi i objektit gjatë shfrytëzimit të tij fillon me heqjen e llumrave që mund të kenë dekantuar në dysheme, pastrimin e mureve dhe larjen e dyshemesë me ujë. Dezinfektimi i objektit bëhet si më sipër duke përdorur solucion klori.

2. Dezinfektimi i linjave

Ndërtimi i linjave të reja të ujësjellësit, rikonstrukcionet e tyre, vendosja e armaturave të ndryshme në sistemin e ujësjellësit shoqërohet me ndotjen e tyre. Për të evituar ndotjen e ujit, përpara vënies së tyre në punë, linjat pastrohen dhe dezinfektohen sipas kërkesave të mëposhtme:

- pastrimi bëhet me ujë me presion të lartë në sektorë me gjatësi që varen nga mundësia e shkarkimit të linjave që i nënshtrohen këtij procesi. Kjo gjë vazhdon deri sa uji në tubacion të jetë i pastër. Zakonisht kjo shpëlarje vazhdon jo më pak se 2 orë;

- dezinfektimi i linjave bëhet me solucion klori, doza e të cilit merret në varësi nga koha e kontaktit. Për një kohë kontakti të solucionit me tubin prej 8 orësh, doza merret 100 mg/l, për 12 orë kontakt doza merret deri në 60 mg/l, ndërsa për 24 orë merret 20–30 mg/l. Pas kësaj, tubacioni zbrazet nga uji dhe bëhet përsëri shpëlarja me ujë të pastër pa ndërprerje për 6 orë deri sa të largohet era e klorit;

- dezinfektimi i rrjetit të brendshëm të furnizimit me ujë të godinave që ndërtohen të reja ose që rikonstruktohen, bëhet me solucion klori me dozë 15–20 mg/l për kohë kontakti 8 orë. Për rrjetin e brendshëm të furnizimit me ujë të godinave bëhet shpëlarja e sistemit të tubacioneve përpara dhe mbas dezinfektimit;

- pas dezinfektimit dhe shpëlarjes së kaptazheve, rezervuarëve, linjave të ujësjellësit (pas vendosjes së linjave të reja apo riparimit të tyre) bëhet analiza bakteriologjike.

Miratimi për vënien në punë të objekteve të reja ose linjave të reja të ujësjellësit, si dhe për rivënien në punë të linjave ose objekteve ku janë kryer punime për riparimin e defekteve, bëhet nga struktura rajonale e shëndetit publik pas verifikimit të cilësisë së ujit të pijshëm.

SHTOJCA VIII

KËRKESAT TEKNIKE DHE HIGJIENOSANITARE PËR AUTOBOTËT

Furnizimi i popullatës me ujë të transportuar me autobotë përdoret në raste emergjence ose në disa situata kur kjo mënyrë furnizimi është e vetmja mundësi e vlefshme.

Në raste të transportit të ujit me autobotë përparësi ka sigurimi i mbrojtjes së shëndetit publik.

Subjektet e autorizuara të cilat planifikojnë të transportojnë ujë të pijshëm me autobotë, fillimisht kontaktojnë me strukturat e ISHSH-së për pajisjen me aktmiratim higjienosanitare për autobotin.

1. Burimi i ujit

Uji për furnizimin e autobotëve merret nga sistemi i ujësjellësit që furnizon me ujë popullatën. Në rast përdorimi të një burimi tjetër uji, si burim natyral, pusshpimi apo rezervuari i hapur, subjekti i licencuar duhet të pajiset me leje nga Këshilli i Basenit Ujor.

2. Kontejneri i autobotit

Kërkesat teknike dhe higjienosanitare të kontejnerit:

- kontejneri i autobotit duhet të jetë i pastër dhe i mirëmbajtur në mënyrë që të parandalohet ndotja e ujit të pijshëm;

- materiali i veshjes së brendshme duhet të respektojë kërkesat e nenit 12;

- duhet të jetë lehtësisht i pastrueshëm dhe i dezinfektueshëm;

- gjithë pjesa e brendshme e kontejnerit duhet të jetë lehtësisht e inspektueshme;

- pjesa e brendshme e kontejnerit kontrollon, shpëlahet me ujë të dezinfektuar (sipas pikës 3), mbushet me ujin që do të transportohet dhe testohet nga ana mikrobiologjike për organizmat koliformë. Testi fillestar duhet të tregojë mungesën e organizmave koliformë përpara se autoboti të përdoret për transportin rutinë të ujit. Pasi ka filluar procesi i transportit rutinë dhe janë marrë masat për parandalimin e ndotjes, nuk ka nevojë të përsëritet testimi gjatë periudhës së përgjigjes ndaj emergjencës;

- nuk lejohet të përdoren autobotët të cilët pas dezinfektimit nuk kalojnë testin fillestar;

- nuk lejohet të përdoren për transportimin e ujit të pijshëm autobotët e përdorur për transportimin e lëndëve toksike ose lëngjeve të tjera jo të pijshme;

- të gjithë kontejnerët mbushen ose zbrazen nëpërmjet një vrime ajri ose një dopiovalvol kontrolli. Nyjat për mbushjen dhe zbrazen e kontejnerit mbrohen për parandalimin e futjes së ndotësve;

- kontejneri duhet të mbahet i vulosur ose i kyçur dhe kapaku ose kapanxha duhet të uthitet plotësisht;

- nuk lejohen të përdoren për transportimin e ujit të pijshëm kontejnerët që kanë komunikim me atmosferën.

3. Përgatitja e autobotit

Preferohet që autobotët e ujit të përdoren vetëm për transportimin e ujit të pijshëm. Nëse autoboti është përdorur për transportimin e lëndëve jo të rrezikshme, duhet që ai të pastrohet dhe dezinfektohet përpara se të mbushet me ujë të pijshëm, në mënyrë që të sigurohet cilësia e ujit të pijshëm të furnizuar prej tyre. Përgatitja e autobotit kalon në tre hapa:

Hapi 1. Pastrimi i kontejnerit

Kontejneri duhet të pastrohet për të siguruar që uji në të nuk ndotet me papastërtitë apo gjurmët e lëndës që ai ka mbartur më parë. Kjo arrihet me procedurën e mëposhtme:

1.1 Boshatisja e kontejnerit

Hapet kapaku/valvola e shkarkimit dhe zbrazet lëngu i mbetur, i cili grumbullohet për t'u shkarkuar në mënyrë të sigurt. Shumica e kontejnerëve e kanë valvolën e shkarkimit në pjesën e pasme, kështu që rekomandohet parkimi i tij në një vend të pjerrët në mënyrë që të zbrazet i gjithë lëngu (figura 1).

1.2 Pastrimi i sipërfaqeve të brendshme

Për pastrimin e sipërfaqeve të brendshme të kontejnerit përdoret një përzierje detergjenti me ujë. Pastrimi bëhet me një furçë të fortë ose me presion të lartë. Nëse kontejneri ka mbartur lëndë volatile, si vaj apo lëndë organike si qumësht, nuk duhet hyrë në kontejner për arsye se gazrat që dalin mund të jenë të rrezikshme (pika 8). Qoshet dhe lidhjet duhen pastruar me kujdes të veçantë në mënyrë që të mos mbetet asnjë sasi sado e vogël e lëngut të mëparshëm.

Gjatë pastrimit, valvola e shkarkimit lihet hapur dhe mbetjet grumbullohet për t'u shkarkuar në mënyrë të sigurt.

1.1 Shpëlarja e sipërfaqeve të brendshme

Shpëlarja e sipërfaqeve të brendshme bëhet për të larguar të gjitha gjurmët e detergjentit. Ajo kryhet më lehtësisht me ujë me presion, por në mungesë, kontejneri mbushet me ujë dhe lihet të qëndrojë për disa orë. Zbrazet i gjithë uji nga kontejneri dhe grumbullohet për t'u shkarkuar në mënyrë të sigurt si më parë. Shpëlarja e kontejnerit vazhdohet deri sa të mos ketë më gjurmë të detergjentit në ujë.





Figura 1. Boshatisja e kontejnerit

Pastrimi i kontejnerit duhet të bëhet në vende të hapura, larg shtëpive me qëllim shmangien e problemeve të mundshme për shëndetin.

Hapi 2. Dezinfektimi i kontejnerit

Për një dezinfektim sa më efektiv të kontejnerit:

- Mbushet kontejneri me ujë të pastër deri në ¼ e volumit;
- Përgatitet tretësira e klorit siç tregohet në kutinë 1. Për këtë përdoret hipoklorit kalciumi, pluhur, që normalisht përmban 50 deri 70% klor;
- Shtohet tretësira e klorit ngadalë dhe duke e përzier dhe më pas mbushet kontejneri me ujë të pastër deri në maksimum;

- Tretësira e klorit mbahet në kontejner për të paktën 24 orë. Kapaku i kontejnerit mbahet i mbyllur;
- Nëse kontejneri kërkohet të përdoret urgjentisht, dyfishohet sasia e klorit të shtuar në kontejner. Kjo e redukton kohën e qëndrimit nga 24 në 8 orë;
- Më pas, zbrazet plotësisht kontejneri dhe bëhet shkarkimi i sigurt i tretësirës së klorit meqë ajo ka përqendrim të lartë të klorit, që dëmton peshqit dhe bimësinë ujore. Në disa raste, për të larguar klorin përpara se uji i klorinuar të derdhet, mund të trajtohet me acid citrik ose tiosulfat.

Të gjithë tubat, pompat dhe pajisjet e tjera që përdoren në transportimin e ujit, dezinfektohen me të njëjtën procedurë të përshkruar më lart.

Hapi 3. Testi i ujit për transportim

- Pasi është zbrazur plotësisht, kontejneri rimbushet me ujë të pastër për t'u transportuar, lihet 30 minuta dhe testohet për klorin e lirë mbetës dhe për bakterie koliforme;
- Nëse përqendrimi i klorit të lirë mbetës është 0.5 mg/l ose më pak, atëherë kontejneri është i sigurt të përdoret për transportimin e ujit të pijshëm. Përndryshe, zbrazet përsëri kontejneri dhe rimbushet me ujë të pastër. Ritestohet për të kontrolluar nëse përqendrimi është 0.5 mg/l ose më pak;
- Nëse bakteriet koliforme janë të pranishme, përsëritet procesi.

Nëse kontejneri nuk mund të dezinfektohet deri në eliminim të koliformeve, ai nuk lejohet të përdoret.

Kutia 1. Përgatitja e tretësirës së klorit për dezinfektimin e kontejnerit

- Llogaritet vëllimi total i kontejnerit.
- Mbushet një kovë 20-litërshe me ujë të pastër.
- Shtohet 50 g hipoklorit kalciumi në ujë dhe përzier deri sa të tretet mirë.
- Shtohet 10 litër (gjysma e kovës) tretësirë klori për çdo 1000 litër ujë të kontejnerit.

Shembull.

Kontejneri është 4 m i gjatë, 1.8 m i gjerë dhe 1.4 m i lartë (kontejneri ka formë ovale).

Vëllimi total i kontejnerit është:

$$\left[\frac{(1.4 + 1.8)}{2} \right]^2 * \pi * 4.0 = 8.04 \text{ m}^3$$

Prandaj, shtohen pak më shumë se 4 kova 20-litërshe me tretësirë klori gjatë kohës që kontejneri mbushet me ujë të pastër. **Shënim.** Nëse përdorim hipoklorit natriumi (lëng) me 12.5% klor, shtohet 100 ml për çdo 1000 litër ujë.

4. Asgjësimi i mbetjeve të lëngëta

Mbetjet e lëngëta të pastrimit dhe dezinfektimit të autobotit duhet të grumbullohen dhe shkarkohen në mënyrë të sigurt. Shkarkimi i tyre duhet të bëhet në mjedise ujore pritëse, si: lumë, liqen, kanal etj., në mënyrë që të mos shkaktohen përmytje të lokalizuara ose erozion.

Në qoftë se kontejneri është përdorur për mbajtjen e lëngjeve të tjera, duhet të merren masat për të parandaluar ndotjen e mjedisit nga mbetjet e lëngëta që do të shkarkohen gjatë përgatitjes së autobotit.

Një alternativë është mbledhja e mbetjeve të lëngëta në një pellg të përkohshëm dhe përzierja e tyre me rërë. Më pas, përzierja transportohet për asgjësim në një vend të përshtatshëm (të tillë si landfilli).

Nëse ka sasi të mëdha të mbetjeve të lëngshme, përthithja e tyre në rërë nuk është e mundur. Në këtë rast është i nevojshëm përdorimi i tankerave me vakuum për largimin e mbetjeve të lëngshme dhe asgjësimin e sigurt të tyre (impiante të trajtimit të ujërave).

5. Trajtimi i tubave dhe pajisjeve të tjera të autobotit

Të gjithë tubat e ujit dhe pajisjet e tjera, të përdorura gjatë periudhës së përgjigjes ndaj emergjencës, ruhen gjatë gjithë kohës larg tokës. Përpara përdorimit, ata shpëlahen, dezinfektohen dhe më pas shpëlahen përsëri plotësisht me ujë të pastër. Të gjithë tubat që nuk janë në përdorim izoloohen mirë në secilin skaj të tyre. Tretësira dezinfektuese është e njëjtë me atë që përdoret për dezinfektimin e kontejnerit të autobotit.

Të gjitha sipërfaqet e pajisjeve në kontakt me ujin e pijshëm, duke përfshirë këtu përshtatësit në vendin e mbushjes, kontejnerët, kapakët, valvulat, filtrat, pompat dhe pajisje të tjera hidraulike, kontrollohen rregullisht dhe dezinfektohen ose zëvendësohen sipas nevojës.

Të gjitha pajisjet që lidhen me marrjen, transportimin dhe shpërndarjen e ujit, projektohen posaçërisht për ujë të pijshëm (d.m.th. të sigurt, të qëndrueshme, rezistente ndaj korrozionit, joabsorbuese dhe me sipërfaqe të buta dhe lehtësisht të dezinfektueshme).

6. Rezervuarët ose sistemi marrës i ujit

- Nëse rezervuari ose sistemi marrës i ujit të transportuar me autobot është pjesë e sistemit të furnizimit publik, atëherë drejtuesit e tyre sigurojnë që sistemi është i sigurt të mbushet nga autoboti.

- Në disa raste nevojitet të përdoren rezervuarë shpërndarës më të vegjël. Materiali i tyre duhet të plotësojë të njëjtat kërkesa, si dhe kontejneri i autobotit (pika 2).

- Ata kontrollohen për të siguruar cilësinë e ujit gjatë mbushjes së tyre dhe më pas gjatë shpërndarjes të konsumatorët. Këta rezervuarë pastrohen dhe dezinfektohen në të njëjtën mënyrë si kontejnerët (pika 3). Ata sigurohen dhe mbrohen nga ndotja gjatë gjithë periudhës së përgjigjes ndaj emergjencës. Vërejtjet lidhur me rezervuarët e ujit dokumentohen në regjistër.

- Rezervuarët mbushen ose zbrazen nëpërmjet një vrime ajri ose një dopiovalvol kontrolli.

7. Dokumentacioni dhe regjistrimi i të dhënave

Subjekti që furnizon ujin e pijshëm me autobot është përgjegjës për dokumentimin, regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave që lidhen me veprimet e kryera gjatë këtij procesi. Këto të dhëna përfshijnë:

- emrin dhe numrat e kontaktit të subjektit transportues;
- libreta shëndetësore për personat që kryejnë furnizimin me autobotë (e rinovuar çdo 6 muaj);
- aktmiratim higjienosanitare nga ISHSH-ja për autobotin;
- leje përdorimi nga Këshilli i Basenit Ujor;
- sasia ujit e shpërndarë për çdo udhëtim;
- burimi i ujit që është përdorur, i aprovuar sipas pikës 1;
- data dhe koha e shpërndarjes, klori i lirë mbetës në pikën e shpërndarjes;
- doza e klorit në pikën e mbushjes dhe klori i lirë mbetës pas mbushjes;
- çdo shënim tjetër lidhur me rezervuarët e furnizimit me ujë.

Këto të dhëna ruhen të paktën për 1 vit dhe rishikohen sipas kërkesës nga autoritetet shëndetësore, subjektet transportuese të ujit apo administratorët e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm.

8. Çështje të shëndetit dhe sigurisë

Futja dhe punimet brenda kontejnerit mund të jenë të vështira dhe të rrezikshme. Shpesh, ka vetëm një kapaqxhë të vogël në pjesën e sipërme të kontejnerit, nëpërmjet së cilës futesh dhe del jashtë tij. Pastruesit duhet të kenë parasysh se disa lëngje të transportuara me kontejner mund të lëshojnë gazra të dëmshme, të cilat mund të mbeten edhe pasi lëngjet janë larguar. Lëngjet mund të shkaktojnë edhe rreziqe fizike, si p.sh. rrëzim nga sipërfaqet rreshqitëse ose djegie nga lëngjet gërryese.

Gjithmonë fryhet ajër i freskët në kontejner për një periudhë të nevojshme që të lejojë futjen e personit në kontejner. Personi i ngarkuar për pastrim duhet të veshë rroba mbrojtëse, duke përfshirë doreza, çizme, kapele dhe syze.

Duhet të sigurohet që një person tjetër të qëndrojë jashtë, pranë kapaqxhës, gjatë gjithë kohës që dikush është duke punuar brenda, në gatishmëri në rast të ndonjë aksidenti. Është avantazh përdorimi i maskave të gazit dhe ventilatorëve portativ.

SHTOJCA IX DEZINFEKTIMI I UJIT TË PIJSHËM

Dezinfektimi i ujit të pijshëm duhet të kryhet në të gjitha sistemet e furnizimit me ujë. Këtu duhet të sigurohet gjatë 24 orëve niveli i klorit i përcaktuar nga kjo rregullore.

1. Metodatat e dezinfektimit të ujit të pijshëm

Metodat më të përdorshme janë:

- a) metodatat fizike; dhe
- b) metodatat kimike.

a) *Metodatat fizike* kryesisht përfshijnë:

Vlimin: Pasi uji arrin pikën e vlimit, lihet të vlojë për 1 minutë. Nëse uji ka turbullirë, duhet që para vlimit të filtrohet për të larguar sedimentet. Kjo metodë është e përshtatshme për përdorim shtëpiak ose në rast epidemie.

- rrezatimin ultraviolet;
- rrezatimin elektromagnetik;
- tingujt ultrasonikë; dhe
- karbonin e aktivizuar. b)

Metodatat kimike:

Në ujin e pijshëm shtohen kimikate, si dhe *ozoni*, për dezinfektimin e tij. Uji dezinfektohet kryesisht para se të hyjë në rrjetin e shpërndarjes për të siguruar eliminimin e mikrobeve potencialisht të rrezikshme. Dezinfektantët më të përdorur janë *klori*, *dyoksidi i klorit* dhe *kloramina* për shkak se janë shumë të efektshëm, jo vetëm në VTUP, por edhe në tubacionet e rrjetit të shpërndarjes. *Ozoni* është një dezinfektant i fuqishëm, por sikurse rrezatimi ultraviolet, nuk është i efektshëm për trajtimin në kontrollin e ndotësve biologjikë në tubacionet e shpërndarjes.

Produktet dezinfektuese, si: hipokloriti i kalciumit, hipokloriti i natriumit apo klori i gaztë janë produkte kimike të cilat përdoren për dezinfektimin e ujit të pijshëm duke u përshtatur me teknologjitë përkatëse.

Pajisjet që përdoren për dezinfektim:

- dozatorë me vetërrjedhje;
- dozatorë me rregullim automatik të sasisë së dezinfektuesit;
- dozatorë me presion me rregullim automatik të sasisë së dezinfektuesit;
- sistemi me tri vaska me dozim manual;
- sistemi me tri fuçi.

2. Shembull i përgatitjes së tretësirës së kloruar

2.1 Përgatitja e një tretësire me 20 gram klor për litër:

a) Tretësira e hipokloritit të natriumit (ujë javeli)

Uji i javelit shitet i lëngshëm, me një përqendrim më të vogël se 152 g/l (48° klorimetrike) ose rreth 38 g/l (12° klorimetrike).

Një litër ujë javeli i dozuar në 152 g/l lejon të merren rreth 7,5 litra tretësirë me 20 g/l.

Një litër ujë javeli i dozuar në 38 g/l lejon të merren rreth 1,9 litra solucion me 20 g/l.

b) Tretësira e hipokloritit të kalciumit

Shitet në formë pluhuri. Përmbajtja e klorit në këtë produkt është rreth 60%.

Një kilogram i hipokloritit të kalciumit lejon të merren rreth 30 litra tretësirë me 20 g/l.

Kujdes i veçantë duhet bërë për tretjen e plotë të këtij produkti në ujë. Përdorimi i një përzierësi elektrik thjeshtëson këtë detyrë.

2.2 Kolaudimi i aparateve të injektimit

Kolaudimi varet nga:

- përqendrimi i klorit mbetës të dëshiruar në pikat fundore të rrjetit (shih paragrafin e mëparshëm);
- debiti i ujit për t'u trajtuar. Në rast luhatjeje të prurjes (rasti i burimeve karstike) do të mbahet prurja maksimale që merret nga ujësjellësi.

* *Klorimetërme klor gaz*

Sasia e klorit për injektim llogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$D = C \times Q$$

ku: D (gram klor/orë): sasia e klorit e matur në kontatorin e klorimetrit

C (miligram klor/litër ujë ose gram klor/m³ ujë): doza klorit për injektim

Q (m³/orë): prurja e ujit për t'u trajtuar

* *Shembull numerik:*

doza e klorit për injektim: C = 1 mg/l ose g/m³

prurja e ujit për t'u trajtuar: Q = 100 m³/orë

doza e klorit të matur me kontatorin e klorimetrit:

$$D = C \times Q = 1 \times 100 = 100 \text{ g klor/orë}$$

* *Pompë dozimipërtretësirëujore:*

Doza e tretësirës së kloruar për injektim llogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$D = (C \times Q) / S$$

ku: D (litër tretësirë /orë): prurja e pompës dozuese

C (miligram klor /litër ujë ose gram klor/m³ ujë): doza e klorit për t'u injektuar

Q (m³/orë): prurja e ujit për t'u trajtuar

S (gram klor/litër tretësirë) përqendrimi i tretësirës së dhënë nga pompa dozuese

* *Shembull numerik:*

doza e klorit për injektim: C = 1 mg/l ose g/m³

prurja e ujit për t'u trajtuar: Q = 100 m³/orë

përqendrimi i tretësirës: S = 20 g/l

prurja e tretësirës së dhënë nga pompa dozuese:

$$D = (C \times Q) / S = (1 \times 100) / 20 = 5 \text{ l/orë}$$

2.3 Koha e kontaktit

Koha e kontaktit të ujit me klorin nga fillimi i përzierjes deri te përdoruesi duhet të jetë jo më pak se 30 minuta. Kontakti i ujit me klorin mund të realizohet në:

- kaptazh, qoftë burim natyror ose pusshpim;
- stacionin e pompimit (me injektim në tubacionin e dërgimit);
- partitarin e shpërndarjes së ujit;
- rezervuarin grumbullues;
- rezervuarin shpërndarës.

3. Testet e matjes së klorit mbetës

a) *Test Dietil-Parafenilen-Diaminë (DPD)*

Ky test përdor tabletat DPD-1 ose DPD-3, të cilat i japin ngjyrë ujit të klorinuar kur shtohen në të. Ngjyra është më e errët sa më i lartë është niveli i klorit mbetës.

Tabletat DPD-1 përdoren për të matur sasinë e klorit të lirë, ndërsa tableta DPD-3 përdoret pas tabletës DPD-1 për të matur sasinë e klorit total.

Pas klorinimit të ujit të pijshëm, sasia e klorit të lirë, e matur në pikat fundore të rrjetit shpërndarës, duhet të jetë nga 0.2 mg/l deri në 0.5 mg/l.

b) *Testi orto-tolidinë (OT)*

Ky test përdor solucion orto-tolidinë, që në prani të klorit i jep ujit ngjyrë të verdhë. Ngjyra është më e verdhë sa më i lartë është niveli i klorit mbetës.

Ky test jep vlerën e klorit total në ujin e dezinfektuar.

4. Kushtet e ruajtjes së lëndës dezinfektuese

Lëndët dezinfektuese ruhen në lokale të thata, të ajrosura mirë, pa lagështirë dhe të pajisura me sistem ajrimi. Ato vendosen në lartësinë 25 cm mbi sipërfaqen e dyshemesë.

Para përdorimit të lëndëve dezinfektuese, përdoruesit bëjnë për çdo parti, kontrollin dhe analizat e nevojshme për përcaktimin e klorit aktiv. Për çdo parti të analizuar, administratori i ujësjellësit duhet të

ketë në dispozicion rezultatet e analizave dhe miratimin e përdorimit nga struktura rajonale e shëndetit publik.

Në rastin e përdorimit të klorit të gaztë, në ambientet e klorinimit parashikohen ndarje me mure betoni të përcaktuara në rregulloren për ruajtjen e enëve nën presion.

Lëndët dezinfektuese mbahen në ambiente larg burimeve të nxehtësisë, acideve ose lëndëve të oksidueshme. Ambienti duhet të jetë nën vrojtim të vazhdueshëm nga përdoruesi dhe në të nuk lejohet të ketë rrjedhje.

Duke qenë se këto lëndë kimike kanë veti korrozive, irrituese dhe toksike, është e detyrueshme që gjatë përpunimit të tyre të mbahen doreza gome, syze, maska dhe çizme. Në këto ambiente është e detyrueshme të mbahet kutia e ndihmës së shpejtë.

SHTOJCA X

MIRËMBAJTJA E VEPRAVE TË UJIT TË PIJSHËM

Veprat e marrjes së ujit (dhoma, galeri, tunele etj.) mirëmbahen në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike nga administratori. Algat ose bimët e tjera ujore që rriten në këto objekte hiqen dhe më pas sipërfaqet dezinfektohen me solucion hipokloriti.

Territoret e veprave të marrjes së ujit rrethohen dhe hyrja në brendësi të tyre bëhet vetëm me autorizim të administratorit të objektit. Përfaqësuesit e autoritetit shëndetësor, me detyrë kontrollin sanitar apo inspektimin sanitar, kanë të drejtë të hyjnë në brendësi të territorit pa autorizim, duke njoftuar paraprakisht administratorin.

Në hyrje të objektit të ujësjellësit, kaptazh, stacion pompimi, partitar, rezervuar etj., vendosen vaska me solucion 5% të hipokloritit të kalciumit ose të natriumit, për dezinfektimin e këpucëve, çizmeve etj.

Rezervuarët e ujit të pijshëm kontrollohen për rrjedhje dhe pastrohen e dezinfektohen të paktën një herë në vit.

Për mbrojtjen nga korrozioni prej lëndëve kimike dhe agjentëve atmosferikë në kaptazhe, në veprat e trajtimit, stacionet e pompimit, dhomat e manovrimit në partitarë, në rezervuarë, në pusetat e manovrimit etj., të tubacioneve sipërfaqësorë dhe saraçineskave, bëhet lyerja me bojë kundër ndryshkut, e destinuar për lyerjen e kontejnerëve të ujit të pijshëm, periodikisht dhe rast pas rasti (jo më pak se një herë në dy vjet).

Pusetat e kontrollit, manovrimit dhe ajrimit pastrohen jo më pak se një herë në vit. Për të evituar futjen e ujërave nëntokësore bëhet izolimi i tyre.

Administratori kontrollon vazhdimisht rrjetin shpërndarës të ujësjellësit për gjetjen dhe eliminimin e defekteve. Ai merr në konsideratë të gjitha njoftimet për defekte të zbuluara nga qytetarët apo organet e qeverisjes vendore. Defektet regjistrohen në një regjistër të veçantë ku vendosen elementet identifikuese të defektit: adresa e plotë, koha e konstatimit/njoftimit, kush njofton, kur është eliminuar defekti dhe kush i ka kryer punimet. Eliminimi i defekteve bëhet menjëherë sapo ai konstatohet/merret njoftimi.

Për të pastruar rrjetin e ujësjellësit pas punimeve që mund të kryhen për riparimin e tij, pas shtrimit të linjave të reja të tubacioneve, bëhet dezinfektimi i tyre sipas dozave të përcaktuara në këtë rregullore. Shpëlarja e linjave të ujësjellësit bëhet në pikat e vendosjes së shkarkuesve të linjave ose hidrantet.

Administratori njofton strukturën rajonale të shëndetit publik për rastet e punimeve dhe defekteve në kaptazh, në linjat e jashtme, rezervuarët, në linjat kryesore, si dhe në rastet e rikonstruksioneve në këto objekte për verifikimin e cilësisë së ujit të pijshëm. Struktura rajonale e shëndetit publik njofton me shkrim administratorin e ujësjellësit për cilësinë e ujit që rezulton nga analizat laboratorike, si dhe për rezultatet e kontrolleve higjienosanitare. Kostoja për kryerjen e analizave mbulohet nga administratori. Në rast të mosrespektimit të kërkesave të kësaj rregulloreje, struktura rajonale e shëndetit publik jep rekomandime për administratorin dhe njofton ISHSH-në dhe ERRU-në.

SHTOJCA XI
A. KËRKESË PËR LEJIM SHMANGIEJE

1.	Ujësjetllësi a) emër b) adresa c) kodi postal/qyteti (rajoni) d) telefon e) fax f) e-mail	3.	Lloji i shmangies a) lejim b) zgjatje e lejitit c) shmangie afatshkurtër
2.	Zona e furnizimit a) emër b) kodi c) popullsia e prekur d) industria ushqimore e prekur h) vëllimi i ujit të shpërndarë në ditë (m ³)	4.	Karakteristikat e shmangies a) parametri b) vlera e re parametrike e propozuar c) periudha limit për shmangien d) arsyet e kërkesës për shmangie
		5.	Raporti përmbledhës (origjinal dhe kopje)
		6.	Në rast të një zgjatjeje, përfshi progresraportin (origjinal dhe kopje)

Data dhe firma

Dërguar në:

B. Komunikimi i lejitit të shmangies

1.	Ujësjetllësi a) organi përkatës	4.	b) zgjatje e lejitit c) shmangie afatshkurtër
2.	Zona e furnizimit e) emër f) kodi g) popullsia e prekur h) industria ushqimore e prekur i) vëllimi i ujit të shpërndarë në ditë (m ³)	5.	Karakteristikat e shmangies a) parametri b) vlera e re parametrike e propozuar c) data e lejitit d) periudha limit e lejitit e) arsyet e kërkesës për shmangie
3.	Lloji i shmangies a) lejim		Në rast të zgjatjeve, përfshi progresraportin

Data dhe firma e autoritetit që lejon shmangien:

Dërguar në: